ISSN 2308-6106

AUDITIMI PUBLIK

KLSH

KËRKIMORE

SHKENCORE

INFORMATIVE

REVISTË 4 - MUJORE Nr. 20

2018

ALSAI

EUROSAI

INTOSAI

Seria : botime KLSH - 12/2018/96

Tiranë, 2018

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Experentia mutua omnibus prodest

AUDITIMI PUBLIK

REVISTË KATËRMUJORE
kërkimore-shkencore-informative
shqip-anglisht

Nr. 20/2018, Tiranë
ISSN 2308-6106
Viti i VII-të i botimit 2018
Maj - Gusht 2018
Seria : botime KLSH - 12/2018/96

Titulli:

AUDITIMI PUBLIK NR. 20

Redaktore : Irena Islami

Amantja Patozi

Art Design: Elisa Metaj

Seria : botime KLSH - 12/2018/96

Shtypur në “Shtëpia Botuese Shtypshkronja Morava”

Tiranë 2018

ALBANIAN SUPREME AUDIT INSTITUTION

Experentia mutua omnibus prodest

PUBLIC AUDIT

EVERY FOUR MONTHS MAGAZINE

of research, science and information

in Albanian and in English

No. 20/2018, Tirana

ISSN 2308-6106

May- August 2018

Series: Publications ALSAI - 12/2018/96

BORDI SHKENCOR

Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH	Kryetar
Prof. Dr. Omer Stringa Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Dhori Kule, Dekan, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Jorgji Bollano, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilistëve	Anëtar
Prof.Dr. Skënder Osmani, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Anëtar
Prof. Dr. Ardian Nuni, Fakulteti i Drejtësisë	Anëtar
Prof. Dr. Sotiraq Dhamo, Përgjegjës i Departamentit të Kontabilitetit FE (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Akademik, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Argita Berisha, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Lindita Lati, Drejtore e Përgjithshme, KLSH	Anëtar
Prof. Dr. Heinz-Dieter Wenzel, Profesor, Universiteti i Bambergut, Gjermani	Anëtar
Dr. Igor Soltes, ish-President i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë	Anëtar
Dr. Sang M. Lee, Universiteti i Nebraskës, SHBA	Anëtar
Prof. Dr. Tonin Kola, Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. As. Dr. Sazan Guri, Instituti " G& G Group"	Anëtar
Prof.As. Dr. Manjola Naço, Drejtore e Përgjithshme, KLSH	Anëtar
Prof.As.Dr. CPA Hysen Çela, Kryetar i IEKA**,** Managing Partner,nH EuroConsult	Anëtar
Prof. As.Dr. Flutura Kola, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar

SEKRETARIATI

Irena Islami	Sekretare Kolegjiumi

I NDERUAR LEXUES !

Numri 20-të i Revistës Kërkimore shkencore të KLSH-së është botimi i 96-të i kolanës së botimeve të KLSH-së.
Në këtë numër të Revistës kanë kontribuar me shkrimet e tyre personalitete të njohura të auditimit të jashtëm publik, si z.Klaus-Heiner Lehne, President i ECA, drejtues të ECA dhe të INTOSAI-t. Një kontribut të veçantë në këtë numër të Revistës ka dhënë Kryetari i KLSH-së, Dr.Bujar Leskaj dhe SAI Bullgar, në cilësinë e organizatorit të Konferencës Shkencore mbi "Rolin e SAI-ve në forcimin e Llogaridhënies, Transparencës dhe integritetit në Sektorin Publik", si edhe audituesit e KLSH-së me punimet e tyre shkencore të paraqitura në përfundim të Fellowship-it në Zyrën e Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO).

Janë të ftuar të publikojnë punimet dhe opinionet e tyre kontabilistë, financierë, ekonomistë të përgjithshëm, specialistë të enteve publike dhe private, akademikë, ekspertë të shoqërisë civile, profesionistë të pavarur si dhe çdo i interesuar që gjen me vend trajtimin e një çështjeje të caktuar me interes në auditimin dhe vlerësimin e administrimit publik të vendit, bazuar në moton e INTOSAI *"Experentia mutua omnibus prodest (Eksperienca e Përbashkët ju shërben të gjithëve)"*.

Bordi Shkencor i Revistës ju fton të shprehni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja në funksion të përmirësimit, të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të saj me qëllim që kjo Revistë Shkencore, të jetë një mundësi më shumë për zhvillimin e debatit në fushën e auditimit dhe më gjerë.

Adresa e redaksisë

Kontrolli i Lartë i Shtetit
Rruga "Abdi Toptani"nr. 1,
Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail: revista@klsh.org.al, klsh@klsh.org.al

PËRMBAJTJA

TITULLI	AUTORI	FAQE
Si ka ndikuar në modernizimin dhe në projektimin e së ardhmes së institucionit (KLSH) ndihma e Bashkimit Europian	Dr. Bujar LESKAJ Kryetar, KLSH Botuar në revistën e ECA Nr.9	**13**
GALF 2018 - Një forum për një shkëmbim të sinqertë dhe të hapur mes liderëve botërorë në auditimin publik	Intervistë nga Klaus-Heiner LEHNE, President i ECA-s Marrë nga revista ECA Nr.5, Maj 2018	**19**
Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në Përmirësimin e Llogaridhënies, Transparencës dhe Integritetit në Sektorin Publik	Raport përmbledhës i Konferencës Shkencore, organizuar nga Zyra Kombëtare Bullgare e Auditimit	**23**
Skepticizmi profesional, esencial për një auditim cilësor	Prof.Dr.Hysen ÇELA. Kryetar IEKA	**35**

Ndryshimi midis Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit në auditimet e performancës me fokusin tek matja e efektivitetit të programeve qeveritare	Alma SHEHU, Audituese Kontrolli i Lartë i Shtetit	**41**
Kontrolli i brendshëm në SHBA- Mësime për t'u ndarë me Shqipërinë	Alfons GABILI, Auditues Kontrolli i Lartë i Shtetit	**71**
Një SAI në Kongres: Pozicioni i GAO-s dhe auditimet drejt Kongresit të SHBA	Gaston MOONEN, Kabineti i Presidentit, ECA Marrë nga revista *ECA Nr.6-7, Qershor –Korrik 2018*	**101**
Llogaridhënia e parlamenteve kontribuon në balancën e pushteteve	Gaston MOONEN, Kabineti i Presidentit, ECA Intervistë me Daniele Lamarque, Anetare e ECA-s Marrë nga revista *ECA Nr.6-7, Qershor – Korrik 2018*	**107**
Ndryshimet kanë nevojë për një person prapa tyre	Dr. Arnus DULKYS, Auditues i Përgjithshëm i Republikes se Lituanisë Revista e INTOSAI, Verë 2018	**113**
Duke transformuar botën nëpërmjet përpjekjeve për zhvillim të qëndrueshëm	Shourjo CHATTERJEE, Kryellogaritar (Kontabilist i Përgjithshëm)	**117**

	SAI i Indisë Revista e INTOSAI, Verë 2018	
Kapitalizimi i standardeve, ndarja e njohurive për të audituar përpjekjet për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë	Betty Carrion RUIZ,Auditues SAI i Ekuadorit Revista e INTOSAI, Verë 2018	**123**
Info nga vendi	Aktivitete të KLSH – së (maj- gusht 2018)	**127**
Zyra Kombëtare e Auditimit të Australisë	Profil	**185**
Gjykata Marokene e Llogarive	Profil	**191**

Table of Contents

Title	Author	Page
How EU pre-accession aid helped us modernize and shape the future	Dr. Bujar LESKAJ Chairman, ALSAI *Interview in ECA Journal nr.9, 2018*	**199**
2018 GALF – a forum for a frank and open exchange between world leaders in public audit	Interview with Klaus-Heiner LEHNE, ECA President *ECA Journal nr.5, May 2018*	**205**
The Role of Supreme Audit Institutions in enhancing accountability, transparency and integrity in the public sector	Report from the conference organized by the Bulgarian National Audit Office during the Bulgarian Presidency of the Council of the European Union	**209**
Essential professional skepticism for a quality audit	Prof.Dr.Hysen ÇELA Chairman IEKA	**221**
Differences Between U.S. Government Accountability Office and Albania High State Control Approaches Toward Performance Audit with a Focus on Measuring	Alma SHEHU, Auditor ALSAI	**315**

the Effectiveness of Government Programs		
Internal Controls in the USA: Lessons learned to share with Albania	Alfonc GABILI, Auditor ALSAI	**343**
A SAI in Congress: GAO's position and audits towards U.S. Congress	Gaston MOONEN, Directorate of the Presidency, ECA *ECA Journal Nr.6-7, June- July 2018*	**367**
Accountability of parliaments contributing to the balance of powers	Gaston MOONEN, Directorate of the Presidency, ECA Interview with Daniele Lamarque, ECA Member *ECA Journal Nr.6-7, June- July 2018*	**373**
Changes need a person behind them	Dr. Arnus DULKYS, Auditor General of the Republic of Lituania, *INTOSAI Journal, Summer 2018*	**379**
Transforming the world through stustainability efforts	Shourjo CHATTERJEE, Accountant General SAI India *INTOSAI Journal, Summer of 2018*	**383**

Capitalizing on standarts, knowledge sharing to audit disaster recovery efforts	Betty Carrion RUIZ,Auditor SAI of Ecuador *INTOSAI Journal, Summer 2018*	**387**
Events and activities of ALSAI during May- August 2018	INFO	**391**
The Australian National Audit Office	Profile	**447**
The Court of Accounts of Marocco	Profile	**451**

SI KA NDIKUAR NË MODERNIZIMIN DHE NË PROJEKTIMIN E SË ARDHMES SË INSTITUCIONIT (KLSH) NDIHMA E BASHKIMIT EUROPIAN

Intervistë me Z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë,

botuar në revistën nr.9 të ECA-s

Që nga fillimi i mandatit tim në vitin 2012, ne si SAI e kishim të qartë se për të përmbushur Kriteret e Kopenhagen (kriteret e pranimit) në fushën e auditimit të jashtëm publik, për një vend evropian si Shqipëria, e cila kërkon pranimin në BE, nevojiteshin përpjekie të forta drejt modernizimit, për ti sjellë auditimet tona në përputhje me standardet e INTOSAI-t.

Nga: Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së

Pyetja 1: Zoti Leskaj, a ka përfituar KLSH nga ndihmat e BE për para aderimin?

Përpara fillimit të mandatit, në 1 Nëntor 2017, kur unë prezantova në Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat dokumentin strategjik për zhvillimin e KLSH, kam theksuar nevojën e madhe për një vizion koherent për KLSH-në, bazuar në përvojat më të mira të vendeve të BE-së dhe respektimin rigoroz të standardeve të njohura ndërkombëtarisht. Ky ka qenë edhe objektivi i parë strategjik.

Që nga fillimi i mandatit tim në vitin 2012, ne si SAI e kishim të qartë se për të përmbushur kriteret e Kopenhagen-it (kriteret e pranimit) në fushën e auditimit të jashtëm publik, për një vend evropian si Shqipëria, e cila kërkon pranimin në BE, nevojiteshin përpjekje të forta drejt modernizimit, për ti sjellë auditimet tona në përputhje me standardet e INTOSAI-t.

Për të arritur këtë qëllim, në Shkurt të vitit 2012 kemi aplikuar për mbështetje nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri. Ndërkohë, riaktivizuam bashkëpunimin me SIGMA e cila filloi një program trajnimi për audituesit tanë në mesin e vitit 2012 dhe krijoi marrëdhënie shumë të mira me Drejtorinë e Buxhetit në KE. Në Nëntor të vitit 2012, një këshilltar i lartë i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, vizitoi Tiranën dhe mori pjesë në takimet këshillimore me palët e interesit (deputetët, ekspertët ligjor dhe financat publike, organizatat e shoqërisë civile, qarqet akademike dhe mediat) gjatë diskutimeve publike mbi

projektligjin e ri të KLSH. Më tej, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit adresoi gjithashtu në Bruksel, Instrumentin për Programin e Para-Aderimit (IPA) me idenë se do të ishte e frytshme një mbështetje e qëndrueshme për modernizimin e KLSH-së.

Si rezultat, në vitin 2015, mësuam se KLSH i është akorduar një projekt binjakëzimi nën Programin IPA 2013, me një fond prej 2.1 milion Euro. Ne patëm mundësinë të përfitonim nga ky program për të drejtuar punën drejt procedurave të tenderimit, në përzgjedhjen e partnerëve të binjakëzimit më të përshtatshëm, ndër vendet e BE. Në atë kohë kishim në mendje Zyrën Supreme të Auditimit të Polonisë (NIK) dhe Zyrën e Auditimit Shtetëror të Kroacisë.

Pyetja 2: Përse?

Ne kishim vendosur marrëdhënie shumë të mira pune me ta. Në Korrik 2012, dy javë pasi nënshkruam në Varshavë, Marrëveshjen e Bashkëpunimit me NIK Polak, bazuar në moton tonë "Experentia Mutua Omnibus Prodest", Presidenti i atëhershëm i NIK, z. Jacek Jezierski mirëpriti në qendrën e trajnimit në Varshavë grupin e parë prej 15 audituesish shqiptarë. Ata u trajnuan mbi auditimin financiar dhe procedurat e auditimit të përputhshmërisë, si dhe mbi vlerësimin e riskut.

Audituesit tanë patën mundësinë të njihen me qasje të reja të auditimit dhe të përballen me përvojat e tyre të përditësuara. Kjo ishte një ndihmë e konsiderueshme për ne. Ne vazhdimisht dërguam grupe të tjera audituesish, të cilët fituan një përvojë të vlefshme. E njëjta gjë, megjithëse në një shkallë më të vogël (për shkak të mundësive konkrete) ndodhi me Zyrën Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, pasi nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit me ta në Nëntor 2012. Ata gjithashtu hapën dyert për audituesit tanë.

Pyetja 3: A rezultoi i suksesshëm orientimi juaj?

Po. Mendoj se ishte çelësi i suksesit për mbështetjen e para-aderimit të BE-së që morëm. Më 17 Shkurt 2016 u nënshkrua një kontratë e projektit të binjakëzimit midis KLSH dhe dy SAI-ve partnere nga Shtetet Anëtare të BE-së, NIK polak (si partner kryesor binjakëzues) dhe Zyra e Shtetërore e Auditimit Kroate, si partner dytësor. Në Mars të vitit 2016, nënshkrova me Presidentin e NIK, z. Krzysztof Kwiatkovski në Varshavë, një memorandum mirëkuptimi, në të cilin të dyja SAI-t u angazhuan të punonin së bashku për të zbatuar projektin e binjakëzimit. Projekti gjithashtu u mbështet plotësisht edhe nga SAI i Kroacisë, në veçanti nga Audituesi i Përgjithshëm z. Ivan Klesic. Projekti filloi më 16 Mars 2016 dhe përfundoi më 13 Korrik 2018. Për zbatimin e këtij projekti, partnerët tanë të binjakëzimit u angazhuan në 107 misione për të

përmirësuar kapacitetet e auditimit të KLSH-së.

Së bashku me partnerët tanë të projektit në BE, ne po përpiqemi të përmbushim tre objektiva kryesore: (i) përmirësimin e kuadrit tonë ligjor në auditim, (ii) forcimin e kapaciteteve tona institucionale dhe (iii) rritjen e ndikimit të auditimeve tona.

Pyetja 4: A pati rezultate të mira projekti?

Unë mendoj se po. Për objektivin e parë, ekspertët tanë të binjakëzimit analizuan kuadrin ligjor të KLSH-së përkundrejt përputhshmërisë me standardet e INTOSAI dhe modelet e adaptueshme të SAI-ve të Shteteve Anëtare të BE-së. Ata ofruan udhëzime praktike për zbatimin e ligjit të ri të KLSH në fusha specifike dhe një Plan Veprimi për hartimin e akteve nënligjore. Për të përmbushur qëllimin e dytë, partnerët tanë të projektit analizuan rregulloren e brendshme të KLSH dhe erdhën me propozime për ta rishikuar dhe ndryshuar atë në përputhje me ligjin tonë të ri, duke ofruar qasje të reja në auditimet e përputhshmërisë, financiare dhe të performancës, bazuar edhe në përvojat e tyre. Ata analizuan aktet rregullative për marrëdhëniet e KLSH me Parlamentin dhe praktikat konkrete në marrëdhëniet midis dy institucioneve dhe erdhën me një projekt-udhëzim mbi institucionalizimin e marrëdhënieve tona me Parlamentin, si dhe një plan me masa për zbatimin e këtij udhëzimi. Ata analizuan gjithashtu kuadrin ligjor të praktikave tona për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Konkretisht, ata:

1. analizuan hendeqet e reja ligjore të KLSH dhe identifikuan pengesat e mundshme në zbatimin e ligjit;
2. zhvilluan propozime për institucionalizimin e marrëdhënieve të KLSH me Parlamentin;
3. krijuan Manualin e Auditimit IT të KLSH;
4. shqyrtuan dhe përditësuan Manualin e Auditimit të Performancës;
5. shqyrtuan dhe përditësuan Manualin e Auditimit Financiar;
6. zhvilluan metodologjinë dhe qasjen për auditimin e pasqyrave financiare;
7. zhvilluan një strategji të përgjithshme për fazën e planifikimit të procesit të auditimit;
8. zhvilluan një strategji të përgjithshme për komunikimin e brendshëm në KLSH;
9. zhvilluan një strategji të përgjithshme për komunikimin e jashtëm të KLSH;
10. mundësuan vizitat studimore të audituesve tanë në Poloni, Kroaci dhe Holandë për të mësuar nga përvoja e audituesve të pavarur në SAI-t përkatëse.

Unë e vlerësoj në veçanti angazhimin dhe përfshirjen e drejtpërdrejtë të

liderit të projektit dhe zëvendëskryetarit të NIK, z. Wojciech Kutyla dhe z. Jacek Jezierski, këshilltar i lartë i presidentit të NIK.

Pyetja 5: Pra, ata bënë një punë të madhe. Cila ishte përgjigja juaj ndaj rezultateve të kësaj pune?

Ne mobilizuam të gjitha burimet tona njerëzore për t'u bashkuar dhe mbështetur të gjitha misionet e binjakëzimit. Më 30 Qershor 2017, kam publikuar një urdhër të brendshëm për zbatimin nga KLSH, të të gjitha rekomandimeve që vijnë nga misionet e Projektit të Binjakëzimit. Ky dekret u pasua nga një plan veprimi i saktë dhe dy matrica për zbatimin e tyre, duke përcaktuar personat përgjegjës brenda KLSH-së dhe afate fikse për përmbushjen e rekomandimeve. Tani mund të themi se së bashku me ekspertët e binjakëzimit jemi në gjendje të:

- përmirësojmë metodologjinë e auditimit në luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit;
- të rishikojmë dhe përditësojmë manualin e auditimit të performancës, si dhe të trajnojmë intensivisht audituesit tanë në këtë fushë;
- të kompletojmë manualin për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë dhe listat e kontrollit për këtë proces;
- të zhvillojmë më tej qasjen e bazuar në risk në auditimet financiare dhe përputhshmërisë përmes hartimit të planeve vjetore të auditimit për vitin 2017 dhe 2018;
- të zhvillojmë manualin e auditimit IT;
- të zhvillojmë modulet e auditimit IT në trajnimin standard për audituesit tanë;
- të krijojmë Helpdesk;
- të shqyrtojmë Manualet e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë;
- të hartojmë Fjalorin e Termave të Auditimit;
- të ndërtojmë një Plan të Qëndrueshmërisë për atë që do të ndodhë pas Projektit;
- të zbatojmë një skemë për menaxhimin dhe dokumentimin e kohës së punës së auditimit;
- të rishikojmë procedurat dhe praktikat për zhvillimin profesional të audituesve të KLSH;
- të përcaktojmë kompetencat dhe komponentët e dëshiruar për procedurën e certifikimit të audituesve tanë;
- të zhvillojmë procedura trajnimi të vazhdueshme.

Pyetja 6: A mundët të zhvilloni auditime pilote në kohën e zbatimit të projektit?

Së bashku me tetë ekipe të ndryshme të auditimit dhe nën mbikëqyrjen e ekspertëve polakë dhe kroatë, pati një testim pilot të manualeve të auditimit të performancës dhe të auditimit financiar gjatë katër auditimeve të performancës, tri auditimeve financiare dhe një auditimi IT, të zgjedhur nga plani vjetor i

auditimit i KLSH-së për vitin 2017. Ekspertët e binjakëzimit dhanë mbështetje edhe në planifikimin e auditimit, mbledhjen e evidencave të auditimit dhe fazat e raportimit. Ata mbikëqyrën vazhdimisht progresin e punës së ekipeve audituese.

Auditimet pilot testuan procesin e përshkruar në doracakët dhe udhëzimet e përmirësuara dhe identifikuan hendeqet dhe nevojat për përmirësim, duke përfshirë në to shembuj praktikë për t'i bërë ato më specifike dhe relevante për kontekstin shqiptar.

Përvoja e fituar nga audituesit tanë nga auditimet pilot ishte e konsiderueshme. Gjatë zbatimit të projektit u realizuan edhe 6 vizita studimore. Audituesit e KLSH patën mundësinë të përfitonin përvojë nga kolegët polakë dhe kroatë në lidhje me të gjitha fazat e auditimeve të performancës, financiare dhe përputhshmërisë, si dhe në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit, procedurat për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë, politikat për komunikimin e rezultateve dhe rritjen e transparencës, si dhe politikat e burimeve njerëzore që synojnë rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve.

Pyetja 7: Si do ta përdorni në të ardhmen eksperiencën e fituar nga ky projekt?

Mbështetja e BE-së nëpërmjet Projektit të Binjakëzimit na ndihmoi të plotësojmë objektivat e Strategjisë sonë të Zhvillimit 2013-2017. Sidomos, kemi marrë ndihmë substanciale në arritjen e katër prej gjashtë objektivave kryesorë, konkretisht objektivi nr. 1: ndryshimi i bazës ligjore dhe rregullative të KLSH-së në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira evropiane, objektivi nr. 2: ndërtimi i kapaciteteve të auditimit dhe cilësia e auditimit, objektivi nr. 3: rritja e cilësisë dhe numrit të auditimeve të performancës dhe objektivi nr. 4: përdorimi i TI në auditime dhe zhvillimi i auditimeve të TI gjatë 2016-2017.

Merita më e madhe për përmbushjen në masën 80% të objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së, 2013-2017 shkon në Projektin e Binjakëzimit të BE-së IPA 2013. Ne po punojmë për të konsoliduar këto arritje.

Gjatë takimit vjetor të Komitetit të Ndërtimit të Kapaciteteve të INTOSAI (CBC) në qytetin e Kuvajtit më 3-5 Shtator 2018, së bashku me SAI-n polak (NIK), ne paraqitëm përvojën tonë të binjakëzimit para një takimi të përbashkët me Komitetin e Donatorëve.

Falë përvojës së fituar nga Projekti, sidomos në përgatitjen e metodologjisë për hartimin e planeve strategjike dhe vjetore, ne hartuam dhe filluam implementimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018-2022, me ambicien për projektimin e KLSH si një organizatë model për ti shërbyer qytetarëve për vitet që vijnë.

Në përfundim, duke falenderuar revistën e ECA për mundësinë për të prezantuar komunitetin tonë të audituesve të jashtëm publik në Evropë, si dhe Gjykatën Evropiane të Audituesve për mbështetjen e ofruar nëpërmjet programeve të intershipit për audituesit tanë, mund të them se, mbështetja që kemi marrë deri më tani nga BE, na ka ndihmuar së tepërmi në modernizimin e kapaciteteve tona, në konsolidimin e të tashmes dhe projektimin e të ardhmes.

Faleminderit!

Përktheu: Redina KARAPICI, Audituese Departamenti i Autitimit të Performancës

Nga: Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së

2018 GALF - NJË FORUM PËR NJË SHKËMBIM TË SINQERTË DHE TË HAPUR MES LIDERËVE BOTËRORË NË AUDITIMIN PUBLIK

Intervistë me Klaus-Heiner Lehne, President i ECA-s, botuar në nr.5 të ECA, maj 2018

Presidenti i ECA-s Klaus-Heiner Lehne kryesoi takimin dy ditor dhe i kthehet konceptit, përmbajtjes dhe karakteristikave të GALF 2018 dhe këtij forumi për një shkëmbim të nivelit të lartë midis krerëve të organeve të auditimit publik në përgjithësi.

Nga: Gaston Moonen, Drejtoria e Presidencës, ECA

ECA pranon çdo vit shumë vizitorë dhe organizon takime dhe konferenca të shumta. Por takimi i GALF 2018 ishte jo i zakonshëm, sepse në të morën pjesë drejtuesit e auditimit publik nga institucionet e larta të auditimit (SAI) nga pothuajse të gjitha kontinentet. Presidenti i ECA-s, z.Klaus-Heiner Lehne kryesoi takimin dy ditor dhe iu referua konceptit, përmbajtjes dhe karakteristikave të GALF 2018 dhe këtij forumi për një shkëmbim të nivelit të lartë midis krerëve të organeve të auditimit publik në përgjithësi.

GALF si G20 në auditim

Nga entuziazmi i tij, mund të thuhet lehtë që presidenti i ECA Klaus-Heiner Lehne e shikon këtë ngjarje si një takim të këndshëm dhe të frytshëm të GALF 2018 në ECA. Ai shpjegon se GALF është një lloj "G20" për botën e auditimit publik, duke shtuar se një etiketë e tillë mund të mos jetë krejtësisht e saktë. Së paku sepse ka më shumë se 20 anëtarë dhe vendet e përfaqësuara nuk janë identike me ato të G20-ës reale. Për më tepër, koncepti dhe formati nuk janë të njëjta. Është një mundësi për udhëheqësit botërorë në auditimin publik që të takohen dhe diskutojnë çështjet aktuale të interesit të përbashkët. Dhe si GALF-G20, është një forum me të vërtetë global me krerët dhe përfaqësuesit e SAI-ve nga të gjitha anët e botës, nga Australia në Kinë deri në SHBA. Dhe siguristh nga disa vende evropiane.

Presidenti i ECA e konsideron GALF si një mundësi të shkëlqyer për të shkëmbyer ide mbi tema të rëndësishme me krerët e tjerë të SAI-ve nga e gjithë bota. Megjithëse jemi natyrisht një institucion evropian, shohim se shumë çështje kanë rëndësi për SAI-t në nivel global dhe për këtë arsye janë veçanërisht të dobishme për të diskutuar këto çështje në një kontekst global. Ajo ndihmon përtej perspektivës evropiane dhe e sheh atë nga një tjetër këndvështrim. Ai nënvizon se audituesit nuk punojnë në vakum: "Komuniteti i auditimit duhet të ndajë idetë dhe shqetësimet për të mbetur në

të ardhmen dhe të vazhdojë të shtojë vlerën përmes punës së tij në emër të qytetarëve".

Një çështje tjetër që ai e gjen shumë të rëndësishme është vendosja tepër informale dhe numri i kufizuar i pjesëmarrësve. Kjo lejon një diskutim të hapur ku mund të zhvillohen ide të reja. Mbi të gjitha, ky është thelbi i GALF për mua, kjo është një fabrikë idesh; një forum ku krijohen ide të reja për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme, me të cilat do të përballemi sot ose nesër në botën e auditimit publik.

Këtë vit GALF kishte saktësisht 20 pjesëmarrës, dhe përveç kësaj një SAI mori pjesë si një mik - Dhoma e Llogarive të Federatës Ruse. Sa i përket anëtarësimit të GALF, Klaus-Heiner Lehne specifikon se numri i vendeve pjesëmarrëse është i kufizuar dhe se një anëtarësim i ri kërkon pëlqimin e të gjithë anëtarëve. “Ekziston një numër maksimal i vendeve pjesëmarrëse. Kjo është e nevojshme për të ruajtur formatin informal dhe mjaft intim të forumit. Gjithashtu në këtë drejtim, GALF është i ndryshëm nga INCOSAI, Kongresi global i institucioneve më të larta të auditimit të organizuar një herë në çdo tre vjet nga INTOSAI. GALF u krijua për të ofruar një forum ku çështjet e caktuara mund të diskutoheshin në një nivel të lartë, por në një mjedis jo-formal. INCOSAI i shërben një qëllimi të ndryshëm dhe prandaj nuk mund ta ofrojë këtë mundësi. Kjo gjithashtu do të thotë që SAI-t në parim janë të përfaqësuar në nivelin më të lartë.

Të bëhesh mikpritës i një takimi GALF

Për sa kohë që ECA u bë SAI pritës për GALF 2018, Presidenti i ECA shpjegon se çdo SAI pjesëmarrës mund të paraqesë kandidaturën e tij për të pritur GALF-in tjetër. “Dhe kjo është ajo që bëmë gjatë GALF-it të vitit 2017 të organizuar nga SAI danez, Rigsrevisionen. Vendimi që ECA do të organizonte takimin e GALF të këtij viti u mor nga anëtarët. Përvoja ime është që SAI-t që duan të presin takimin e ardhshëm GALF, në mënyrë joformale përpara se çështja të vihet në votim duhet të bien dakord se kush duhet të presë takimin e ardhshëm. Kjo reflekton mirë karakterin konsensual të forumit.

GALF-i i vitit 2017 në Danimarkë ishte në fakt GALF i parë për Klaus-Heiner Lehne, të cilin ai kujton se ishte i organizuar shumë mirë dhe një shembull i mirë se si mund të bëhet. “Ata e vendosën nivelin mjaft të lartë. Atje diskutimet u përqendruan në punën e strategjisë në SAI dhe në vlerësimin e punës së auditimit - dy tema shumë interesante. Qëllimi ynë për vitin 2018 ishte të përmbushnim standardin që ata vendosën por jo ta tejkalojmë atë sa i përket financimit dhe burimeve të tjera. “Ai thekson se ECA, si Danezët, nuk dëshironin që takimi të ishte shumë i shtrenjtë. “Në fund, ne po flasim për paratë e taksapaguesve”.

Sa i përket rezultatit të një takimi të GALF, Presidenti i ECA i referohet asaj

që tha më sipër: "Për mua, GALF duhet të shërbejë si një fabrikë idesh. Pjesëmarrësit duhet t'i marrin këto ide në shtëpi dhe pastaj t'i zbatojnë në SAI-t e tyre në mënyrën dhe në masën që ata e konsiderojnë të nevojshme dhe të dobishme. Ideja e forumit nuk është që të ketë ndonjë rezolutë të detyrueshme ose jo- detyruese në fund. Kjo do të shkatërronte natyrën e saj.

Ndarja e perspektivave dhe praktikave të ndryshme

Duke folur për përmbajtjen e diskutuar në GALF e 5-të, Presidenti i ECA-së është i kënaqur me dy temat e përzgjedhura për GALF 2018. "Ne propozuam dy temat kryesore, pasi u morëm vesh me anëtarët e tjerë të GALF para se ata t'i perceptojnë këto tema. Në fund të fundit, temat duhet të jenë relevante dhe interesante për të gjithë anëtarët. "Ai shpjegon se dy temat e zgjedhura nga ECA: Kryerja e auditimeve të performancës në një kontekst politik: cilat janë kufizimet? në ditën e parë dhe komunikimi i gjetjeve të auditimit në një botë dixhitale: sfidat dhe mundësitë në ditën e dytë - u pritën shumë mirë nga pjesëmarrësit. "Kjo për shembull u tregua edhe nga diskutimet e hapura që kishim në to, me perceptime shumë të ndryshme në temën e parë dhe praktikat e ndryshme në temën e dytë. Më vonë ne konkluduam se pavarësisht nga rreziqet dhe mangësitë e caktuara lidhur me mediat dixhitale dhe sociale, si SAI, ne do të duhet të përdorim këto mjete gjithashtu për të arritur tek palët e interesit dhe publiku i gjerë.

Duke folur për mënyrën sesi mund të shkojmë tëk publiku më i gjerë: ECA si organizata pritëse ka ofruar informacion në lidhje me takimin e GALF 2018 në faqen e saj të internetit përpara, gjatë dhe pas takimit, Klaus-Heiner Lehne e vë këtë në perspektivë: "Aspekti publik nuk është objektivi kryesor i forumit. Nëse pjesëmarrësit mendojnë shumë për vëmendjen e publikut, ata mund të ndalojnë të mendojnë dhe të flasin lirshëm. Çfarë mund të marrë në fund vëmendjen e publikut janë ndryshimet në punën e SAI-ve përkatëse, si rezultat i takimit të GALF".

Duke synuar për diskutime joformale dhe mendime provokuese

Duke kaluar nga takimi i mëparshëm i GALF në atë të GALF 2018, Presidenti i ECA paraqiti një pamje mjaft të balancuar: "Çdo SAI mikpritës i aktivitetit është krejtësisht i lirë si të organizojë takimin".

Karakteri inovativ, veçanërisht i theksuar gjatë takimit të këtij viti në Luksemburg, theksoi Presidenti i ECA. "Formati i përdorur ishte shumë i ndryshëm nga ai i vitit të kaluar. Unë mendoj se ne ishim shumë me fat me moderatorët tanë që bënin një punë të shkëlqyer duke mbajtur diskutimet e gjalla dhe të fokusuara. U jam shumë mirënjohës kolegëve tanë nga Zyra Federale Zvicerane e Auditimit, Michel Huissoud dhe Brigitte Christ, si edhe folësit kryesor, zj. Ann Mettler të Komisionit Evropian dhe z.Jorg Muller-Lietzkoë, profesor në Studimet e Medias

të Universitetit të Paderbornit, të cilët ishin jashtëzakonisht të mirë në nisjen e diskutimeve, duke u dhënë atyre drejtimin e duhur. Por ai gjithashtu nënvizon se në fund, nuk ka nevojë të përsërisni një takim GALF çdo herë. "Gjithashtu ne u përpoqëm të mësonim nga praktikat e mira të organizatorëve të viteve të mëparshme. Për shembull, ne kemi ndërtuar punën e bërë nga kolegët tanë Danezë në lidhje me dokumentet e vendeve të dorëzuar nga SAI pjesëmarrëse paraprakisht".

Presidenti i ECA thekson se ECA dëshiron të ruajë karakterin joformal, duke e mbajtur numrin e pjesëmarrësve në mënyrë të arsyeshme të ulët dhe nivelin e përfaqësuesve të lartë. "Ky takim duhet të mbetet sa më informal për të ruajtur karakterin e tij unik. Si mikpritës, mendoj se është e rëndësishme të mos mbingarkoni takimin me prezantime dhe elemente formale. Diskutimet duhet të jenë të sinqerta dhe të hapura. Dhe ato duhet të moderohen në një mënyrë që i kushton respekt fondit të ndryshëm kulturor, politik dhe rregullator të pjesëmarrësve, në mënyrë që të sigurohet që secili pjesëmarrës të ndjehet i përfshirë dhe i vlerësuar".

Të kërkojmë për shkëmbime të reja në takimet e GALF-it 2019 dhe 2020

Për Klaus-Heiner Lehnet takimi i këtij viti i GALF-it ishte gjithashtu një përvojë shumë e mirë, falë ideve shumë interesante të paraqitura nga kolegët e tij nga e gjithë bota: "Ishte shumë e dobishme që të shikonim temat e diskutuara nga një tjetër kënd dhe kundër backgraundeve të tjera. Në fund, qasjet tona gjithmonë do të jenë evropiane, të testuara dhe të rafinuara në diskutim me njerëz nga vende të tjera të botës ".

Takimi i gjashtë i GALF, vitin e ardhshëm do të organizohet nga Kina, pasuar nga India në vitin 2020. Klaus-Heiner Lehne është i bindur se të dy SAI-t, ai kinez dhe indian do të ofrojnë një takim të përgatitur me diskutime të shkëlqyera, interesante dhe frytdhënëse. "Një tipar i rëndësishëm i GALF është se çdo SAI mikpritës është plotësisht i lirë në organizimin e takimit si në aspektin e përmbajtjes dhe strukturës. Mund të jetë shumë ndryshe nga ajo që bëmë. Mendoj, megjithatë, se në takimin e GALF të këtij viti në ECA, zgjedhja e një numri maksimal të pjesëmarrësve në takimin e GALF dhe nivelin e përfaqësimit, na ndihmoi ne për të siguruar karakterin unik të takimit për të ardhmen".

Përktheu: Xhein Xhindoli, Auditues, Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

Nga: Klaus-Heiner Lehne, President i ECA-s

ROLI I INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIMIT NË PËRMIRËSIMIN E LLOGARIDHËNIES, TRANSPARENCËS DHE INTEGRITETIT NË SEKTORIN PUBLIK

Raport përmbledhës i Konferencës Shkencore organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Bullgarisë, nën Presidencën Bullgare të Këshillit të Bashkimit Evropian

Sofia, 15 Maj 2018

Konferenca e nivelit të lartë "Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në Përmirësimin e Llogaridhënies, Transparencës dhe Integritetit në Sektorin Publik", u organizua nga Zyra Kombëtare Bullgare e Auditimit (BNAO) nën Presidencën Bullgare të Këshillit të Bashkimit Evropian në datën 15 maj 2018, në Pallatin Kombëtar të Kulturës në Sofje.

Në Konferencë morën pjesë kryetarët dhe përfaqësuesit e 26 Institucioneve Supreme të Auditimit Evropian (SAI), duke përfshirë 19 Shtete Anëtare të BE-së dhe Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA).

Konferenca u nda në 4 panele dhe një forum diskutimi. Në secilin prej paneleve, SAI-e të Shteteve Anëtare të BE-së ndanë praktikat dhe arritjet më të mira në një fushë dhe SAI-e të vendeve kandidate dhe potencial kandidate për BE paraqitën pikëpamjet mbi sfidat me të cilat ballafaqohen.

Qëllimi i Konferencës ishte që SAI-t e Shteteve Anëtare të BE-së, SAI-t e vendeve kandidate dhe potencial-kandidate për në BE, të ndajnë përvojat dhe praktikat kryesore në zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë në sektorin publik - llogaridhënien, transparencën dhe integritetin. Kjo

qeverisje është e fokusuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe në justifikimin e besimit të tyre në institucionet.

Hapja e Konferencës nga Z. Tzvetan Tzvetkov, Kryetar i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Bullgarisë

Konferenca u hap nga z. Tzvetan Tzvetkov, Kryetar i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Bullgarisë dhe kryesues i takimit. Ai theksoi se Republika e Bullgarisë është e bindur për perspektivën evropiane të fqinjëve të saj në rajon dhe mbështet përpjekjet e tyre për të zbatuar reformat. Reformat që po bëhen për qytetarët e këtyre vendeve janë bërë jo vetëm për të përmbushur kërkesat për anëtarësim në BE.

Institucionet Supreme të Auditimit të vendeve kandidate të BE dhe vendeve kandidate të mundshme nuk janë vetëm një vëzhgues i paanshëm i procesit të para-aderimit. Ata kanë një rol kyç për vlerësime të pavarura të reformave të kryera nga qeveritë, si dhe rekomandime për intensifikimin e përpjekjeve dhe punës së institucioneve. Në këtë mënyrë, Institucionet Supreme të Auditimit janë një nga forcat lëvizëse pas proceseve të rëndësishme në lidhje me zbatimin e reformave në vendet e tyre dhe po bëhen "garant" që këto reforma të arrijnë qëllimin e tyre.

Zyra Kombëtare Bullgare e Auditimit mbështet përpjekjet e kolegëve të saj nga rajoni për t'u zhvilluar më tej si SAI moderne dhe për të qenë "garantues" për rritjen e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit në sektorin publik.

Qeverisja e mirë e burimeve publike, parimet themelore të të cilave janë përgjegjshmëria, transparenca dhe integriteti, është një nga kushtet kryesore për një të ardhme më të mirë dhe më të sigurt për qytetarët e BE.

Përgjegjshmëria nënkupton se shpenzimet nuk bëhen thjesht në përputhje me legjislacionin, por për të sjellë përfitime reale për shoqërinë, siç janë arsimi cilësor, shërbimet e kujdesit shëndetësor, transportit dhe shërbimet administrative.

Transparenca nënkupton që shoqëria është informuar me kohë në lidhje me rezultatet e punës së institucioneve - nëse ata përmbushin detyrimet e tyre ligjore, si i menaxhojnë buxhetet e tyre, si i mbrojnë interesat e qytetarëve.

Integriteti është një tjetër faktor kyç për efektivitetin e institucioneve, sepse qeverisja e mirë bazohet jo vetëm në rregulla dhe procedura, por edhe në vlerat e përbashkëta etike në të cilat SAI-t besojnë dhe i zbatojnë në punën e

tyre - ndershmëri, objektivitet dhe kompetencë.

Përmirësimi i qeverisjes dhe llogaridhënies në sektorin publik është i pamundur nëse SAI nuk e kupton rolin e saj si organizatë model. Që të jetë me të vërtetë një model dhe një shembull i qeverisjes së mirë, SAI duhet të ketë pavarësinë e nevojshme institucionale, e cila do të sigurohet jo vetëm me kushtetutë, por edhe financiarisht, në mënyrë që të jetë në gjendje të kryejë punën e saj në mënyrë objektive, profesionale dhe të paanshme.

Misioni i SAI-t modern është të kryejë auditime jo vetëm për të kontrolluar përputhshmërinë me legjislacionin, por edhe për të përcaktuar nëse fondet shpenzohen në mënyrë efektive dhe eficiente, pasi objektivi kryesor është të përcaktojë nëse janë arritur rezultatet e planifikuara.

Për të përmbushur kompetencat e tyre, SAI duhet të ketë kapacitet adekuat administrativ. Kjo nënkupton që SAI-t të kenë një sistem funksional të menaxhimit të burimeve njerëzore në mënyrë që të sigurojnë punonjës të kualifikuar, të motivuar dhe të ndershëm.

Në ditët e sotme, SAI-t moderne po përballen me një sfidë tjetër - për t'u transformuar në Institucione të Larta të Auditimit të shekullit të 21-të që përshtaten me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe që po përdorin teknologjitë për të lehtësuar dhe përmirësuar aktivitetet e tyre. Kjo nënkupton dixhitalizimin e punës së auditimit, zbatimin e produkteve moderne të softwerit dhe zgjidhjeve të TI-së për kryerjen e auditimeve.

SAI duhet të marrë parasysh pritshmëritë e palëve të interesit dhe të ketë bashkëpunim dhe komunikim të mirë me ta në mënyrë që ata të mund të pajisen me informacione objektive për gjendjen e sektorit publik, sepse informacioni objektiv është thelbësor për gjenerimin e ndryshimeve pozitive.

Gjatë viteve, ne gjithashtu kemi kuptuar se nuk është e rëndësishme vetëm të kemi rregulla dhe procedura të duhura, por edhe një sistem vlerash në të cilin ne besojmë duke zbatuar parimet e integritetit dhe etikës. Për më tepër, ky sistem vlerash duhet të ndahet në mënyrë që të ndërtohet qeverisja e mirë.

Në përfundim, Z. Tzvetkov theksoi në sloganin e Presidencës bullgare - "Të bashkuar qëndrojmë të fortë", që është një shprehje e të kuptuarit të një të ardhme të përbashkët europiane dhe solli në vëmendje të gjithë citatin e z.Stefan Stambolov, një burrë shteti dhe autor i Aktit të parë të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Bullgarisë: "Të bashkuar ne qëndrojmë të fortë dhe forca ruan pavarësinë". Kjo sipas nesh është formula që Institucionet e Larta të Auditimit të jenë të suksesshëm.

Fjala e mirëseardhjes nga Znj. Lilyana Pavlova, Ministre për Presidencën Bullgare të Këshillit të BE-së 2018

Znj. Lilyana Pavlova, Ministre e Presidencës Bullgare të Këshillit të BE-së 2018, i përshëndeti pjesëmarrësit dhe theksoi se SAI-të nuk janë armiqtë, nga të cilët qeveritë duhet të kenë frikë, por një partner që i ndihmon ata të përshtatin strukturat e tyre dhe t'i bëjnë ato që të funksionojnë duke respektuar rregullat dhe ligjet. Ministria Pavlova gjithashtu vuri në dukje se kjo konferencë është një pjesë e rëndësishme e Kalendarit të Presidencës bullgare, për shkak të rolit aktiv të SAI-ve në integrimin e Ballkanit Perëndimor.

Shkëmbimi i përvojave ndërmjet SAI-ve të Shteteve Anëtare të BE-së, Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë është një proces i rëndësishëm për rregulla më të mira dhe shfrytëzim të burimeve. Stabiliteti dhe besimi në administratën publike, integriteti dhe epërsia e ligjit janë të pamundura pa institucionet e auditimit.

Ministria Pavlova gjithashtu paraqiti një video të shkurtër mbi atë që është bërë deri më tani gjatë Presidencës bullgare, me fokus kryesor - perspektiva e BE-së për Ballkanin Perëndimor. Në këtë raport, ajo i njohu shumë përpjekjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Bullgarisë për të organizuar një konferencë të përbashkët në Sofje, në të cilën do të takoheshin Udhëheqësit e SAI-ve të Shteteve Anëtare të BE-së dhe Kryetarët e SAI-ve të Ballkanit Perëndimor dhe të Turqisë. Zonja Pavlova përmblodhi shkurtimisht fokusimet e tjera të Presidencës bullgare lidhur me debatin për të ardhmen e Evropës, të rinjtë dhe kuadrin financiar shumëvjeçar.

Fjalimi përshëndetës i Znj. Mariya Ilieva, Kryetare e Nën-komitetit të Llogaridhënies në Sektorin Publik në Komisionin e Buxhetit dhe Financave të Asamblesë Kombëtare të Republikës së Bullgarisë

Znj. Mariya Ilieva, Kryetare e Nën-komitetit të Llogaridhënies në Sektorin Publik në Komisionin e Buxhetit dhe Financave të Asamblesë Kombëtare të Republikës së Bullgarisë,përshëndeti pjesëmarrësit e Konferencës dhe uroi Zyrën Kombëtare të Auditimit të Bullgarisë për organizimin e një evenimenti të tillë në kuadër të Kalendarit të punimeve të Presidencës bullgare. Znj. Ilieva theksoi se

Parlamenti është veçanërisht i interesuar për bashkëpunimin e mirë me Zyrën Kombëtare të Auditimit. Raportet e auditimit janë një burim i besueshëm informacioni mbi gjendjen e sektorit publik. Kjo ndihmon Asamblenë Kombëtare në procesin e vendimmarrjes legjislative dhe në ushtrimin e kontrollit parlamentar.

Ajo theksoi bashkëpunimin e mirë që ekziston midis BNAO dhe Parlamentit Bullgar dhe e ilustroi atë me shembuj të auditimeve të caktuara për BNAO dhe ndikimin e tyre - eficiencën dhe efektivitetin e mbikëqyrjes bankare, Aeroportin e Sofjes EAD, Qendrën e Mobilitetit Urban të EAD, si dhe auditimin e shpenzimeve/ transfertave shtesë në buxhetet e shpenzuesve të buxhetit të nivelit të parë. Znj. Ilieva theksoi se Zyra Kombëtare Bullgare e Auditimit është e pavarur në përmbushjen e përgjegjësive të saj.

Fjalimi kyç i z. Klaus-Heiner Lehne, kryetar i Gjykatës Europiane të Audituesve

Në fjalimin e tij kryesor, z. Klaus-Heiner Lehne, Kryetar i ECA-s, theksoi rëndësinë e konferencës së nivelit të lartë për një çështje kaq të rëndësishme, perspektivën dhe lidhshmërinë europiane të Ballkanit Perëndimor, dhe përmendi bashkëpunimin e shkëlqyeshëm midis ECA dhe Presidencës Bullgare, qysh në fillim të Presidencës, kur Ministria Pavlova vizitoi ECA për të paraqitur prioritetet e Presidencës Bullgare.

Shkëmbimi i praktikave të mira midis SAI-ve të Shteteve Anëtare dhe atyre të vendeve kandidate është shumë tema e konferencës, shtoi z. Lehne dhe shprehu mirënjohjen e ECA-s ndaj Zyrës Kombëtare të Auditimit të Bullgarisë për ofrimin e mundësisë për të marrë një perspektivë të qartë nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

Z. Lehne paraqiti rezultatet dhe konkluzionet kryesore nga një numër raportesh të veçanta që ECA ka publikuar në vitet e fundit në lidhje me shpenzimet e BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe një raport sintezë lidhur me prokurimin publik në Ballkanin Perëndimor.

Z. Lehne ndau edhe pikëpamjet e tij mbi disa nga temat kryesore të konferencës:

Pavarësia institucionale - SAI-t janë kujdestarë të financave publike dhe interesave të qytetarëve - duke theksuar ato gjëra që shkojnë mirë dhe ato që nuk kanë funksionuar siç duhet, që do të thotë: zgjedhje e lirë e temave të auditimit, konkluzionet dhe rekomandimet të hartohen pa presion të jashtëm.

Qeverisja e mirë në sektorin publik - thelbësore për besimin e qytetarëve në

institucionet e tyre; SAI-t duhet të udhëheqin nëpërmjet shembullit, duke qenë një organizatë model për qeverisje të mirë; roli i tyre si audites nuk duhet të jetë vetëm identifikimi i dobësive por edhe shkëmbimi dhe shpërndarja e praktikave të mira për llogaridhënie, transparencë dhe integritet më të madh në të gjithë sektorin publik.

Komunikimi me palët e interesuara, veçanërisht me qytetarët - sot SAI-t po përballen me një sfidë dhe ndryshim të mjedisit politik, ekonomik, teknologjik dhe social dhe ata duhet t'u përgjigjen në kohë këtyre realiteteve të reja, gjë që çon në nevojën e zhvillimit të një strategjie solide komunikimi me palët e interesuara në një botë gjithnjë e më shumë të digjitalizuar; roli i SAI-ve është të sigurojnë dhe shpërndajnë informacion të qartë, të besueshëm dhe të paanshëm për rezultatet e aktivitetit të tyre.

Përmbledhje e çështjeve kyçe të trajtuara në këtë event

Paneli I: Pavarësia Institucionale - Faktori kyç për Efektivitetin e SAI

Z. Wolfgang Wiklicky, Drejtor i Përgjithshëm në Gjykatën Austriake të Auditimit, vuri në dukje se vetëm institucionet e pavarura të Auditimit të Lartë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e eficiencës, llogaridhënies, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike - faktorë, të cilët gjithashtu ndihmojnë në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Për fat të keq, rezultatet e Anketës Globale të INTOSAI-t në vitin 2017 mbi performancën dhe kapacitetet e SAI-ve kanë zbuluar se ka disa zhvillime shqetësuese në lidhje me pavarësinë e SAI-ve dhe theksojnë se gjendja e pavarësisë së SAI-ve është duke u përkeqësuar në krahasim me vitet e kaluara - pavarësia për 56% të SAI është në rrezik; ligjvënësi mbikëqyr zbatimin e buxhetit për 46% të SAI-ve; 75% e SAI-ve vuajnë nga ndërhyrje; më shumë se 50% e buxheteve të miratuara për SAI-t nuk korrespondojnë me nevojat e tyre; 27% e SAI-ve nuk mund të publikojnë asnjë raport; 31% e tyre përballen me kufizime në lidhje me publikimin e raporteve; 48% e SAI-ve nuk mund të mbajnë ndonjë seancë publike për të shqyrtuar auditimin e tyre; 18% nuk kanë liri të plotë për të vendosur mbi përmbajtjen dhe kohën e raporteve të tyre të auditimit. Z. Wiklicky gjithashtu shtoi se INTOSAI dhe SAI kanë ndërmarrë një sërë masash për përmirësim, siç është qasja e Kombeve të Bashkuara duke kërkuar mbështetjen e Shteteve respektive ose nisjen e programeve ndërgjegjësuese lidhur me rëndësinë e SAI-ve të pavarura në të mirë të qytetarëve.

Z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së (ALSAI), bëri një prezantim mbi sfidat me të cilat është përballuar KLSH, pasi ka filluar luftën për pavarësinë e saj - nga debatet në Kuvend, përmes analizës SËOT bazuar në pavarësinë institucionale, deri në miratimin e Ligjit të KLSH-së në nëntor të vitit 2014. Z. Leskaj kujtoi fjalët frymëzuese të ish-Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI, Dr Josef Moser, se *"Pavarësia e SAI-ve është një gur themeli për funksionimin e Shteteve. Ajo forcon parlamentet në funksionet e tyre të mbikëqyrjes dhe kontrollit dhe është e garantuar vetëm nëse bazohet në ligj dhe sanksionohet në Kushtetutë ".*

Paneli II:Në rrugëtimin e auditimeve të orientuara drejt vlerës

Kryetari i Zyrës Supreme të Kontrollit të Republikës së Çekisë, z. Miloslav Kala, prezantoi qasjet e reja përputhje me kërkesën sociale për kryerjen e aktiviteteve të auditimit që nxisin administratën publike të jetë efektive dhe përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve në të gjitha fushat e zhvillimit të qëndrueshëm. Ka specifika rajonale që shpjegojnë pse disa tema janë më të rëndësishme se të tjerat. Kjo, megjithatë, nuk përjashton bashkë-punimin aktiv ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit, të cilat duhet të bazohen në parimet që mbështesin efektivitetin e një aktiviteti të tillë.

Z. Duško Pejović, Kryetar dhe Auditor i Përgjithshëm i Institucionit Shtetëror të Auditimit të Serbisë, theksoi se Institucionet Supreme të Auditimit shërbejnë si shtylla të rëndësishme të sistemeve demokratike kombëtare dhe luajnë një rol kyç në forcimin e performancës së sektorit publik, duke theksuar parimet e qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies. Duke marrë parasysh interesin e shtuar të aktorëve të jashtëm dhe të brendshëm dhe shtrirjen e fushëveprimit të shërbimeve të auditimit të siguruara nga SAI, ka një sfidë në rritje për të treguar vlerat dhe përfitimet e SAI-ve. Përgjigjja ndaj reagimit ndaj mjedisit në ndryshim dhe pritshmërive të palëve të interesit është një faktor kyç në krijimin e një ndryshimi pozitiv në jetën e qytetarëve.

Forumi i diskutimeve: SAI – Të qenurit një organizatë model për qeverisje të mirë

Znj. Tytti Yli-Viikari, Auditori i Përgjithshëm i Finlandës, vuri në dukje se Institucionet Supreme të Auditimit aktualisht po përmirësojnë kapacitetin e tyre për të ofruar informacione të përshtatshme dhe në kohë të auditimit. Për të reaguar ndaj ndryshimeve të shpejta në mjedisin operativ, janë duke u zhvilluar kompetenca të reja. Për të ardhmen e SAI-ve, bashkëpunimi me SAI-t e tjera dhe palët e interesuara është jetik. Rrjetet kombëtare dhe globale janë platforma që na ndihmojnë të ndërtojmë kompetenca kyçe dhe të zhvillojmë praktika të reja.

Seyit Ahmet Baş, Kryetar i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, theksoi se qeverisja e mirë mund të përkufizohet si përmbushje e nevojave në një mënyrë prioritare, duke marrë parasysh preferencat publike dhe kryerjen e shërbimeve publike në mënyrë efektive, ekonomike dhe eficiente në përputhje me standardet etike, parimet dhe llogaridhënien. Kontributi më i madh i SAI-ve në sigurimin e qeverisjes së mirë bëhet duke forcuar transparencën dhe llogaridhënien në përmbushjen e shërbimeve dhe proceseve të vendimmarrjes dhe duke paraqitur shkeljet në Parlament dhe publik. Në përputhje me këto parime, Gjykata Turke e Llogarive, e cila është një entitet kushtetues, kryen aktivitetet e saj me qëllim të paraqitjes së informacionit të besueshëm dhe të mjaftueshëm tek Asambleja e Madhe Turke dhe publiku në lidhje me rezultatet e veprimtarisë së administratës publike.

Në fjalën e tij, z. Tomaž Vesel, kryetar i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë, u përqendrua në mënyrat për të arritur qeverisjen e mirë të SAI-t. Ai ngriti çështjen e SAI-ve "shumë të forta", ato që janë subjekt i një interesi të madh publik dhe të cilat janë adresuar për pjesëmarrje në debatet publike, duke përfshirë edhe ato politike. Kjo, nga ana tjetër, mund të dëmtojë objektivitetin e tyre. Një tjetër çështje që zoti Vesel theksoi ishte rekrutimi, investimi dhe mbajtja e stafit profesional për të siguruar punë të

qëndrueshme të auditimit. Ai gjithashtu theksoi kontributin e mundshëm të SAI-ve në jetën publike. SAI-t nuk do të jenë vetëm kritike ndaj çështjeve të kaluara, por duhet dhe duhet gjithashtu të jenë të orientuara drejt vizionit dhe qëndrueshmërisë. Institucionet e auditimit duhet të shohin përtej asaj që është aktualisht në agjendën e qeverive dhe të përpiqen të parashikojnë për shembull problemet financiare që mund të lindin në të ardhmen.

Z. Vesel tha gjithashtu se Gjykata e Auditimit të Sllovenisë përqendrohet në çështje me rëndësi relevante për shoqërinë, veçanërisht në kontekstin e proceseve demografike që lidhen me plakjen e popullsisë, ndryshimet në strukturën demografike dhe migracionin.

Z. Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm i Kosovës*, deklaroi se roli i Institucioneve Supreme të Auditimit nuk ka qenë kurrë më i rëndësishëm se sa është sot. Ai theksoi parimet kryesore ku qeverisja e mirë është ndërtuar - pavarësia, integriteti dhe besimi. Z. Osmani gjithashtu vuri në dukje disa nga aktivitetet e SAI-t lidhur me zbatimin e procedurave të kontrollit të cilësisë - bashkëpunimi me universitetet, jo vetëm për të rritur cilësinë e raporteve të auditimit, por edhe për të rritur ndikimin e punës së SAI-t në jetën publike të vendit, parandalimin e konfliktit të interesave dhe mbajtjen dhe zhvillimin e aftësive profesionale të nevojshme për të kryer përgjegjësitë e auditimit.

Paneli III: Kapaciteti administrativ Modernizimi i SAI-ve - Shembull i Qeverisjes së Mirë në Sektorin Publik

Z.Krzysztof Kwiatkowski, Kryetar i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, deklaroi se Institucionet Supreme të Auditimit duhet të lëvizin nga SAI-t e monologut tek SAI-t e dialogut. Një sfidë e rëndësishme me të cilën përballen Institucionet Supreme të Auditimit është detyrimi për të komunikuar vazhdimisht me shoqërinë - për të siguruar informacion të besueshëm mbi punën e qeverisë dhe efektet e tij, të kuptueshme për opinionin publik. Ky objektiv kryesor mund të arrihet duke fokusuar auditimet e planifikuara dhe të kryera tashmë në problemet reale; si të shtetit ashtu edhe të shoqërisë, dhe vazhdimisht përmirësimin e performancës së SAI-ve.

Z. Naser Ademi, Zëvendës Auditori i Përgjithshëm i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe z. Sasho Jakovchevski, Zëvendës Shef i Auditimit të TI-së, bënë një prezantim mbi sfidat për modernizimin e kapaciteteve administrative të SAO. Z. Jakovçevski prezantoi Sistemin e Menaxhimit të Auditimit (AMS) dhe vuri në dukje se ofron qasje të standardizuar të auditimit dhe qasje të shpejtë e të lehtë në dosjet e kontrollit me monitorimin online / real në kohë të përfundimit të aktiviteteve të planit të auditimit; AMS gjithashtu ofron mundësinë e shkëmbimit të njohurive (të mësuarit nga përvoja) në mesin e audituesve, duke siguruar qasje në informacionet në dispozicion nga auditimet e mëparshme dhe aktuale.

Paneli IV: Komunikimi me palët e interesuara dhe rritja e besimit të qytetarëve

Mr. Peter Kinsley, Z. Peter Kinsley, Zëvendës Drejtor i Auditimit në Zyrën e Kontrollorit dhe Auditorit të Përgjithshëm të Irlandës, paraqiti një prezantim mbi temën "Këndvështrimi i palëve të interesuara" dhe ndau përvojën e SAI të Irlandës në komunikimin me palët e interesuara. Ajo që Zyra e Kontrollorit dhe Auditimit të Përgjithshëm të Irlandës po synon të arrijë me punën e tij është t'i shtojë vlerë organizatave që auditon. Duke paraqitur rekomandime që ndihmojnë jo vetëm në performancën e tyre individuale, por gjithashtu të identifikojnë praktikat e mira që janë të zbatueshme në të gjithë shërbimin publik. SAI i Irlandës gjithashtu synon të mbështesë procesin përmes të cilit Parlamenti përmes Komitetit të Llogarive Publike i mban organet publike përgjegjëse për përdorimin e këtyre burimeve publike.

Në përfundim, Z. Kinsley shtoi se është ende e rëndësishme që SAI të jetë i i qartë në komunikimin e tij dhe konstruktiv në mënyrën se si komunikon.

Z. Hayo van der Wal, Këshilltar i Lartë Ndërkombëtar i Gjykatës Holandeze të Auditimit, paraqiti prezantim me temë "Besimi në bazë të Mirëkuptimit - Komunikimi me palët e interesuara dhe rritja e besimit

të qytetarëve". Ai theksoi shembuj nga Holanda dhe vende të tjera, si dhe tërhoqi vëmendjen e pjesëmarrësve në aktivitetet e EUROSAI dhe interesin e përbashkët të të gjitha SAI-ve. Ai vuri në dukje se vetëm më shumë transparencë do të çojë në njohuri, e cila do të çojë në mirëkuptim, e cila nga ana e saj do të çojë në besim nga publiku i gjerë. SAI-t kanë një rol të rëndësishëm në sigurimin e transparencës dhe të të kuptuarit, për sa kohë që veprojnë në emër të popullit.

Z. Milan Dabović, Kryetar i Institucionit Shtetëror të Revizionit të Malit të Zi, theksoi se rëndësia e bashkëpunimit midis institucionit të lartë të auditimit dhe Parlamentit është reflektuar mbi të gjitha në faktin se ata së bashku bëjnë një sistem të balancuar të llogaridhënies së qeverisë. Përmes punës së tij profesionale, institucioni suprem i auditimit përfaqëson një partner të rëndësishëm në Parlament dhe kontributi i tij është i pazëvendësueshëm.

Mesazhet kryesore, rezultatet dhe rekomandimet:

- *Vetëm SAI-t e pavarura mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e eficiencës, llogaridhënies, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike.*
- *Pavarësia e SAI-ve është një gur themeli për funksionimin e shteteve. Ajo forcon parlamentet në funksion të mbikëqyrjes dhe kontrollit dhe është e garantuar vetëm nëse është bazuar në ligj dhe e sanksionuar në Kushtetutë.*
- *Buxheti dhe pavarësia financiare e SAI-ve, si dhe korrelacioni joproporcional ndërmjet rritjes së kompetencave të tyre dhe burimeve të tyre financiare janë çështjet kryesore që kufizojnë aktivitetet e SAI-ve.*
- *Është e nevojshme të zhvillohen programe ndërgjegjësimi lidhur me rëndësinë e SAI-ve të pavarura që veprojnë në dobi të qytetarëve.*
- *Një nga praktikat më të mira të disa shteteve anëtare të BE-së lidhur me menaxhimin e marrëdhënieve midis SAI-ve dhe Parlamentit është ekzistenca e një organi parlamentar të dizajnuar për t'u marrë me Institucionet Supreme të Auditimit.*
- *Shkëmbimi i informacionit dhe të dhënave të auditimit ndërmjet SAI-ve*

do të jetë në dobi jo vetëm për institucionet e auditimit, por gjithashtu do të kontribuojë në ndryshime pozitive në të gjithë sektorin publik.

- *Cilësia e raporteve të auditimit ndikon sa mirë Parlamenti,të audituarit, mediat dhe qytetarët mund të përdorin gjetjet dhe rekomandimet e auditimit.*
- *SAI mund të sigurojë besimin e qytetarëve duke paraqitur në Kuvend raportime të qarta, të balancuara dhe të bazuara në dëshmi dhe për çështjet që mund të çojnë në përmirësime dhe që mund të ndihmojnë për shfrytëzimin më të mirë të burimeve publike.*
- *Është e rëndësishme që SAI të jetë i qartë në komunikimin e tij dhe konstruktiv në mënyrën se si komunikon.*
- *Rekrutimi i personelit të aftë profesionalisht dhe mbajtja e tij është e rëndësishme për të siguruar aktivitete të qëndrueshme të auditimit.*
- *Nuk është e rëndësishme vetëm të kemi rregulla dhe procedura të duhura, por edhe të ndahen vlerat dhe të zbatohen parimet e integritetit dhe etikës.*
- *Në kohën e zhvillimit të shpejtë të teknologjisë, SAI-t moderne po përballen me sfidën e digjitalizimit të punës së tyre të auditimit duke futur produkte të avancuara (sofware)dhe zgjidhje IT për të kryer auditime.*

Përktheu : Eni Kabashi, Audituese

Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qëndrore

SKEPTICIZMI PROFESIONAL ESENCIAL PËR NJË AUDITIM CILËSOR

Skepticizmi nuk është thjesht dhe vetëm në qendër të auditimit, në të vertete ai është pjesë e vetvetishme e brendshme e shumicës së audituesve. Një fakt i tillë nuk është shumë i dukshëm për palët e treta, po të mbajmë parasysh që këto palë nga njëra anë kërkojnë qe audituesit të jene më shumë skeptike, pra të rrisin dyshimin e tyre, dhe nga ana tjetër bëjnë presion ndaj tyre për të përmbushur deadline-et dhe për të kryer auditimin brënda buxheteve financiare te shtrënguara. Pikërisht, këto sjellje të stakeholdersve e bëjnë auditimin një sfide të vërtetë.

Nga: Prof.Dr.Hysen Çela, Kryetar, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA)

Hyrje

Audituesit e jashtëm gjatë angazhimit të tyre në auditimin e pasqyrave financiare dhe të informacioneve të tjera financiare historike, i përmbahen gjithmonë kërkesave të standardeve teknike e profesionale. Këto standarde kërkojnë që prej tyre, në çdo rast të ndiqen të gjitha procedurat e duhura dhe të zbatohet skepticizmi profesional, e veçanërisht e theksuar kjo në çështjet komplekse të ushtrimit të gjykimit profesional. Janë të shumtë audituesit me eksperience, të cilët asnjëherë nuk e humbasin dëshirën për të pyetur për shifrat që përfshihen në pasqyrat dhe në raportet financiare. Tundimi për të pyetur se mbi çfarë baze janë llogaritur shifrat dhe nevoja për t'u siguruar që ato janë ashtu siç duhet të jenë, bëhet në mënyrë të natyrshme pjesë e sjelljes së tyre profesionale.

Skepticizmi nuk është thjesht dhe vetëm në qendër të auditimit, në të vertete ai është pjesë e vetvetishme e brendshme e shumicës së audituesve. Një fakt i tillë nuk është shumë i dukshëm për palët e treta, po të mbajmë parasysh që këto palë nga njëra anë kërkojnë qe audituesit të jene më shumë skeptike, pra të rrisin dyshimin e tyre, dhe nga ana tjetër bëjnë presion ndaj tyre për të përmbushur deadline-et dhe për të kryer auditimin brënda buxheteve financiare te shtrënguara. Pikërisht, këto sjellje të *stakeholdersve* e bëjnë auditimin një sfide të vërtetë.

Ndonëse konceptet për skepticizmin profesional janë relativisht të thjeshta e pothuaj të drejtpërdrejta, në praktikën e përditshme, kjo çështje gjen trajtime të ndryshme, kryesisht për shkak të mungesës sa të një kuptimi të përbashkët aq edhe të mungesës së udhëzimeve praktike mbi atë se çfarë është skepticizmi profesional dhe si duhet të zbatohet e dokumentohet ai në praktiken e auditimit.

1. Një përkufizim për skepticizmin profesional

Fjala skepticizëm rrjedh nga fjala "skeptik", e cila vjen nga greqishtja e vjetër, "skeptikos", dhe ka kuptimin "kureshtje ose reflektim". Kureshtje do të thotë "të kërkosh informacion duke pyetur; d.m.th.. të pyesësh”. Tiparet që zakonisht lidhen me të qënurit skeptikë përfshijnë marrjen në pyetje dhe vëzhgimin e kujdesshëm, të kërkuarit përtej asaj që duket dhe shmangien e besimit të tepërt apo të paprovuar. Skepticizmi në një mjedis profesional përfshin qëndrimin dyshues dhe mosbesues, që bazohet në një standard të kujdesit dhe nënkupton kujdesin e duhur në kontekstin e standardeve profesionale, rregullave, mbikëqyrjes, proceseve, negocimit, mbledhjes dhe vlerësimit të evidencës, gjykimit profesional, transaksioneve komplekse të biznesit, stimujve dhe motiveve të ndryshme, racionalizimit, etj. Standardi Ndërkombëtar i Auditimit i IAASB-së,- SNA 200 kërkon përdorimin e skepticizmit profesional si një mjet për të përmirësuar aftësinë e audituesit për të identifikuar rreziqet e anomalisë materiale dhe për të reaguar ndaj rreziqeve të vlerësuara. Sipas po këtij standardi, një auditim i cili kryhet pa një qëndrim profesional skeptik nuk ka të ngjare të jetë një auditim cilësor. Tre elementet përbërës të skepticizmit profesional (i) atributet e audituesit, (ii) mendësinë/te e të menduarit të audituesit dhe (iii) veprimet e audituesit - përshkojnë të gjithë procesin e auditimit dhe janë pjesë përbërëse e cilësisë së auditimit.

Në mënyrë te sintetizuar skepticizmin profesional do ta përkufizonim si një qëndrim që përfshin të menduarit dyshues, të qenurit vigjilent (alert) ndaj kushteve, që mund të tregojnë për anomali të mundshme për shkak të gabimit ose mashtrimit dhe një vlerësim kritik të evidencës se auditimit.

2. Lidhja midis gjykimit dhe skepticizmit profesional

Skepticizmi profesional është shumë i domosdoshëm për një gjykim profesional cilësor. Megjithatë, ai është vetëm njëri nga komponentët që e ndihmon audituesin apo një profesionist të fushës, të ushtrojë gjykime të shëndosha profesionale. Për shembull, pavarësisht faktit që një profesionist mund të jetë skeptik, vetëm kjo nuk mjafton që profesionisti të bëjë gjykime cilësore dhe të marrë vendimet e duhura. Pra një gjykim profesional

kërkon përveç skepticizmit edhe ekspertizën e nevojshme kontabël dhe të auditimit si dhe eksperiencën praktike. Në këtë kuptim, skepticizmi mund të konsiderohet si një instrument për të iniciuar gjykimin profesional, ndonëse ky i fundit ka nevoje për më shume instrumente, ku përfshihen njohuritë, zotësitë dhe mënyrat racionale të trajtimit të problemeve.

Literatura akademike e fushës, por edhe standardet përkatëse të kontabilitetit dhe auditimit i referohen skepticizmit me fjalët "të menduarit dhe vlerësimi kritik" lidhur me evidencën e auditimit. Por, terma të tilla si "të menduarit kritik" dhe "vlerësimi kritik i provave të auditimit" janë disi të paqartë dhe lënë vend për interpretim, sidomos kur lind nevoja të analizohen dhe definohen se cilat janë nivelet e përshtatshme të mendimit dhe vlerësimit kritik. Gjithashtu, kjo paqartësi rritet kur vlerësohet mënyra se si kjo sjellje skeptike është demonstruar dhe dokumentuar në sfondin e rreziqeve të ndryshme në nivele të pohimeve për shumat në pasqyrat financiare, klasat e transaksioneve apo informacionet e dhëna në shënimet shpjeguese të pasqyrave. Literatura e auditimit përshkruan perspektiva të ndryshme të skepticizmit profesional. Pamja dyshuese duket në përputhje me kërkesat specifike që parashikojnë standardet e auditimit, d.m.th. supozimi se ekzistojnë rreziqe të konsiderueshme të mashtrimit, për shembull, në njohjen e të ardhurave pavarësisht përvojës së mëparshme në auditimin e të ardhurave të një entiteti dhe pavarësisht kompetencës dhe integritetit të individëve të emëruar në organet e drejtimit. Dyshimi i vazhdueshëm në këtë drejtim supozon se mund të ekzistojë një shkalle pakujdesie, paaftësie ose pandersh-mërie tek hartuesit e informacioneve financiare historike. Shumë fusha në standardet e auditimit duket se kanë një perspektivë neutrale. Për shembull, "audituesi as nuk supozon se drejtimi është i pandershëm dhe as nuk pranon ndershmërinë e tij të padiskutueshme". Me një qasje të tillë, audituesi vlerëson evidencën e grumbulluar me kujdes dhe objektivitet, por jo domosdoshmërisht duke supozuar se patjetër kemi të bëjmë me pakujdesi të drejtimit, paaftësi apo mashtrim.

Si përfundim mund të themi se performanca e gjykimit profesional ndihmohet nga skepticizmi profesional, dhe realizohet përmes aftësisë, njohurive dhe motivimit të audituesit duke mbajtur gjithnjë parasysh mjedisin në të cilin realizohet gjykimi.

3. Një fokus më i shtuar në skepticizmin profesional

Në kushtet e një ekonomie që tenton drejt globalizimit, kur marrëdhëniet midis entiteteve nga juridiksione të ndryshme bëhen të natyrshme, transaksionet e biznesit kanë prirjen të jenë gjithnjë e më komplekse. Është

pikërisht ky kompleksitet në rritje, i cili ka ndikuar edhe në standardet e raportimit financiar, të cilat kanë prirjen gjithashtu të sofistikohen. Një rol jo të vogël luan revolucioni në fushën e teknologjisë së informacionit, efektet e të cilit po bëhen element thelbësor edhe i veprimtarive profesionale të fushës kontabël dhe të auditimit. Standardet e raportimit financiar të bazuara gjerësisht në parime, raportimi i mjaft elementëve në pasqyrat financiare duke përdorur koncepte të tilla si vlera e drejtë dhe një numër çështjesh kontabël të njohjes dhe të matjes së vlerësimit të elementeve, po e rrisin shumë nevojën për njohuri dhe metoda të specializuara për të bërë gjykime të arsyeshme dhe të pranueshme. Përmes gjykimeve elementet në pasqyrat financiare marrin vlera dhe natyrisht profesionistët i kontabilizojnë dhe regjistrojnë ato në mënyrë të përshtatshme.

Në rolin e tyre të verifikuesit për saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare, audituesit mbajnë parasysh faktin që rritja e kompleksitetit në transaksionet dhe standardet e raportimit e të kontrollit, rrit nevojën për gjykime të drejtimit, të cilat jo rrallë ndodh të jenë jo të duhura për shkak të subjektivitetit dhe konflikteve të interesit. Në këto kushte, për të shtuar besimin e përdoruesve tek raportimi financiar, audituesit adoptojnë qasje që bazohen tek skepticizmi profesional, i cili me fjalë të tjera nënkupton qasjen që ka në themel dyshimin për ekzistencën e rrethanave ose të fakteve apo të mënyrave që mund të ndikojnë në mos paraqitjen drejt të efekteve dhe ngjarjeve në të gjithë zinxhirin e raportimit të informacionit financiar.

Duke qënë themelor në punën audituese, skepticizmi profesional është vendosur sot në fokus të punës përmirësuese të Bordeve të standarteve ndërkombëtare të auditimit dhe të etikës (IAASB dhe IESBA) të IFAC-ut. Përfshirja e audituesve në të njëjtën shoqëri tregtare edhe në ofrimin e shërbimeve të tjera të jo auditimit, sic janë konsulencat, këshillat tatimore, etj., sikurse edhe vazhdimi i marrëdhënieve me të njëjtin klient për shume vite, janë elemente që potencialisht mund të kërcënojnë cilësinë e auditimit, për shkak të rreziqeve të tilla si vetë rishikimi apo familjarizimi. Në të tilla rrethana, potencialisht "minohet" skepticizmi profesional i audituesit, pasi ka shumë gjasa që pohimet e drejtimit të entitetit të biznesit të pranohen si të vërteta, kur ato mund të mos jenë të tilla. Audituesit që ndodhen në këto konflikte interesi, ka shumë të ngjarë të mos ndjekin në mënyrë rigoroze procedurat e kërkuara nga standardet e auditimit.

4. Nevoja për një qëndrim profesional skeptik të vazhdueshëm

Profesionistët e auditimit, në bashkërendim me akademikët, hartuesit e standardeve, dhe rregullatorët, po synojnë të zhvillojnë një qasje sa më

gjithëpërfshirëse dhe praktike të skepticizmit profesional, e cila në sensin praktik do të mundësonte plotësimin e boshllëkut dhe mungesën e udhëzimeve të aplikimit të tij në praktikë. Propozimet më të fundit të IESBA dhe IAASB e kanë venë theksin në zhvillimin e një qasje zbatuese sa më praktike dhe racionale në këtë drejtim. Për audituesit, zbatimi i skepticizmit profesional duhet parë si një proces i vazhdueshëm, që lidhet me rrezikun e anomalive materiale dhe faktorët respektivë të rreziqeve të biznesit. Zbatimi i skepticizmit profesional në vazhdimësi, kërkon që audituesi të marrë në konsideratë të gjithë mekanizmin e vlerësimit të rrezikut, i cili nis me njohjen fillestare të entitetit, vlerësimin fillestar dhe paraprak të kujdesshëm e rigoroz të rrezikut, rishikimin dhe rivlerësimin e rrezikut në vazhdimësi gjatë gjithë fazave të auditimit, dhe reagimin e duhur ndaj rreziqeve të vlerësuara. Në të gjithë këtë zinxhir aktivitetesh e fazash, audituesve ju duhet të zbatojnë një nivel të duhur të skepticizmit, i cili i garanton ata për mbledhjen dhe vlerësimin e evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit. Në skemën më poshtë jepet një ilustrim i përdorimit të skepticizmit gjatë zbatimit të procedurave të auditimit dhe të dokumentimit të tyre. Skema nis me vlerësimin fillestar të rrezikut për te ecur më tej, me rishikimin e këtij vlerësimi dhe reagimet përkatëse përmes procedurave të auditimit. Skema ka në qendër paraqitjen e sjelljes skeptike të audituesit brenda një segmenti besimi - nga besimi i plotë në të majtë ku skepticizmi pothuaj nuk ekziston, deri tek mosbesimi apo dyshimi i plotë, ku skepticizmi është pothuaj maksimal.



Përdorimi i skepticizmit profesional varet veç të tjerash, nga rrethanat dhe mjedisi i operimit të entiteteve të biznesit. Disa nga faktorët që çojnë në një qëndrim neutral ose më shumë dyshues dhe në këtë mënyrë, në nevojën për më shumë ose më pak evidence auditimi, janë listuar në pjesën e fundit të skemës. Këta faktorë bazohen kryesisht në rrezikun dhe ndjeshmërinë e anomalive materiale dhe në indikacionet e siguruara nga evidencat e auditimit.

Faktorët që çojnë në nevojën për evidence auditimi shtesë lidhen me kompleksitetin e transaksioneve të biznesit, përdorimin e zgjeruar të

vlerave të drejta, vlerësimet subjektive dhe ndryshimet e shpejta në standardet e zbatueshme të raportimit financiar. Të gjithë këta faktorë kanë tendencë të rrisin shkallën e gjykimit profesional dhe për rrjedhoje, të shtojnë skepticizmin që duhet të aplikojnë audituesit.

Si konkluzion mund të themi se skepticizmi profesional duhet të ushtrohet nga të gjithë kontabilistët profesionistë, dhe jo vetëm nga audituesit. Përgatitësit në veçanti, duhet të ushtrojnë vetë skepticizëm para se t'i dorëzojnë informacionet audituesve të jashtëm. Komitetet e auditimit dhe audituesit e brendshëm duhet të sfidojnë vetveten, kontrollet e vendosura dhe cilësinë e informacionit që prodhojnë, përpara se t'ia dorëzojnë audituesve të jashtëm. Nuk është detyra e audituesve të provojnë se drejtimi ka gabuar, është drejtimi që duhet të mbështesë pohimet e tij.

Një skepticizëm efektiv kërkon që nga njëra anë asnjëherë të mos pranohet përgjigja e dhënë pa u siguruar, edhe nëse ajo duket e besueshme, dhe nga ana tjetër, dyshimet të materializohen në pyetje të duhura, racionale, që ndihmojnë të konfirmohet e vërteta ose e kundërta e saj. Buxhetet, afatet, praktikat e punës dhe metodologjitë nuk duhet të pengojnë ushtrimin e skepticizmit. Firmat e auditimit duhet të gjejnë mënyra më të mira, duke përfshirë potencialisht përdorimin e teknologjisë, për të mbajtur në nivelin e duhur skepticizmin profesional.

Literatura e konsultuar

1. IAASB, SNA 200, Objektivat e Përgjithshme të Audituesve të Pavarur dhe kryerja e një auditimi në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, 2009. New York, NY: IFAC.
2. SNKC1 – Kontrolli i cilësisë për firmat që kryejnë auditime dhe rishikime të informacioneve financiare historike dhe angazhime të tjera të sigurisë dhe të shërbimeve të lidhura. 2009. New York, NY: IFAC
3. SNA 240, Përgjegjësitë e Audituesit Lidhur me Mashtrimin në Auditimin e PF 2009. New York, NY: IFAC.
4. PCAOB AU 230, Due Professional Care in the Performance of work, 2006. www.pcaobus.org.
5. Nelson, M.W. 2009. “A model and literature review of professional skepticism in auditing.” Auditing: A Journal of Practice & Theory.
6. Steven M. Glover & Douglas F. Prawitt, 2013
7. IESBA Code of Ethics for professional accountants, 2016
8. Manuali i Auditimit të pasqyrave financiare, bazuar në SNA-te e qartësuara te IAASB-së, 2017, Hysen Cela

Nga: Prof.Dr.Hysen Çela, Kryetar, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA)

NDRYSHIMI MIDIS ZYRËS SË AUDITIMIT TË QEVERISË SË SHBA DHE KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT NË AUDITIMET E PERFORMANCËS ME FOKUSIN TEK MATJA E EFEKTIVITETIT TË PROGRAMEVE QEVERITARE

Punim i paraqitur nga audituesja Alma Shehu, në përfundim të Fellowship-it në GAO

Në misionin e tij kryesor në mbështetje të Kongresit të SHBA, GAO synon të ndihmojë në përmirësimin e performancës dhe të sigurojë llogaridhënien e qeverisë federale. Për këtë GAO i kushton vëmendje të veçantë gjithë procesit të auditimit, i cili zhvillohet në përputhje me standardet e përgjithshëm të auditimit të pranuara nga qeveria (GAGAS). Pas pranimit të kërkesës së Kongresit, hartimit të pyetjes kryesore të auditimit dhe përcaktimit të kritereve, procesi i auditimit fokusohet në grumbullimin dhe analizën e të dhënave.

Nga: Alma Shehu, Audituese, KLSH

Përmbledhje ekzekutive

Misioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) si një institucion i pavarur kushtetues është të informojë publikun dhe Kuvendin mbi përdorimin e burimeve publike nga qeveria qendrore dhe lokale dhe subjektet e tjera publike. Gjithashtu, KLSH-ja promovon llogaridhënien dhe transparencën në të gjithë sektorin publik në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), duke kontribuar në qeverisjen e mirë përmes luftës kundër korrupsionit.

Ndryshimi në menaxhimin e KLSH-së në dhjetor 2011, solli ndryshime të rëndësishme në filozofinë e menaxhimit të këtij institucioni. Kryetari i ri i KLSH-së, z. Bujar Leskaj, theksoi se përveç konsolidimit të auditimeve financiare, zhvillimi i mëtejshëm mund të arrihet duke zhvendosur vëmendjen tek auditimet e performancës[1] të kryera në përputhje me standardet e INTOSAI-t.

Qëllimi i këtij shkrimi është të prezantojë praktikat më të mira të Zyrës

[1] *Fjala e z. Bujar Leskaj, i propozuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë për postin e kryetarit të KLSH, mbajtur në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave më 14.12.2011, me rastin e prezantimit të platformës së tij për drejtimin e KLSH-së*

së Auditimit të Qeveris të Shteteve të Bashkuara (GAO) që mund të jenë të zbatueshme për KLSH-në gjatë kryerjes së auditimeve të performancës në adresimin e sfidave të ardhshme, veçanërisht në matjen e efektivitetit të programeve qeveritare.

Në misionin e tij kryesor në mbështetje të Kongresit të SHBA, GAO synon të ndihmojë në përmirësimin e performancës dhe të sigurojë llogaridhënien e qeverisë federale. Për këtë GAO i kushton vëmendje të veçantë gjithë procesit të auditimit, i cili zhvillohet në përputhje me standardet e përgjithshëm të auditimit të pranuara nga qeveria (GAGAS). Pas pranimit të kërkesës së Kongresit, hartimit të pyetjes kryesore të auditimit dhe përcaktimit të kritereve, procesi i auditimit fokusohet në grumbullimin dhe analizën e të dhënave. Të dhënat e mjaftueshme dhe të përshtatshme janë elemente kyçe që ndihmojnë audituesit e GAO-s të arrijnë në konkluzione dhe të hartojnë rekomandimet e duhura në lidhje me efektivitetin e programeve qeveritare. Në procesin e follow up, që konsiderohet si hap i fundit, por jo më pak i rëndësishëm në procesin e auditimit, GAO analizon zbatimin e rekomandimeve. Ky proces shqyrton përmirësimet e programeve qeveritare dhe se si rekomandimet e GAO kanë ndikuar që këto programe të jenë më efektive. KLSH duke analizuar praktikën e GAO-s dhe përshtatur atë në veprimtarinëë e tij do të rrisë besueshmërinë dhe kapacitetin e tij në kryerjen e auditimeve të performancës për t'u përshtatur më mirë sfidave të reja dhe për të përmbushur pritshmëritë e qytetarëve shqiptarë, Parlamentit dhe palëve të tjera të interesit.

Objektivat

Sa më sipër qëllimi i këtij shkrimi është të:

- Përshkruajë qasjen e Kontrollit të Lartë të Shtetit në auditimin e performancës, veçanërisht në matjen e efektivitetit;
- Të përshkruaj qasjen e Zyrës së Auditimit të të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara për auditimin e performancës, veçanërisht në matjen e efektivitetit;
- Të analizojë ndryshimet mes qasjeve të dy institucioneve;
- Të propozojë disa ndryshime për përmirësimin e qasjes së KLSH-së në auditimet e performancës, veçanë-risht me fokus në matjen e efektivitetit.

Hyrje

Rënia e regjimit komunist dhe vendosja e rendit demokratik në Shqipëri, si në të gjitha institucionet, u shoqërua me ndryshime thelbësore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, i cili deri në fillim të viteve 1990 ishte një institucion

tërësisht në varësi të qeverisë. Reformat e thella demokratike që janë kryer në Shqipëri për të përmirësuar jetën e qytetarëve të saj dhe qëllimin kombëtar për anëtarësim të plotë në Bashkimin Europian u shoqëruan edhe me miratimin e Kushtetutës së re, në të cilën nenet 162, 163, 164 dhe 165 sanksionohet:

- Autoriteti dhe funksioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Zgjedhja e Kryetarit të KLSH;
- Objekti i aktivitetit të auditimit;
- Raportimi dhe marrëdhëniet me Parlamentin;
- Marrëdhëniet me qeverinë.

Ligji nr. 154/2014, *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",* i cili është në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) dhe praktikat më të mira evropiane qartëson të drejtën dhe detyrimin e KLSH-së për të kryerjen e auditime të performancës.

Në përmbushjen e detyrimeve të ligjit, KLSH ka themeluar Departamentin e Auditimit të Performancës, i cili vazhdon të ballafaqohet me sfida të ndryshme të tilla si si ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional i audituesve të performancës.

GAO, si një institucion udhëheqës në komunitetin INTOSAI, ka krijuar procese, procedura dhe struktura të brendshme, të cilat mbështesin ekipet e auditimit për të zgjedhur metodologjinë e duhur për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave, duke kontribuar kështu në raporte auditimi të cilat në mënyrë të qartë adresojnë mangësitë e programeve qeverisë dhe ofrojnë rekomandime për përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të këtyre programeve.

Ky shkrim synon të identifikojë (1) qasjen e Gao për kryerjen e auditimeve të performancës, (2) aktorët e përfshirë në planifikimin, kryerjen dhe raportimin në auditimet e performancës dhe rolin e tyre specifik në procesin e auditimit të GAO-s, (3) metodologjitë e përdorura nga GAO për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, dhe (4) procesin e follow up të GAO me fokus në matjen e efektivitetit të programeve qeveritare

Kreu I

1.1 Struktura dhe kuadri i rregullator të KLSH

Më 27 nëntor 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin e ri të KLSH-së nr. 154/2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e KLSH"*, i cili hyri në fuqi në shkurt të vitit 2015. Ky ligj shënoi një pikë kthese për institucionin, duke profilizuar atë si një institucion modern të auditimit suprem që e bazon veprimtarinë e tij në standardet INTOSAI.

Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit është i organizuar në nëntë departamente, shtatë prej tyre

departamente auditimi dhe Departamentin Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Departamentin e Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit. Duke pasur parasysh fazat nëpër të cilat ka kalura KLSH dhe traditës institucionale, aktiviteti i tij deri në vitin 2008 ishte fokusuar në kryerjen e auditimeve të përputhshmërisë dhe disa auditimeve financiare dhe të performancës. Është e rëndësishme të theksohet se Ligji për organizimin dhe funksionimin e KLSH nr. 8270, date 23 dhjetorit 1997, i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 10 prill 2000, nuk jepte një përkufizim ose nuk adresonte në mënyrë specifike auditimin e performancës si një nga llojet e auditimit. Ligji theksonte se*: "Objektivi kryesor i Kontrollit të Lartë të Shtetit është të kontrollojë efektivitetin dhe dobinë e përdorimit të fondeve publike*[2] *..."* por nuk i jepte një mandat të qartë KLSH për të kryer auditime performance.

Nga strukturat e menaxhimit të institucioneve publike të atëhershme, auditimi i performancës shihej si derivat i llojeve të tjera të auditimit dhe jo si një lloj i ri auditimi, i cili kontribuon në matjen e ekonomicitetit, efektivitetit dhe efikasiencës. Në vitin 2011, KLSH kishte kryer rreth 152 auditime[3], por vetëm një ishte auditim performance.

Me synim kryerjen e aktiviteteve të auditimit në përputhje me standardet INTOSAI-t dhe me qëllimin e informacionit multidimensional të Parlamentit mbi përdorimin e parave publike, bashkë me ndryshimin në menaxhimin e KLSH në vitin 2011, vëmendje e veçantë iu kushtua auditimit të performancës. Në këtë drejtim, në Dokumentin e Zhvillimit Strategjik 2013-2017[4], Objektivi i tretë u fokusua në përmirësimin e cilësisë së auditimit dhe rritjen e numrit të auditimeve të performancës. Ky dokument i rëndësishëm theksonte se *"Auditimi i performancës do të jetë një aktivitet i konsoliduar që synon rritjen e numrit të auditimeve, me personel të mire trajnuar që do të demonstrojë aftësi shumë të mira në kryerjen e këtij lloj auditimi me ndikim në administratën publike shqiptare. Auditimi i Performancës do të jetë një nga dy aktivitetet më të rëndësishme në të gjithë veprimtarinë e institucionit të KLSH-së.*

... Rezultatet e disa politikave të institucioneve publike kanë treguar nga njëra anë një hendek midis politikave dhe skemave të këtyre politikave, si dhe natyrën komplekse dhe gjithnjë në

[2] Neni 6 i Ligjit nr. 8270, datë 23 dhjetor 1997, "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit".

[3] *Analiza vjetore e KLSH 2011, e publikuar në vitin 2012.*

[4] *Dokumenti Strategjik i Zhvillimit 2013-2017, faqet 22-24.*

ndryshim të problemeve sociale dhe ekonomike të vendit nga ana tjetër. Ato kërkojnë një lloj të ri përgjegjësie, në të cilin auditimi i sektorit publik duhet të luajë rolin e tij duke pasur një qasje dinamike dhe jo statike. KLSH do ta fokusojë auditimin e performancës në rezultate dhe jo në procese, duke theksuar nevojën për ndryshime, për një përmirësim të përgjegjshëm dhe të vazhdueshëm të menaxhimit publik. Institucioni ka sfidën të shqyrtojë nëse qëllimet dhe skemat e politikave lidhen me problemet e jetës së përditshme dhe shqetësimin e palëve të interesuara ".

Hapi i parë në përmbushjen e këtij objektivi të rëndësishëm, ishte themelimi në tetor 2012 i Departamentit të Auditimit të Performancës në KLSH, i cili përbëhej nga 16 auditues. Në vitin 2017, Departamenti i Auditimit të Performancës përbëhej nga Drejtori i Departamentit dhe 19 auditues.

Me qëllim të kryerjes së punës së auditimit në bazë të standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe për tu ardhur në ndihmë audituesve të këtij departamenti të gjitha fazat e auditimit, KLSH publikoi "*Udhëzuesin e Auditimit të Performancës: ISSAI 3000-3100*". Qëllimi i publikimit të këtij dokumenti nga KLSH ishte:

- të ndihmonte audituesit në kryerjen me cilësi të dhe të mbështetur në standard të auditimeve të performances ;
- stimulimi i kompetencës profesionale të audituesve të KLSH-së;
- të ofronte një bazë për kryerjen me sukses të këtyre llojeve të auditimeve; dhe t'i mundësonte publikut të gjerë dhe përdoruesve të veçantë një perspektivë më të mirë të të kuptuar qartë karakteristikat dhe profesionalizmin e KLSH[5].

Një tjetër moment i rëndësishëm në punën e Departamentit të Auditimit të Performancës është botimi në vitin 2015 i Manualit të Departamentit të Auditimit të Performancës. Ky manual jep udhëzime për audituesit e performancës në KLSH, duke përshkruar të gjitha fazat e ciklit të auditimit të performancës siç janë: planifikimi strategjik, planifikimi vjetor, planifikimin i auditimit, qasjet e auditimit, kriteret, metodologjitë e auditimit, matricën e tij, grumbullimin dhe analizimin e të dhënave, hartimin e raportit dhe përcjelljen e raportit përfundimtar në subjekt. Në vitin 2015, KLSH gjithashtu publikoi *"Indikatorët e Performancës",* publikimi i cili i referohet përvojës britanike dhe konsiderohet si një udhëzues për audituesit e performancës në identifikimin, përcaktimin, shpjegimin dhe ilustrimin e grupeve të treguesve të performancës përmes të cilave një subjekt publik mund të vlerësohet nga palët brenda dhe jashtë organizatës. Në

[5] *Udhëzuesi i Auditimit të Performancës: ISSAI 3000-3100, faqe 3.*

kuadër të rritjes së kapaciteteve profesional të audituesve, KLSH i ka kushtuar vëmendje të veçantë programeve të trajnimit brenda dhe jashtë vendit dhe sidomos trjnimit të audituesve të performancës. Gjatë vitit 2012-2017, secili auditues i KLSH ka kryer mesatarisht 25 ditë trajnimi. Për periudhën 2002-2011, ky tregues ka qenë rreth 2.1 ditë trajnimi për auditues.

Që nga viti 2011, KLSH ka rritur çdo vit numrin e auditimeve të performancës. Ky lloj auditimi përbënte vetëm 1 përqind të aktivitetit të auditimit të KLSH në vitin 2011, ndërsa përqindja e këtij lloji të auditimit u rrit në vitin 2015 shkoi në 8 për qind dhe në vitin 2017 në rreth 10 për qind.

Auditimet e performances për vitet 2011-2017

Viti	*Numri total i auditimeve të kryera nga KLSH*	*Numri i auditimeve të performancës*	*Pasha ne përqindje e auditimeve të performances kundrejt totalit*
2011	152	1	1
2012	158	4	3
2013	153		4
2014	160	8	5
2015	158	12	8
2016	154	13	8
2017	156	15	10

Burimi: Publikimet "Analiza vjetore e KLSH" për vitet 2011-2017

Mbulimi i auditimit të performancës aktualisht varion nga performanca specifike e programeve qeveritare kundrejt reformave qeveritare dhe administrative të ndërmarra nga qeveria, vlerësimi i menaxhimit të financave publike, vlerësimi i efektivitetit të strategjive të zhvillimit në fusha të ndryshme, programet e administratës fiskale dhe vlerësimi i reformave në to, kujdesi shëndetësor , reformat e arsimit vlerësimi i projekteve mjedisore dhe të atyre energjetike dhe vlerësimi i performancës së njësive të veçanta. Në fjalën e tij me rastin e analizës vjetore të KLSH për vitin 2016, Kryetari, z. Bujar Leskaj theksoi se *"Auditimi i performancës do të vazhdojë të mbetet prioritet i punës sonë, si një auditim që parandalon para se të penalizojë, studion në mënyrë analitike para se të krahasojë mekanikisht , rekomandon zgjidhje optimale, duke synuar kryesisht ndryshimin e sjelljes dhe mentalitetit të zyrtarit publik nëpërmjet komunikimit të hapur dhe konstruktiv, pa kompromentuar vendimmarrjen apo hartimin e politikave ".*

Numri i gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimit është rritur gjithashtu nga viti në vit. Në vitin 2017, totali ishte si më poshtë:

528 gjetje; 424 konkluzione; 396 rekomandime.

Rekomandimet e audituesve të Departamentit të Auditimit të Performancës kryesisht lidhen me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe kuadrit

rregullator si dhe fokusohen në përmirësimin e aspekteve organizative të subjekteve të audituara.

Duke pasur parasysh faktin se KLSH ndër vite ka kryer kryesisht auditime përputhshmërie dhe fakti që institucionet e njohin këtë lloj të auditimit, iniciimi dhe kryerja e auditimeve të performancës nuk ishte e lehtë. Një pjesë e madhe e zyrtarëve të çdo niveli në administratën publike kanë një qasje kontradiktore ndaj këtij lloji të auditimit dhe ende nuk e kuptojnë rolin e auditimit të performancës.

1.2. Matja e efektivitetit në auditimet e performancës të KLSH

Bazuar në ligjin e tij organik , KLSH mund të vendosë në mënyrë të pavarur dhe në çdo kohë për planin e aktiviteteve të auditimit. Para përfundimit të vitit, Kryetari i KLSH-së miraton Planin Vjetor të Auditimit për vitin e pasardhës në bazë të propozimeve të përcjella nga drejtorët e departamenteve, të cilët propozimet i kanë pasur subjekt të diskutimeve interne brenda departamentit. Pas miratimit të Planit Vjetor të Auditimit, krijohen grupet e auditimeve që do të kryejnë auditimin për secilën temë.

Në fazën përgatitore, grupi i auditimit auditimit përpiqet merr informacion për veprimtarinë e subjektit që do të audiztohet, politikat e tij dhe strukturën administrative. Pasi grupi i agjitimit ka identifikuar programin, objektivat e programit, inputet dhe rezultatet e pritshme, grupi i auditimit në diskutime të vazhdueshme me Drejtorin e Departamentit harton pyetjen kryesore dhe matricën e auditimit.

Shembulli i matrices së auditimit të performances [6]



Për pyetjen kryesore dhe nënpyetjet, grupi i auditimit përcakton kriteret, të dhënat që nevojiten, burimet e të dhënave, metodat e përdorura për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, teknikat analitike, kufizimet në konkluzionet që mund të raportohen dhe përshkrimin e ngjarjeve të pazakonshme në bazë të kësaj analize.

Matja e efektivitetit të programeve dhe politikave të qeverisë qendrore dhe lokale është e lidhur ngushtë me burimet e të dhënave, autenticitetin dhe besueshmërinë e tyre, metodat e zgjedhura nga grupi i auditimit për mbledhjen e të dhënave të cilat, pas analizës, duhet të ofrojnë një pasqyrë të

[6] *KLSH, Manuali i Departamentit të Auditimit të Performances, faqja 40.*

qartë për efektivitetin e këtyre programeve. Pjesë e manualit të Departamentin e Auditimit të Performancës është gjithashtu një udhëzues i shkurtër i qasjes/ metodologjisë së auditimit. Në këtë seksion theksohet *"... Ky seksion duhet të listojë të gjitha teknikat për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe publikimin e informacionit. Metodat duhet të jenë në përputhje me qasjen e zgjedhur. Për shembull, ekipi i auditimit nuk mund të zgjedhë një qasje sasiore dhe pyetësorët me pyetje të hapura të përdoren si metodë për mbledhjen e të dhënave[7]".* Të dhënat në auditimet e performancës të KLSH-së kryesisht grumbullohen nga shqyrtimet e dosjeve, intervistat e punonjësve të entitetit të audituar, pyetësorët e hapur dhe të mbyllur, hulumtimi aktiv dhe praktikat më të mira. Grupi i auditimit, bazuar në përvojën audituese, njohuritë e fituara gjatë fazës studimore, trajnimet dhe edukimit arsimor të anëtarëve të grupit të auditimit, është përgjegjës për përcaktimin e kritereve dhe metodat për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Mungesa e njohurive të thelluara për metodologjinë për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave dhe kufizimet e secilës metodë e bën të vështirë për audituesit e KLSH të matin efektivitetin e programeve qeveritare. Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës nuk ka një seksion specifik që përshkruan secilën metodë që mund të përdoret për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave

1.3. Follow up në KLSH si një mekanizëm për matjen e efektivitetit të programeve dhe politikave të qeverisjes qendrore dhe lokale.

Ligji i ri i KLSH *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"* përcakton qartë se si KLSH duhet të ndjekë zbatimin e rekomandimeve. Neni 15 j, *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH"* parashikon që *"Kontrolli i Lartë i Shtetit, kur është e përshtatshme, në fillim, gjatë dhe / ose në fund të auditimit ... cakton afatin për zbatimin e rekomandimeve dhe duhet të informohet nga subjektet e audituara në lidhje me zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve".*Neni 30, paragrafi 2*, "Rekomandimet e KLSH-së dhe follow up"* parashikon që *"subjekti i audituar i raporton KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna brenda 6 muajve nga përcjellje së raportit të auditimit".*

Rregullorja e Brendshme e KLSH-së dhe vendimi e Kryetarit të KLSH i vitit 2016 *"Për procedurat për kryerjen dhe dokumentimin e punës për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH"* janë dokumentet udhëzuese për kryerjen e follow up. Procesi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve është një proces i rëndësishëm në KLSH dhe bëhet për të gjitha llojet e auditimeve. Në

[7] *Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës, faqe 51*

auditimet pasardhëse, raportimi në lidhje me implementimin e rekomandimeve përbën një pjesë të rëndësishme të raportit të Auditimit. Gjithashtu në fund të çdo viti, KLSH kryen një auditim lidhur me mënyrën se si janë zbatuar planet e veprimit për implementimin e rekomandimeve të lëna më parë nga KLSH. Çdo departament auditimi kryen monitorimin e rekomandimeve të lëna prej tij dhe raporton veçmas për këtë. KLSH ende nuk ka konsoliduar një database për të gjitha rekomandimet e auditimit dhe kjo e bën të vështirë ndjekjen e zbatimit të tyre. Kjo bëhet edhe më e vështirë për rekomandimet e auditimeve të performancës, pasi siç është përmendur më parë, rekomandimet e auditimimeve të performancës së KLSH-së lidhen me natyrën organizative të çështjeve të kontrollit të brendshëm dhe propozime për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator. Subjektet tentojnë të zbatojnë më shumë rekomandimet për përmirësimin e kontrolleve të brendshme. Ndryshimet në ligjet dhe kornizat rregullatore kërkojnë kohë dhe përfshirjen e shumë palëve, dhe kjo e bën të vështirë që Departamenti i Auditimit të Performancës të raportojë mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve. Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) dhe ky dokument kombinon axhendën e integrimit në BE me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit, duke përfshirë dhe angazhimet që lidhen me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Dokumenti i SKZHI paraqet vizionin për zhvillimin e demokracisë, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit, duke nënvizuar aspiratat për integrim në Bashkimin Evropian. SKZHI paraqet si do të arrihet ky vizion përmes politikave dhe prioriteteve që synojnë:

- Nxitjen e zhvillimit të vendit, duke krijuar një rritje të qëndrueshme ekonomike, nëpërmjet një stabiliteti makroekonomik dhe financiar;
- Rriitjen e standardeve që i shërbejnë qytetarëve, rritjen e mirëqenies dhe sigurimin e mbrojtjes të drejtat e tyre;
- Transformimin e Shqipërisë në një vend standard, për të bërë të mundur anëtarësimin në Bashkimin Europian; dhe
- Hartimin e politikave që rrisin konkurrencën dhe rritjen ekonomike të vendit, në krahasim me vendet e rajonit dhe më gjerë.

Për shkak të kapaciteteve dhe përvojat e saj të kufizuara, KLSH ende nuk ka hartuar një dokument / udhëzim specifik për mënyrën e ndjekjes dhe raportimit në Kuvend të përmbushjes së objektivave të Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Kreu II

2.1. Struktura dhe kuadri organizator i GAO

- GAO është një institucion i pavarur, që punon për Kongresin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Misioni i tij është të mbështesë Kongresin në përmbushjen e përgjegjësive të tij kushtetuese për përmirësimin e performancës dhe për të siguruar llogaridhënien e qeverisë federale për të mirën e qytetarëve amerikanë. GAO mbështet mbikëqyrjen e Kongresit duke:
- audituar veprimtarinë e agjencive federale për të përcaktuar nëse fondet federale janë shpenzuar në mënyrë efektive dhe eficiente;
- hetuar pretendimet për veprimtari të paligjshme dhe të pahijshme;
- raportuar se sa mirë programet dhe politikat qeveritare po përmbushin objektivat e tyre;
- kryer analiza të politikave dhe evidentimin e opsioneve që merren në shqyrtim nga Kongresi

Akti i Buxhetit dhe Kontabilitetit i vitit 1921 transferoi përgjegjësitë e auditimit nga Departamenti i Thesarit në një agjenci të re dhe kështu nisi zanafilla e veprimtarisë së Zyrës së Auditimit të Qeverisë[8]. Akti ligjor siguroi pavarësinë e GAO-s nga ekzekutivi dhe i dha këtij institucioni një mandat të gjerë për të hetuar se si shpenzohen paratë federale. Legjislacioni më vonë sqaroi dhe zgjeroi rolin e GAO, por Akti i Buxhetit dhe Kontabilitetit i vitit 1921 vazhdon të shërbejë si bazë për aktivitetin e këtij institucioni. GAO drejtohet nga Kontrollori i Përgjithshëm, i cili ka një mandate 15-vjeçar. GAO është e organizuar në 14 departament, Zyra e Këshillit të Përgjithshëm dhe Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm. Aktiviteti i auditimit i GAO-s bazohet në standardet profesionale dhe udhëzimet që përfshihen në dokumentin Standardet e Përgjithshme të Auditimit të Qeverisë (GAGAS), i njohur edhe si Libri i Verdhë. Ky dokument siguron një kuadër rregullator për kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë. Këto standarde përdoren gjithashtu nga audituesit e njësive të qeverisjes vendore dhe lokale dhe subjektet që marrin fonde qeveritare. Këto standarde përmbajnë kërkesat dhe udhëzimet që kanë të bëjnë me etikën, pavarësinë, gjykimin dhe kompetencën profesionale të audituesve, kontrollin e cilësisë, kryerjen e auditimit dhe raportimin.

2.2. Auditimi i Performancës në GAO

Aktiviteti audites i GAO-s dhe produktet që i paraqiten Kongresit dhe publikut janë kryesisht auditimet e performancës, auditimet financiare dhe dëshmi.

[8] Zyra e Përgjithshme e Kontabilitetit në SHBA u bë Zyra e Auditimit të Qeverisë së SHBA në 1994.

GAO e inicion aktivitetin e saj auditues me kërkesë të komisioneve ose nën komisioneve të Kongresit ose kur është e mandatuar nga ligjet ose raportet të komisioneve të Kongresit. GAO gjithashtu inicion auditime me iniciativën e Kontrollorit të Përgjithshëm. Në pranimin e kërkesave të anëtarëve të Kongresit, GAO mund të iniciojë aktivitet auditues vetëm brenda mandatit dhe kompetencave të saj. Për pranimin e kërkesave të Kongresit, së bashku me qëllimin dhe kohën e kryerjes së auditimit, GAO vlerëson nëse subjekti i audituer, një programi ose aktiviteti i veçantë është financuar ose do të financohet nga fonde federale ose kryhet sipas një ligjit ekzistues federal. Rreth 80 % e auditimeve të kryera nga GAO janë auditime performance.

Suksesi i punës së kryer nga GAO konsiston kryesisht në procesin e planifikimit të auditimit. Ky është procesi në të cilin grupi i auditimit përpiqet të kuptojë dhe qartësojë objektivat e auditimit, kryen hulumtime paraprake rreth kërkesës së marrë për të informuar palët e përfshira në auditim, harton matricën e auditimit dhe zhvillon fushëveprimin e propozuar dhe metodologjinë e auditimit. Grupi i auditimit, në bashkëpunim dhe diskutime të vazhdueshme me palët e tjera të përfshira në auditim, identifikon risqet dhe përcakton mënyrën e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave për të hartuar gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet për matjen e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficiencës në auditimet e performancës. Më poshtë gjendet shembulli i matricës së auditimit të performances që përdoret nga grupet e auditimit të GAO-së

Pyetja Kryesore	***Kriteret dhe informacioni I kërkuar dhe burimet e tij***	***Qëllimi dhe metodologjia përfshirë dhe besueshmërinë e të dhënave***	***Kufizimet***	***Çfarë do ti lejojë GAO-s të shprehet analiza e kryer***
Cilës pyetje po përpiqet ti përgjigjet grupi i auditimit? Identifikoni pyetjet kyçe të auditimit. Sigurohuni që secila pyetje të jetë specifike, objektive, neutrale, e matshme dhe e zbatueshme. Sigurohuni që të jenë të përcaktuara kushtet kyçe.	***Cili është informacioni që i nevojitet grupit të auditimit për adresimin e pyetjes së auditimit?*** Për objektivat e auditimit të performancës që do të vlerësojnë të dhëna kundrejt kritereve të qarta, të identifikohen kriteret ose planet për mbledhjen e dokumenteve që nevojiten për përcaktimin e kritereve që duhen përdorur. Për objektivat e auditimit të performancës që nuk do të vlerësojnë provat kundrejt kritereve të qarta, por në vend të kësaj japin siguri në lidhje me një program (kriteret e nënkuptuara), shtoni "Kriteret: A6.03". Identifikoni dokumentet ose llojet e informacionit që grupi i auditimit duhet të ketë. Identifikoni nëse	***Si do ti përgjigjet ekipi çdo pyetje?*** Përshkruani strategjitë për grumbullimin e informacionit apo të dhënave të kërkuara, të tilla si marrja e mostrave të rastësishme, studime të rasteve të ngjashme, grupet e fokusit, pyetësorët, krahasimi me praktikat më të mira, përdorimi i bazave ekzistuese të të dhënave, marrjen e fotografive, regjistrimeve video ose audio, etj. Përshkruani fushën e planifikimit të secilës strategji, duke përfshirë afatet kohore, vendet për t'u vizituar dhe madhësitë e mostrës. Përshkruani teknikat analitike që do të përdoren: siç janë analiza e regresionit, analiza e përfitimit të kostos, analiza e	***Cilat janë kufizimet e matrices së auditimit dhe si do të ndikojnë ato tek produkti?*** Cito ndonjë kufizim si rezultat i informacioneve të marra ose qëllimit e metodologjisë të tilla si: - Cilësia e të dhënave ose besueshmëria e tyre. -Pamundësia për të aksesuar lloje të caktuara të të dhënave ose për të marrë të dhëna që mbulojnë periudhën kohore që auditohet . - Kufizime të klasifikimit të të dhënave për shkak të sigurisë. -Pamundësia për të përgjithësuar ose ekstrapoluar gjetjet për tërësinë e të dhënave - Sigurohuni që të adresohet se si këto kufizime do të ndikojnë në	***Cilat janë rezultatet e pritshme të punës?*** Përshkruani çfarë mund të shpreheni pas kryerjes se auditimit. Jepni një përshkrim të rezultateve paraprake për qëllime ilustruese, nëse mundeni. Sigurohuni që përgjigja e propozuar të trajtojë pyetjen në kolonën e parë. Nëse është e përshtatshme, jepni një për shkrim për materialet video, audio, animacion ose media të tjera që mund të ndihmojnë në komunikimin e mesazhit të auditimit

Pyetja Kryesore	*Kriteret dhe informacioni I kërkuar dhe burimet e tij*	*Qëllimi dhe metodologjia përfshirë dhe besueshmërinë e të dhënave*	*Kufizimet*	*Çfarë do ti lejojë GAO-s të shprehet analiza e kryer*
	mund të mblidhen fotografi, video, audio ose media të tjera për të rritur dokumentimin dhe komunikimin e informacionit. Identifikimi i planeve për të adresuar funksionin e kontrolleve të brendshme dhe përputhshmërinë e aktivitetit. Identifikoni planet për follow up për gjetjet e rëndësishme dhe rekomandime ende të pazbatuara që grupi i auditimit i ka gjetur në marrjen e informacionit gjatë fazës studimore Identifikoni burimet e informacionit që ju nevojitet siç janë: bazat e të dhënave, studimet, ekspertë të fushave specifike, zyrtarët e programeve federale, modelet të ndryshme, etj.	ndjeshmërisë, modelimi, analiza përshkruese, analiza e përmbajtjes, dhe përmbledhje të studimeve të rasteve të ngjashme, etj. Përshkruani hapat që duhet të ndërmerren për të vlerësuar besueshmërinë e burimeve të të dhënave.	produkt.	

Si pjesë e degës legjislative, e cila ndihmon dhe mbështet Kongresin për marrjen e vendimeve në dobi të qytetarëve amerikanë, GAO i paraqet Kongresit raporte që janë të bazuara në fakte dhe ndihmojnë agjencitë të identifikojnë sfidat dhe mangësitë dhe të ndërmarrin veprime për të përmirësuar aktivitetin e tyre. GAO përdor një qasje menaxheriale të bazuar

në risk në auditimet e performancës dhe përfshin ekspertë të ndryshëm që prej inicimit të aktivitetit auditues deri në publikimin e tij. Matrica e auditimit përgatitur nga grupi i auditimit përshkruan objektivat, fushëveprimin dhe metodologjinë e auditimit. Përveç matricës, grupi i auditimit përgatit një projekti plan i cili specifikon detyrat, përgjegjësitë e personelit dhe datat e parashikuara për përmbushjen e çdo etape të auditimit.

2.3. Palët e interesuara dhe roli i tyre në procesin e auditimit

Në varësi të kompleksitetit të temës dhe ndikimit që mund të ketë raporti i GAO-s, drejtorët dhe zëvendësit e tyre gjatë gjithë procesit të planifikimit të auditimit identifikojnë aktorët e mundshëm të brendshëm që mund të jenë një vlerë e shtuar dhe të rrisin cilësinë e auditimit. Palët e interesuara ose aktorët e tjerë në procesin auditues të GAO-s janë drejtues ose staf, aftësitë e të cilëve janë të nevojshme për përfundimin në kohë dhe me cilësi të auditimit. Termi i përdorur për palët e brendshme të interesuara është specialistë. Ata zakonisht përfshihen prej fillimit në punën audituese si pjesë e grupit të auditimit për të hartuar matricën e auditimit, për të mbledhur dhe analizuar të dhënat, për të hartuar mesazhin e auditimit dhe hartimin e raportit përfundimtar. Duke qenë se ata ndihmojnë në hartimin dhe rishikimin e produktit të auditimit, ata përgjithësisht marrin pjesë në mbledhjet vendimmarrëse të grupit të auditimit. Specialistët mund të jenë avokatë / jurist dhe përfshirja e tyre në një auditim varet nga ndjeshmëria ligjore. Angazhimi i tyre mund të shkoj nga një rishikim formal i produkteve të auditimit që kanë pak ose aspak përmbajtje ligjore deri në pjesëmarrjen e vazhdueshme në aktivitetet audituese që kërkojnë këshillim intensive ligjor. Ekspertët e metodologjisë së Ekipit të Metodave Kërkimore të Aplikuara (ARM) ose Qendrës së Dizenimit, Metodave dhe Analizave të ARM ofrojnë ndihmë në formulimin e pyetjeve të auditimit dhe në identifikimin e çështjeve që lidhen me metodologjinë. Specialistët e ARM-së përfshihen në diskutimin dhe përzgjedhjen e qasjes metodologjike audituese. Specialistët e ARM ku përfshihen statisticienë, specialistët për hartimin e pyetësorëve, ekonomistë dhe specialistë të tjerë konsultohen sipas rastit kur auditimet përfshijnë qasje në fushat e tyre të ekspertizës. Për shembull, specialistët e ARM-së janë shpesh përgjegjës për dokumentimin e planeve të mostrimit dhe anketave. FAIS i (Ekip i Auditimi Forenzikës dhe Shërbimeve Investigative) konsultohet kur audituesit identifikojnë raste mashtrim, shkelje etike, konflikte interesi, shpërdorim, keqpërdorim, ose keqmenaxhim të fondeve federale. Për të siguruar përfshirjen efektive të të gjithë palëve të interesuara, specialistët janë

përgjegjës për kontributin e tyre në auditim. Ata gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e mesazhit të produktit dhe rishikimin e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve.

2.4. Roli i Ekipit të Metodave të Kërkimeve të Aplikuara (ARM) në mbështetjen e aktiviteteve të auditimit

Ekipi i Metodave të Kërkimeve të Aplikuara është një nga 14 ekipet e GAO –s që përbëhet nga profesionistë me ekspertizë në hartimin dhe aplikimin e metodologjive të përshtatshme që ndihmojnë grupet e auditimit të GAO-së për informimin e Kongresit rreth veprimtarisë të qeverisë. ARM përbëhet nga pesë ekipe:

- Qendra për hartimin e metodave dhe analizës;
- Qendra për studime ekonomike;
- Qendra për analiza të zgjeruara;
- Qendra për Metodat dhe Çështjet e Vlerësimit;
- Qendra për Shkencë, Teknologji dhe Inxhinieri.

Qendrat ofrojnë ekspertizë në shumë fusha, duke përfshirë analizën e kostos, dizenjimin e auditimit, ekonominë, analizën e të dhënave, vlerësimin, shkencën, statistikat, anketat, teknologjinë, inxhinierinë dhe sigurinë e IT.

Qendra për hartimin e metodave dhe analizës (Center for Design Methods, and Analysis CDMA)

CDMA synon rritjen e cilësisë së punës audituese të GAO-s, duke ofruar ndihmë në metodologji, analitikë dhe teknikë për grupet e auditimit. Misioni i CDMA është të prezantojë metoda të reja dhe të transferojë njohuritë për fushën e auditimit, të cilat janë në përputhje me standardet e GAO-s dhe standard të tjera profesionale. Përfshirja e hershme e CDMA lejon që specialistët e saj të identifikojnë mundësitë kërkimore dhe të përcaktojnë avantazhet dhe disavantazhet e qasjeve të ndryshme. Në fillim të çdo aktiviteti audites një anëtar i stafit të CDMA diskuton me ekipin e auditimit qëllimin e auditimit dhe nevojën e pritshme për ndihmë.

Qendra për studimet ekonomike (Center for Economics - CE)

Misioni i CE është të ofrojë ekspertizë në një gamë të gjerë çështjesh, metodash dhe analizash ekonomike. Ato mund të ndihmojnë ekipin e auditimit të identifikojë çështjet ekonomike relevante për auditimin dhe të diskutojë qasjet dhe metodologjitë më të përshtatshme dhe më të realizueshme për t'i adresuar këto çështje. Ekonomistët e CE bashkëpunojnë me ekipet e auditimit për të identifikuar dhe mbuluar çështjet ekonomike dhe për të kryer punë që adreson objektivat e auditimit. CE përfshin ekonomistët me ekspertizë në çështjet që përfshijnë aktivitetin e qeverisë dhe ekonominë federale, si: analizën e risqeve, njohuri për taksat

dhe subvencionet, si dhe efektet ekonomike të një ligji, akti rregullativ, projekti ose programi. Ekonomistët e CE gjithashtu ofrojnë asistencë duke iu përgjigjur shumë pyetjeve që, në shikim të parë, nuk mund të konsiderohen se përfshijnë çështje ekonomike.

Qendra për Analizën e Avancuar (*Center for Enhanced Analytics- *CEA)

CEA rrit cilësinë e punës së GAO-s, duke u ofruar grupeve të auditimit ndihmë në analizë të avancuar për të dhëna të strukturuara dhe të pastrukturuara duke përdorur analizë parashikuese dhe përshkruese. Ekspertët e CEA mund të ndihmojnë grupet e auditiimit gjatë çdo fazë të auditimit, por ndihma e tyre është më efektive në fillim të planifikimit të auditimit për të identifikuar metodat dhe qasjet analitike më të përshtatshme përgjatë gjithë procesit të auditimit.

Qendra për Metodat dhe Çështjet e Vlerësimit (Center for Evaluation Methods and Issues- CEMI)

Misioni i CEMI është të përmirësojë vlerësimet që jep GAO-s dhe por edhe në mbarë qeverinë. CEMI harton raporte dhe studime që përfshijnë vlerësimin e programeve qeveritare, matjen e performancës, statistika të aplikuara, hulumtime të aplikuar të shkencave sociale dhe analiza të orientuara drejt së ardhmes, të ashtëquajtura *"largpamësi e bazuar".* Publikimet dhe përpjekjet e CEMI kanë për qëllim forcimin e metodave të vlerësimit, si dhe përmirësimin dhe promovimin e zhvillimit të njohurive. Qëllimi final i CEMI është të mbështesë qeverisjen efektive dhe politikat e bazuara në të dhëna të pakundër-shtueshme, duke ndihmuar Kongresin dhe Degën e Ekzekutivit të përmbushin përgjegjësitë e tyre. Për të promovuar qeverisjem efektive dhe politikat e bazuara në të dhëna të pakundërshtueshme, CEMI:

- punon për përmirësimin e metodat e vlerësimit
- propozon udhëzime për përfshirjen e informacionit të vlerësimit në politikë, buxhet dhe menaxhimin e programeve;
- promovon zhvillimin e njohurive.

Stafi i CEMI kryen studime të veta dhe në partneritet me ekipet e tjera, harton dokumente orientuese dhe konsultohet mbi metodat dhe politikat e vlerësimit të programeve brenda dhe jashtë GAO-s për të ndihmuar në shkëmbimin e njohurive dhe rritjen e kapacitetit të vlerësimit të agjencive federale.

Qendra për Shkencë, Teknologji dhe Inxhinieri (Center for Science, Technology, and Engineering CSTE)

CSTE ndihmon grupet e auditimit në auditimin e blerjeve në sistem, vlerësimin e kontraktonit, vlerësimin e kostos, menaxhimin e investimeve dhe teknologjisë, sigurinë kompjuterike dhe vlerësimin e cenueshmërisë së këtyre

sistemeve, si dhe analizën e antiterrorizmit, duke përfshirë zbulimin e armëve dhe gatishmërinë për katastrofat. CSTE gjithashtu identifikon praktikat më të mira në sektorin privat dhe publik dhe i përdor ato si kritere për punën e GAO-s.

Ekspertiza e CSTE fokusohet në përmirësimin e sigurisë kompjuterike, teknologjisë së informacionit dhe modernizimit të sistemeve, vlerësimi i maturimit të teknologjisë për sigurinë e vendit duke siguruar në këtë mënyrë saktësinë teknike të punës së GAO-s. Stafi i CSTE që ndihmon ekipet e auditimit zotëron një gamë të gjerë aftësish dhe përvoje. Disa janë inxhinierë me ekspertizë në inxhinierinë e sistemeve, zhvillimin dhe blerjen e software-ve, sistemet në kohë reale, rrjetet e të dhënave dhe vlerësimet e lidhura me teknologjinë dhe analizën e kostos. Disa prej tyre kanë përvojë në auditimet që lidhen me sigurinë, duke përfshirë sigurinë elektronike dhe kontrollet në sigurinë kompjuterike, të cilat përfshijnë sisteme testimi për të identifikuar dobësitë. Të tjerë janë shkencëtarë në fushat socialë dhe të edukimit , përvoja e të cilëve përfshin hulumtime në fushën e shkencës dhe teknologjisë për rastet e terrorizmit dhe përdorimit të armëve bërthamore, biologjike dhe kimike. Stafi i CSTE mund të ndihmojë grupet e auditimit të identifikojnë dhe interpretojnë kriteret për vlerësimin e performancës së programeve federale që përdorin pothuajse çdo lloj teknologjie.

2.5. Matja e efektivitetit në auditimet e performancës së GAO-s

Siç u përmend më parë, e gjithë puna dhe procesi i auditimit e kryer nga GAO është në përputhje me dokumentin e Standardeve të Përgjithshme të Auditimit të Qeverisë (GAGAS). Në GAGAS, auditimet e performancës përcaktohen si auditime që sigurojnë gjetje ose konkluzione bazuar në vlerësimin e dështmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme kundrejt kritereve. Auditimi i performancës në GAO me objektiv të përcaktimit ose vlerësimit të efektivitetit të programit mund të përfshijë gjithashtu një objektiv shtesë të vlerësimit të kontrolleve të brendshme për të përcaktuar arsyet për mungesën e efektivitetit të një programi ose se si efektiviteti mund të përmirësohet.

Për auditimet e performancës, GAGAS nuk përfshin standardet e tjera, por pranon se audituesit mund të përdorin ose mund t'u kërkohet të përdorin standarde të tjera profesionale siç janë:

- Standardet Ndërkombëtare për Praktikat Profesionale të Auditimit të Brendshëm të hartuar nga Instituti i Audituesve të Brendshëm;
- Parimet Udhëzuese për Vlerësuesit, të hartuara nga Shoqata Amerikane e Vlerësimit;

- Standardet e Vlerësimit të Programit, të hartuara nga Komiteti i Përbashkët mbi Standardet për Vlerësimin e Arsimit;
- Standardet për Testimin Arsimor dhe Psikologjik, të hartuara nga Shoqata e Psikologëve Amerikane.

Kapitulli 6 i GAGAS i është dedikuar standardeve të punës që kryhet në për auditimet e performancës. Në hyrje të këtij kapitulli theksohet se *"Qëllimi i kërkesave të punës në terren është të krijojë një qasje të përgjithshme për audituesit që të aplikojnë siguri të arsyeshëm se të dhënat (dëshmitë) janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet " ... mjaftueshmëria dhe përshtatshmëria e të dhënave të nevojshme dhe testimi i tyre do të ndryshojnë në bazë të objektivave, gjetjeve dhe konkluzioneve të auditimit".*

Në këtë kapitull, audituesit e GAO-s njihen dhe mund të gjejnë një përkufizim të efektivitetit në programet e qeverisë. Pra, efektiviteti i operacioneve të programit përcaktohet si kontrolli mbi operacionet e programit, përfshirë politikat dhe procedurat që njësia e audituar ka zbatuar për të siguruar siguri të arsyeshme dhe që një program i përmbush objektivat e tij, duke marrë parasysh efektivitetin e kostos dhe eficiencën. Kuptimi i këtyre kontrolleve mund të ndihmojë audituesit të kuptojnë operacionet e programit që konvertojnë inputet në rezultate. Në vlerësimin dhe matjen e efektivitetit të një programi të caktuar përkundrejt qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara të njësisë që auditohet, audituesit e GAO-s përfshijnë në planin e auditimit vlerësimin e politikave dhe procedurave të brendshme. Në vlerësimin e auditimit të brendshëm, audituesit e GAO-s fokusohen në raportimin se si planifikimi, organizimi, drejtimi dhe kontrolli i operacioneve të programeve ndikojnë në efektivitetin e programeve të caktuara qeveritare.

2.6. Të dhënat e përdorura në procesin e auditimit dhe rëndësia e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave në GAO.

Për të vlerësuar efektivitetin e agjencive federale ose një programi të caktuar të zbatuar prej tyre, GAO përdor metoda të ndryshme për mbledhjen dhe analiyimin e të dhënave. Metodologjia e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave varet nga fushëveprimi dhe kompleksiteti i auditimit dh përshkruan natyrën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit për mbledhjen dhe analizimin e këtyre të dhënave për të adresuar objektivat e auditimit. Sipas GAGAS, audituesit duhet të hartojnë metodologjinë për të pasur siguri të arsyeshme se të dhënat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet dhe për të zvogëluar në këtë mënyrë riskun e auditimit në një nivel të pranueshëm.

Koncepti i të dhënave të mjaftueshme dhe të përshtatshme është pjesë integrale e punës së audituesve të GAO-s. Në Librin e Verdhë (GAGAS), përshtatshmëria është përshkruar *si masë e cilësisë së të dhënave që përfshin rëndësinë, vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre për të siguruar mbështetje për gjetjet dhe përfundimet që lidhen me objektivat e auditimit*. Në vlerësimin e përshtatshmërisë të të dhënave, audituesit e GAO-s duhet të vlerësojnë nëse provat *janë relevante, të vlefshme dhe të besueshme*. Mjaftueshmëria në Librin e Verdhë (GAGAS) përshkruhet si *masë e sasisë së të dhënave të përdorura për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet që lidhen me objektivat e auditimit.* Në vlerësimin e mjaftueshmërisë së provave, audituesi e GAO-s duhet të përcaktojnë *nëse janë siguruar të dhëna të mjaftueshme për të bindur një person me dije të mjaftueshme se gjetjet janë të arsyeshme*.

Etablimi i koncepteve të informacionit të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm mbi të cilin mbështetet GAO fillon me procesin e planifikimit dhe vazhdon gjatë gjithë auditimit. Matrica e auditimit tregon se si do të përdoren dëshmitë e mbledhura për të hartuar gjetjet, konkluyionet dhe rekomandimet. Niveli i specifikimit mund të ndryshojë në varësi të llojeve të analizave dhe sa njohuri disponohet për këtë analiyë. Në GAO, grupet e auditimit kryejnë dhe dokumentojnë vlerësimet e vlefshmërisë dhe besueshmërisë për të gjitha të dhënat që përdoren në produktet e GAO-s për të mbështetur gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet. Audituesit, sipas rastit, ndjekin udhëzimet e GAO-s për vlerësimin e besueshmërisë së të dhënave kompjuterike të përpunuara. Në fazën e raportimit, është e rëndësishme që audituesit të përfshijnë një përshkrim të metodologjisë së përdorur për adresimin e objektivave të auditimit. Metodologjia e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave varet nga fushëveprimi dhe kompleksiteti i auditimit.

Tabela më poshtë paraqet metodat e mbledhjes së të dhënave të përdorura nga audituesit e GAO-s gjatë kryerjes së auditimeve të performancës, përshkrimet e metodave, përdorimin dhe përfitimet e përdorimit të secilës metodë.

Metodat për mbledhjen e të dhënave të përdorura nga audituesit e GAO-s gjatë kryerjes së auditimeve të performances.

Metoda	***Përshkrimi***	***Përdorimi dhe përfitimet***
Pyetësorët	Metoda e strukturuar e mbledhjes së informacionit nga individë apo institucione në një popullsi ose nga një masë kampionimi.	• Grumbullimi i të dhënave mund të përgjigjet deri në njëfarë mase pyetje. • Vlerësimi i saktë (me intervale konfidenciale) mund të sigurohet kur përdorni një mostër.

Metoda	*Përshkrimi*	*Përdorimi dhe përfitimet*
	Mënyra të ndryshme të grumbullimit të të dhënave (e vetëadministruar ose intervistuar) duke përdorur telefonin, postën, faksin, personalisht, në internet dhe e-mail.	
Intervista	Një intervistues individ i bën pyetje të një personi (të intervistuarit). Mund të kryhet me telefon ose personalisht. Tre lloje intervistash: të strukturuara (pyetjet janë të standardizuara), gjyëm të strukturuara (disa pyetje janë të standardizuara por lejojnë diskutime mëtë të thelluara) dhe jo strukturuar (pyetjet nuk janë të strukturuara).	• Intervistat gjysmë strukturuara dhe pa strukturuara mund të zhvillohet mjaft shpejt. • Mund të mblidhet shumë informacion dhe lejon pyetje të mëtejshme. • Lejon spontanitetin dhe hetimin gjatë intervistave. Mund të nxjerrë mendime nga informatorët kyç, të vërtetojë provat nga burime dhe të sigurojë pista për auditim.
Shqyrtimi dokumenteve ose observacioni i strukturuara	Hulumtuesi ndjek protokollin dhe përdor instrumentin e grumbullimit të të dhënave të strukturuara që më pas të vëzhgojë dhe regjistrojë të dhënat nga mbledhja fizike e skedarëve, vendeve ose objekteve	• Mundëson grumbullimin sistematik të të dhënave. • Përmirëson aftësinë hulumtuese për të analizuar më lehtë të dhënat e grumbulluara. • Stafi i shumëfishtë mund të mbledhë të dhëna në të njëjtën kohë.
Rastet studimore	Një vështrim në thellësi në një ose më shumë ngjarje, incidente ose vende, burime të shumta informacioni mund të përdoren për të ndihmuar krahasimin, kontrastin dhe kombinimin e perspektivave të ndryshme të të njëjtit proces.	• Mund të ofrojë më shumë informacion për një temë. • Qasje e metodave të shumëfishta për grumbullimin e të dhënave. Në disa raste studimore është vërtetuese. • Rrit besueshmërinë dhe vlefshmërinë e gjetjeve.
Metoda e grupeve të vogla	Prezantimi i metodave për të mbledhur mendime dhe ide nga një grupi i vogël njerëzish dhe për të gjeneruar ide të përgjithshme. Ka lloje të ndryshme, duke përfshirë grupet e fokusit dhe sesionet e diskutimit.	• Mund të ofrojë informacione të hollësishme për një temë ose marrëdhënie ndërmjet koncepteve. • Të planifikuara për të siguruar ndërveprimin në grup për një temë të caktuar. • Mund gjenerojë informacione dhe detaje të cilat nuk mund të merren nga intervistat individuale apo intervistat e njëpasnjëshme. • Mund të merret informacion nga njerëz me ekspertizë të veçantë ose interes në një temë.
Të dhëna të subjektit që auditohet ose të dhëna sekondare	Analiza e të dhënave ekzistuese si pjesë e auditimit. Të dhënat mund të jenë nga bazat e të dhënave të krijuara dhe të mirëmbajtura nga agjenci të ndryshme qeveritare, organizata të tjera si universitetet apo firma private kërkimore.	• Mund të analizohet grupi i plotë i të dhënave për një temë. • Zakonisht është më eficiente se mbledhja e të dhënave nga ana e grupit të auditimit për një temë të veçantë. • Të dhënat administrative në përgjithësi nuk janë objekt i paragjykimeve të

Metoda	*Përshkrimi*	*Përdorimi dhe përfitimet*
		vetëraportimit.
Shqyrtimi i studimeve	Vlerësimi i studimeve të publikuara përfshin një sërë teknikash, duke përfshirë rishikimin e një ose më shumë studimeve, sintezën e vlerësimit dhe meta-analizën.	• Përfshin grumbullimin sistematik të hulumtimeve të njohura dhe mund të lejojë adresimin e ankesave që shpesh mund të bëhen në të dyja palët. • Mund të jetë shumë më i shpejtë se sa zhvillimi i kërkimeve individuale mbi këtë temë. • Duke vlerësuar cilësinë e studimeve dhe duke theksuar çdo kufizim, kjo mund të përbëjë vlerë të shtuar për trupin ekzistues kërkimor.
Analiza e përmbajtjes	Metoda për strukturimin dhe analizimin e të dhënave cilësore si materiali i shkruar, filmi dhe media të tjera në mënyrë që të dhënat të mund të renditen dhe thjeshtohen në tema që mund të përmblidhen	• Ofron aftësi për të analizuar sistematikisht informacionin nga një material i shkruar. • Lejon përmbajtjen e të dhënave për të udhëhequr zhvillimin e kategorive analitike. • Rezultati i analizës mund të përmblidhet një kuptim.

Burimi: GAO, Qendra e të mësuarit, Seminari i mbledhjes së të dhënave

2.7. Follow up në GAO si një mekanizëm për matjen e efektivitetit të programeve dhe politikave të agjencive federale

Në Librin e Verdhë (GAGAS) përcaktohet se rekomandimet e GAO-s janë efektive kur veprimet e rekomanduara janë specifike, praktike, me kosto efektive dhe të matshme. Këto rekomandime duhet:

- të ngrihen logjikisht nga provat e paraqitura;
- të lidhen qartë me objektivat, katër elementet e gjetjeve dhe konkluzionet;
- të specifikojnë veprimet që janë të realizueshme, me kosto efektive dhe të matshme;
- të jenë të mbështetura në prova dhe të jenë bindëse;
- të adresojnë shkakun e mangësive të identifikuara.

Pas kryerjes së auditimit, qëllimi i raportit të auditimit të GAO-s është (1) të komunikojë rezultatet e auditimit subjektit të audituar; (2) t'i bëjë rezultatet më pak të ndjeshme ndaj keqkuptimit; (3) t'i bëjë rezultatet të disponueshme për publikun, dhe (4) të lehtësojë follow up për të përcaktuar nëse janë ndërmarrë veprime korrigjuese të përshtatshme.

Sipas GAGAS, si pjesë e përgjegjësive audituese të GAO-s, kjo e fundit ndjek rekomandimet që ka bërë dhe raporton në Kongres për statusin e tyre.

Përvoja e GAO ka treguar se duhet kohë që disa rekomandime të zbatohen. Për këtë arsye, përqindja e rekomandimeve të zbatuara, është përqindja e zbatimit

të rekomandimeve të bëra 4 vjet parë (p.sh. për vitin 2017 përqindja e zbatimit të rekomandimeve i referohet rekomandimeve të bëra në vitin fiskal 2013 që janë zbatuar deri në fund të vitit fiskal 2017). Përvoja e GAO-s është se nëse një rekomandim nuk është zbatuar brenda 4 viteve, nuk ka gjasa që të zbatohet. Statusi i zbatimit të rekomandimeve raportohet në aplikacionin për ndjekjen e rekomandimit të GAO. Ky aplikacion i bazuar në taktikën IT lejon stafin të përditësojë statusin e rekomandimeve gjatë gjithë vitit. Aplikacioni regjistron informacion mbi statusin e rekomandimeve dhe nëse janë ndërmarrë veprime të përshtatshme korrigjuese dhe këto veprime janë kryer në kohë. Informacioni përdoret për të matur shkallën e zbatimit të rekomandimeve dhe në këtë mënyrë matet edhe efektiviteti i programeve qeveritare. Është e rëndësishme të theksohet se 80 % e rekomandimeve të GAO janë zbatuar nga agjencitë federale.

Edhe pse shkalla e zbatimit të rekomandimeve të GAO-s është e lartë, në mënyrë që të ndihmojë Kongresit për të bërë qeverinë më të përgjegjshme GAO ka hartuar një dokument për programet qeveritare me risk të lartë. Dokumenti *"Përcaktimi i sfidave të performancës e llogaridhënies dhe risqeve të larta"* nënvizon kriteret dhe procesin e përcaktimit të sfidave të performancës e llogaridhënies dhe ato që konsiderohen të jenë me risk të lartë.

Për çdo agjenci federale, GAO identifikon programin dhe fushat kryesore që janë baza primare për raportimin në Serinë e Performancës dhe Përgjegjshmërisë, të cilat :

- janë në qendër të vëmendjes së Kongresit dhe ekzekutivit;
- kanë interes të lartë publik dhe / ose shpenzime të mëdha;
- figurojnë në mënyrë të dukshme në planet strategjike të agjencive dhe planet e raportet vjetore të performancës;
- njihen performancë e llogaridhënie ose çështje me risk të lartë.

Faktorët cilësorë të përdorur nga GAO në përcaktimin e riskut të lartë për programet e agjencive federale janë:

- shëndeti ose siguria[9];
- ofrimi i shërbimeve;
- •siguria kombetare;
- mbrojtja kombëtare;
- rritja ekonomike;
- privatësia ose të drejtat e qytetarëve.

Risku i faktorëve të lartpërmendur gjithashtu mund të rezultojë në:

- shërbime ndjeshëm të pabarabarta,
- dështime të një programi,
- efektivitet të zvogëluar dukshëm ,
- eficencë të zvogëluar dukshëm,

[9] *Përcaktimi i Sfidave të Performancës e llogaridhënies dhe risqet e larta ", fq. 9*

- lëndimi ose humbje të jetës së qytetarëve,
- të dhëna jo të besueshme për marrjen e vendimeve,
- zvogëlon besimin tek qeveria, dhe
- zbulimin, manipulimin ose keqpërdorimin e paautorizuar i informacioneve sensitive, të tilla si menaxhimi i të dhënave financiare ose personale ose të të dhënave të mirëmbajtura në sistemet kompjuterike.

Përvoja e GAO-s ka treguar se elementët kryesorë që nevojiten për të bërë përparim në zonat me risk të lartë janë vëmendja e nivelit të lartë menaxherial të administratës ose agjencive të bazuara në pesë kriteret për largimin nga Lista e Riskut të Lartë .

GAO për këtë ka përcaktuar pesë kritere të cilat si më poshtë:

- Angazhimi i lidershipit – Demonstrimi i përkushtim dhe mbështetja e lartë e lidershipit.
- Kapaciteti - Agjencia ka kapacitetin (p.sh. njerëz dhe burime) për të minimizuar riskun.
- Plani i Veprimit - Ekziston një plan veprimi korrigjues që përcakton shkaqet kryesore, zgjidhjet dhe siguron përfundimin substancial të masave korrigjuese, duke përfshirë hapat e nevojshëm për zbatimin e zgjidhjeve të rekomanduara nga GAO.
- Monitorimi - Është krijuar një program për të monitoruar dhe vlerësuar në mënyrë të pavarur efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e masave korrigjuese.
- Demonstrimi i progresit-A aftësi për të demonstruar progres në zbatimin e masave korrektuese dhe në minimizimin e zonave me risk të lartë.

Për secilën zonë të riskut të lartë, GAO jep një përshkrim përse kjo zone përbën risk të lartë, çfarë ka gjetur GAO gjatë auditimit të kësaj zone, çfarë duhet të bëhet, përfitimet e arritura nga zbatimi i rekomandimeve të GAO-s. Lista aktuale e GAO-s përmban 34 zona me risk të lartë. Tabela më poshtë tregon se si GAO vlerëson përpjekjet e agjencive federale për t'u larguar nga Lista e Riskut të Lartë.



Raporti mbi programet me risk të lartë publikohet nga GAO çdo 2 vjet dhe është në dispozicion të publikut. Këto raporte ndihmojnë Kongresin që të identifikojë përparimin e bërë nga agjencitë në adresimin e rekomandimeve të GAO-s dhe të marrë

masa (të tilla si shkurtimi i buxhetit) ndaj agjencive që nuk zbatojnë rekomandimet e GAO. Ky mjet i përdorur nga GAO është provuar të jetë shumë efektiv. Në raportin e botuar në shkurt të vitit 2017, raporti i GAO-s tregon se shumë prej 32 zonave me risk të lartë në listën e 2015-ës kanë treguar progres solid[10]. Njëzet e tre fusha me risk të lartë, ose dy të tretat e të gjitha zonave, kanë përmbushur ose pjesërisht plotësojnë të pesë kriteret për largimin nga Lista e Riskut të Lartë, 15 nga këto zona përmbushën plotësisht të paktën një kriter. Progresi është bërë i mundur përmes përpjekjeve të përbashkëta të Kongresit dhe udhëheqjes e stafit në agjencive federale.

KREU III

Diferenca ndërmjet Zyrës së Auditimit të Qeverisë dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit në matjen e efektivitetit të programeve qeveritare

Krahasimet midis qasjes së GAO-s dhe qasjes së KLSH-së në lidhje me kryerjen e auditimeve të performancës me fokus në matjen e efektivitetit të programit qeveritare ndihmon në identifikimin e fushave që kanë nevojë për përmirësime nga KLSH dhe gjithashtu kanë potencial për të adresuar në mënyrë efektive çështjet që përbëjnë shqetësim për KLSH.

Tabela më poshtë paraqet një krahasim midis qasjes së GAO-së dhe qasjes së KLSH -së në kryerjen e auditimeve të performancës me fokus në matjen e efektivitetit të programeve qeveritare.

[10] Seria e Dokumenteve të Listës me Risk të Lartë , shkurt 2017.

Qasja e GAO dhe qasja e KLSH-së për kryerjen e auditimeve të performancës

Institucioni	*GAO*	*KLSH*
Mandati	Auditimi i përdorimit të parave publike nga agjencitë federale.	Auditimi i përdorimit të parave publike nga entitetet qendrore, lokale dhe ente të tjera publike.
Misioni	GAO është një institucion i pavarur, jo-partizan që punon për Kongresin. Misioni i tij është të mbështesë Kongresin në përmbushjen e përgjegjësive të tij kushtetuese, për të ndihmuar në përmirësimin e performancës dhe për të siguruar llogaridhënien e qeverisë federale për të mirën e qytetarëve amerikanë.	Misioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit si institucion i pavarur kushtetues është të informojë publikun dhe Parlamentin për përdorimin e burimeve publike nga qeveria qendrore dhe lokale dhe subjektet e tjera publike si dhe promovimin e llogaridhënies dhe transparencës në të gjithë sektorin publik në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), duke kontribuar në qeverisjen e mirë përmes luftës kundër korrupsionit.
Inicimi i aktivitetit auditues	Me kërkesën e anëtarëve të Kongresit, përcaktimeve të bëra në ligje të veçanta dhe me inicjativën e Kontrollorit të Përgjithshëm	Është e lirë të vendoset për planin e auditimit, temën e auditimit dhe kohën e përshtatshme për kryerjen e punës së auditimit.
Llojet e auditimit që kryhen	80% janë auditime performance dhe pjesa tjetër janë auditime financiare dhe dëshmi auditimi	Përgjithësisht auditime përputhshmërie , por KLSH kryen edhe auditime financiare, auditime performance dhe auditime IT.
Standardet për kryerjen e auditimit	Standardet e Përgjithshme të Pranuara të Auditimit	• Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) • Manuali i Auditimit të Performancës • Udhëzuesi i Auditimit të Performancës • Indikatorët e Performancës
Metodologjia	Metodologji e detajuar e përshkruar në GAGAS për	Mangësi në përshkrimin e detajuar të metodologjive për mbledhjen dhe

	mbledhjen dhe analizimin e të dhënave dhe në dokumente të tjera të GAO-s	analiyimin e të dhënave në manualin e Departamentit të Auditimit të Performancës.
Palët e interesit të përfshira në auditim	Drejtuesit e Lartë, Drejtori i Departamentit, Zv/Drejtori, ekipi i auditimit (audites, audites të lartë dhe analistë) dhe specialistë të tillë si avokatët, statisticienët, specialistët për pyetsorë, ekonomistët dhe specialistë të tjerë me ekspertizë të veçantë konsultohen sipas nevojës kur auditimet përfshijnë qasje në fushat e tyre të ekspertizës.	Drejtori i Departamentit, grupi i auditimit, Kryeaudituesi dhe ekspertë të jashtëm kur është e nevojshme.
Follow up	• Përvoja e GAO-s ka treguar se duhet kohë që disa rekomandime të zbatohen. Për këtë arsye, përqindja e rekomandimeve të zbatuara - është përqindja e zbatimit të rekomandimeve të bëra 4 vjet para një viti fiskal të caktuar (p.sh. për vitin 2017 është përqindja e rekomandimeve të bëra në vitin fiskal 2013). • Follow up është pjesë e procesit të auditimit në të njëjtat agjenci federale. Statusi i zbatimit të rekomandimeve raportohet në aplikimin për ndjekjen e Rekomandimit të GAO-s i cili përditësohet çdo vit. GAO ka hartuar një dokument për programet qeveritare me risk të lartë. Dokumenti "*Përcaktimi i Sfidave të Performancës e Llogaridhënies dhe Risqeve të Larta*" nënvizon kriteret dhe procesin e përcaktimit të sfidave të performancës e llogaridhënies	• Follow up bëhet në auditimet në vazhdim, duke raportuar se si janë zbatuar rekomandimet e KLSH në auditimin e mëparshëm. • Në fund të çdo viti, KLSH kryen një auditim mbi mënyrën se si janë zbatuar planet e veprimit të raportuara nga subjektet e auditimit. • KLSH ende nuk ka konsoliduar një bazë të të dhënave për rekomandimet e auditimit dhe kjo e bën të vështirë follow up, veçanërisht për auditimet e performancës. • KLSH nuk ka zhvilluar mjete dhe procese për të identifikuar një listë të programeve qeveritare me risk të lartë.

	dhe ato që konsiderohen si risqe të larta. GAO publikon çdo 2 vjet një raport mbi programet me risk të lartë dhe raporti është në dispozicion të publikut.	

KREU IV

Konkluzione

Shkalla e lartë e zbatimit të rekomandimeve nga agjencitë federale në Shtetet e Bashkuara demonstron edhe njëherë suksesin e GAO në përmbushjen e misionit të tij për të ndihmuar në përmirësimin e performancës dhe sigurimin e llogaridhënies së qeverisë federale për të mirën e qytetarëve amerikanë. Ashtu siç është theksuar në kapitujt e mëparshëm, suksesi i GAO-s në matjen e efektivitetit të programeve qeveritare mbështetet në krijimin e standardeve dhe procedurave të suksesshëm të auditimit të cilat janë shumë të detajuara dhe ndihmojnë audituesit në të gjitha fazat e punës së auditimit. Në përgjigje të nevojave të Kongresit, GAO ka ndërtuar kapacitete institucionale dhe i ka kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit profesional të stafit të tij me qëllimi final të hartimit të produkteve cilësore të auditimit.

Duke analizuar qasjet e GAO-s dhe KLSH-së në kryerjen e auditimeve të performances, veçanërisht me fokusin tek matja e efektivitetit të programeve qeveritare, KLSH-ja ende përballet me disa sfida. Disa nga këto sfida kërkojnë veprime brenda KLSH-së dhe varen tërësisht nga mjetet dhe procedurat që do të hartohen nga lidershipi për t'iu përgjigjur këtyre sfidave. Sfidat e tjera janë më komplekse dhe kërkojnë jo vetëm zhvillimin e politikave, por edhe përfshirjen dhe mbështetjen e palëve të interesit.

Bazuar në analizën e bërë mësipërm, mund të merren të merret në konsiderate sugjerimet e mëposhtme:

1. Zhvillimi i një udhëzuesi dhe një liste të programeve qeveritare me risk të lartë.

Për të rritur normën e zbatimit të rekomandimeve të tij dhe për t'i raportuar Parlamentit dhe publikut për efektivitetin e programeve qeveritare, KLSH të hartojë një udhëzues për përcaktimin e sfidave të performancës e llogaridhënies dhe riskut të lartë në programet qeveritare. Udhëzuesi duhet të përdoret si metodologji për hartimin e një liste të programeve qeveritare me risk të lartë. Kjo listë do të ndihmonte Parlamentin në marrjen e vendimeve efektive për miratimin e buxhetit dhe

rritjen e besimit të publikut tek një qeverisje më transparente dhe llogaridhënëse.

2. Të hartohet një udhëzues, mjete dhe procese të nevojshme për të krijuar një bazë të dhënash për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të performancës.

KLSH të hartojë një udhëzues, mjete dhe procese të nevojshme për të krijuar një bazë të dhënash për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të performancës. Etablimi i një baze të dhënash do të shërbejë si bazë për raportimin e veprimeve të ndërmarra nga qeverisja qendrore dhe lokale për të përmirësuar programet e tyre dhe për të matur efektivitetin e aktiviteteve të qeverisë.

3. Shqyrtimi dhe ndryshimi i Manualit të Departamentit të Auditimit të Performancës.

KLSH të rishikojë dhe ndryshojë Manualin e Departamentit të Auditimit të Performancës për të siguruar që ky dokument thelbësor do të ndihmojë audituesit me metodologji të përshtatshme për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, duke u dhënë atyre një përshkrim të secilës metodë, kur metoda mund të përdoret për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave dhe kufizimet e metodave specifike.

4. Riorganizimi i Departamentit të Metodologjive dhe Politikave të Auditimit dhe zhvillimi i një politike tërheqëse për burimet njerëzore për punësimin e ekspertëve të kualifikuar.

Për të siguruar që produktet e KLSH-së janë të bazuara në metodologji të efektive auditimi, KLSH të riorganizojë Departamentin e Metodologjive dhe Politikave të Auditimit duke rritur numrin e punonjësve në këtë departament, të cilët kanë njohuritë dhe përvojën e duhur për të ndihmuar audituesit me metodologjitë e duhura gjatë gjithë procesin e auditimit. KLSH gjithashtu duhet të marrë në konsideratë zhvillimin e një politike atraktive të burimeve njerëzore për punësimin e ekspertëve të kualifikuar në KLSH.

5. Zhvillimi i politikave për përfshirjen e palëve të tjera të interesit në mbështetjen e grupeve të auditimit të performancës gjatë gjithë procesit të auditimit.

KLSH të hartoj politika për përfshirjen e palëve të tjera të interesit (si specialist të pyetësorëve, ekonomistët dhe specialistë të tjerë) për të mbështetur grupet e auditimit të performances gjatë gjithë procesit të auditimit. Ekspertiza specifike e këtyre palëve të interesit do të ishte një vlerë e shtuar, duke siguruar që raportet e KLSH do të jenë një burim i besueshëm informacioni për Parlamentin dhe publikun në matjen e efektivitetit të programeve qeveritare.

6. Zhvillimi i programeve të trajnimit për audituesit e performancës të cilat do të përqendrohen në metodologjitë e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

KLSH duhet të hartojë programe trajnuese që përqendrohen në metodologjitë e mbledhjes dhe analizimin e të dhënave. Këto programe trajnimi duhet të jenë shumë specifike për të ndihmuar audituesit e performancës të zgjedhin metodologjinë e duhur mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të nevojshme për të arritur përfundime dhe për të hartuar rekomandime që matin efektivitetin e programeve qeveritare.

KREU V

Eksperience e përfituar

Përvoja 7 vjeçare ka treguar se, garancia për suksesin e KLSH-së ishte dhe është angazhimi i fortë i lidership-it për të bërë ndryshime të mëdha që përqendrohen në përmirësimin e vazhdueshëm të politikave dhe procedurave si dhe procesin e mësimit dhe trajnimit të vazhdueshëm e audituesve të tij.

Bazuar në përvojën e GAO-s, një analizë e suksesshme dhe e thelluar e sfidave të përmendura më sipër dhe politikat dhe procedurat e propozuara për të adresuar dhe kapërcyer këto sfida mund të përmirësojnë të gjithë procesin e auditimit të performancës, duke siguruar që KLSH të jetë burim i besueshëm i informacionit për Parlamenti dhe publiku në matjen e efektivitetit të programeve qeveritare.

Lista e riskut të lartë për programet qeveritare marrë si një eksperiencë dhe mjet i suksesshëm i hartuar nga GAO dhe i aksesueshëm nga publiku do të rriste presionin ndaj entiteteve të qeverisjes qendrore dhe lokale për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së për të përmirësuar programet dhe operacionet e tyre.

Objektivi i KLSH-së për ta bërë qeverinë më transparente dhe llogaridhënëse mund të arrihet duke hartuar metodologji që përqendrohen në analizimin e të dhënave të mbledhura për të arritur konkluzione dhe për të bërë rekomandime që lindin logjikisht nga provat e paraqitura, të lidhura qartë me objektivat e auditimit të performancës, dhe që specifikojnë veprimet që mund të realizohen me kosto të matshme dhe efektive. Siç tregon edhe shembulli i GAO-s, suksesi i auditimit të performancës në KLSH do të matet nga rekomandimet e implementuara nga subjektet e audituara dhe nga ndikimi i rekomandimeve në rritjen e ekonomisë shqiptare dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve të saj.

E gjithë kjo mund të arrihet vetëm me mbështetjen e Parlamentit dhe bashkëpunimin e KLSH me palët e tjera të interesit si dhe angazhimin e stafit në hartimin e produkteve cilësore.

Lista e shkurtimeve

GAO – Zyra e Auditimit të Qeverisë së SHBA

KLSH– Kontrolli i Lartë i Shtetit

BE – Bashkimi Evropian

INTOSAI – Organizata ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit

ISSAI – International Standards of Supreme Audit Institutions

NSDA – Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Nga: Alma Shehu, Audituese, KLSH

Kontrolli i Brendshëm në Shtete e Bashkuara të Amerikës
Mësime për t'u ndarë me Shqipërinë

Punim i paraqitur nga audituesi Alfonc Gabili, në përfundim të Fellowship-it në GAO

Kontrolli i brendshëm nuk është një ngjarje apo rrethanë, por një seri veprimesh që përshkojnë aktivitetet e një njësie ekonomike. Këto veprime ndodhin në të gjithë proceset e një njësie ekonomike në mënyrë të vazhdueshme. Ato janë të përhapura dhe të qenësishme në mënyrën e menaxhimit të drejtimit të organizatës.

Nga: Alfonc Gabili, Auditues i Lartë, KLSH

Preambula

Kontrolli i brendshëm nuk është një ngjarje apo rrethanë, por një seri veprimesh që përshkojnë aktivitetet e një njësie ekonomike. Këto veprime ndodhin në të gjithë proceset e një njësie ekonomike në mënyrë të vazhdueshme. Ato janë të përhapura dhe të qenësishme në mënyrën e menaxhimit të drejtimit të organizatës. Kontrolli i brendshëm është ndryshe nga këndvështrimi i disa vëzhguesve që e shohin atë si diçka të shtuar në aktivitetet e një njësie ekonomike ose si një barrë e nevojshme. Sistemi i kontrollit të brendshëm është i ndërthurur me aktivitetet e njësisë dhe është më efektiv kur është ndërtuar në infrastrukturën e njësisë dhe është pjesë përbërëse e organizatës. Kontrolli i brendshëm duhet të ndërtohet brenda njësisë në vend se të ndërtohet mbi njësinë. Duke ndërtuar në kontrollin e brendshëm, ai bëhet pjesë e proceseve themelore të menaxhimit të planifikimit, ekzekutimit dhe monitorimit. Ndërtuar i njësisë sipas kontrollit të brendshëm gjithashtu ka implikime të rëndësishme për kontrollin e kostove. Shtimi i procedurave të reja të kontrollit që janë të ndara nga procedurat ekzistuese shton kostot. Duke u fokusuar në operacionet ekzistuese dhe kontributin e tyre në kontrollin e brendshëm efektiv, dhe duke integruar kontrollet në aktivitetet themelore operative, një organizatë shpesh mund të shmangë procedurat dhe shpenzimet e panevojshme.

Njerëzit janë ato që bëjnë punën e kontrollit të brendshëm. Ajo realizohet nga individë brenda një organizate, me atë që ata bëjnë dhe thonë.

Rrjedhimisht, kontrolli i brendshëm është i prekur nga njerëzit. Njerëzit duhet të njohin rolet dhe përgjegjësitë e tyre dhe kufijtë e autoritetit të tyre.

Çdo organizatë merret kryesisht me arritjen e misionit të saj. Subjektet ekzistojnë për një qëllim - sektori publik në përgjithësi merret me ofrimin e një shërbimi dhe një rezultat të dobishëm për publikun.

Cilado qoftë misioni, një organizatë do të përballet me riskun për ta arritur atë. Detyra e menaxhimit është identifikimi dhe reagimi ndaj këtyre risqeve, për të maksimizuar gjasat për arritjen e misionit të entitetit. Kontrolli i brendshëm mund të ndihmojë në adresimin e këtyre risqeve; megjithatë mund të sigurojë siguri të arsyeshme për arritjen e misionit dhe objektivave të përgjithshme.

Pavarësisht se sa mirë është projektuar dhe operuar, kontrolli i brendshëm nuk mund të ofrojë siguri absolute të menaxhimit në lidhje me arritjen e objektivave të përgjithshme. Në vend të kësaj, udhëzimet pranojnë se vetëm një "nivel i arsyeshëm sigurie" është i arritshëm. Siguria e arsyeshme barazohet me një nivel të kënaqshëm besimi në bazë të konsideratave të shpenzimeve, përfitimeve dhe risqeve. Përcaktimi se sa siguri është e arsyeshme kërkon gjykimin. Në ushtrimin e atij gjykimi, menaxherët duhet të identifikojnë risqet e qenësishme në operacionet e tyre dhe nivelet e pranueshme të riskut në rrethana të ndryshme dhe të vlerësojnë riskun në mënyrë sasiore dhe cilësore.

Kontrolli i brendshëm është i përshtatur për arritjen e një serie të ndarë por të ndërlidhur të objektivave të përgjithshme. Këto objektiva të përgjithshme zbatohen përmes nën objektivave, funksioneve, proceseve dhe aktiviteteve të shumta specifike.

Audituesit janë pjesë e një strukture të kontrollit të brendshëm të një organizate qeveritare, por ata nuk janë përgjegjës për zbatimin e procedurave specifike të kontrollit të brendshëm në një organizatë të audituar. Roli i audituesve është të auditojë politikat, praktikat dhe procedurat e kontrollit të brendshëm të një organizate për të siguruar që kontrollet janë adekuate për të arritur misionin e organizatës. Megjithëse audituesit mund të jenë pjesë e organizatës që ata auditojnë, është e rëndësishme dhe e domosdoshme që të ruhet pavarësia e tyre. Një njësi e auditimit të jashtëm gjithashtu mund të luajë një rol në kontrollin e kontrollit të brendshëm të njësisë qeveritare.

I. Hyrje në Sistemet e Kontrollit të Brendshëm Shqiptar

I.1. Albanian approach to Internal Control.

Kontrollet e brendshme ndihmojnë subjektet të arrijnë objektiva të rëndësishme dhe të mbështesin dhe

përmirësojnë performancën. Ato janë komponentë të rëndësishëm për rritjen e llogaridhënies në operacionet qeveritare. Politikëbërësit dhe menaxherët e programeve vazhdimisht kërkojnë mënyra për të përmirësuar llogaridhënien në arritjen e një misioni të njësisë. Një faktor kyç në përmirësimin e llogaridhënies në arritjen e misionit të njësisë është implementimi i një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm. Kontrolli i brendshëm është një proces i krijuar nga një organ mbikëqyrës, menaxhimi dhe personeli tjetër i një njësie ekonomike që ofron siguri të arsyeshme se objektivat që lidhen me operacionet, pajtueshmërinë dhe raportimin do të arrihen. Ajo shërben gjithashtu si linja e parë e mbrojtjes në ruajtjen e aseteve.

Rrënjët e rregullimit të kontrollit të brendshëm Shqiptar, fillojnë në vitin 1992. Kjo ishte data e krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Institucionit Suprem të Auditimit Shqiptar. Në vitin 2003, ligji i parë për auditimin e brendshëm u miratua nga Parlamenti, i cili krijoi Departamentin e Përgjithshëm të Auditimit të Brendshëm brenda Ministrisë së Financave. Ky ligj siguroi bazën për zhvillimin e konceptit të kryerjes së auditimeve në sektorin publik dhe themeloi strukturën e pavarur të auditimit të brendshëm. Bazuar në këtë ligj, strukturat e kontrollit financiar u kthyen në struktura të auditimit të brendshëm. Në vitin 2007, bazuar në praktikat më të mira të organizatave të tjera të auditimit të brendshëm, u miratua një ligj i ri për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik.

Për më tepër, si pjesë e procesit të përmirësimit të legjislacionit, në vitin 2008 Kuvendi miratoi ligjin nr. 9936 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Ky ligj paraqiti udhëzimet për kontrollin e brendshëm në entitetet publike ose ashtu siç quhet Financa e Brendshme Publike dhe Kontrollit (PFIC). Në vitin 2010, qeveria shqiptare krijoi një ligj lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin, i cili deklaroi se Ministri i Financave është autoriteti përgjegjës për miratimin e udhëzimeve për menaxhimin financiar dhe kontrollin në entitetet publike. Sipas këtij ligji, Kontrolli i Brendshëm përcaktohet si “...një proces integral i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe i auditimit të brendshëm, i vendosur nga titullari i njësisë publike, brenda objektivave të tij qeverisës, për të ndihmuar në kryerjen e veprimtarive të njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.”.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli është definuar si: “...një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë person li, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci

të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

1. Veprimtarive efektive, efiçiente dhe me ekonomi.

2. Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat.

3. Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota.

4. Mbrojtjes së informacionit dhe aktiveve".

Lista e GAO për Riskun e Lartë synon të ndihmojë agjencinë dhe ekzekutivin të japin vëmendje në identifikimin dhe zgjidhjen e sfidave të performancës dhe llogaridhënies dhe problemeve me risk të lartë. Fusha e Performancës dhe Përgjegjshmërisë së GAO-s dhe azhornimi i Riskut të Lartë janë një mënyrë e rëndësishme për të vlerësuar përparimin në arritjen e këtij objektivi.

Përmes këtyre përpjekjeve, GAO është angazhuar për të ndihmuar Kongresin për të përmirësuar ekonomicitetin, eficencën dhe efektivitetin e operacioneve federale. Gjithashtu të rrisë respektin e publikut dhe besimin në qeverinë federale.

III.2. Krijimi i bashkësive të praktikës

Në qeverinë federale, një tjetër mjet efektiv në zhvillimin e mirëkuptimit dhe qasjes në zbatimin e kontrollit të brendshëm është nëpërmjet krijimit të bashkësive të praktikës. Këshilli i ZKF-së është një shembull i një bashkësie të tillë praktike. "Me udhëheqjen e ZKF federale, zyrtarë të lartë në zyrën e menaxhimit dhe buxhetit dhe thesarin e SHBA, këshilli i ZKF-së merret me çështjet më të ngutshme në menaxhimin financiar federal me anë të lidershipit bashkëpunues".

Këshilli u krijua në bazë të Aktit të Zyrtarëve Kryesorë Financiar (CFO) të vitit 1990 (e drejta publike 101-576). Ajo një organizatë e ZKF-ve dhe Zëvendës ZKF-ve të agjencive më të mëdha federale, zyrtarë të lartë të Zyrës së Menaxhimit dhe Buxhetit, dhe Departamenti i Thesarit të cilët punojnë në bashkëpunim për të përmirësuar menaxhimin financiar në Qeverinë e SHBA. Këshilli u krijua sipas dispozitave të Aktit të ZKF-së të vitit 1990 për të këshilluar dhe koordinuar aktivitetet e agjencive anëtare në çështje të tilla si, konsolidimi dhe modernizimi i sistemeve financiare, përmirësimi i cilësisë së informacionit financiar, të dhënave financiare dhe standardeve të informacionit, kontrolleve të brendshme, legjislacionit që ndikon në operacionet financiare dhe organizatat, dhe çdo çështje tjetër të menaxhimit financiar. Anëtarësia e Këshillit Kryesor Financiar përfshin:

- Zëvendës Drejtor-in për Menaxhimin e Zyrës së Menaxhimit dhe Buxhetit, i cili vepron si Kryesues i Këshillit;
- Kontrollues i Zyrës së Menaxhimit Financiar Federal të Zyrës së Menaxhimit dhe Buxhetit;

- Ndihmës Sekretar Fiskal i Thesarit; dhe
- Zyrtarët kryesorë financiarë të departamenteve të renditura më poshtë:

Departamenti i Bujqësisë
Departamenti i Tregtisë
Departamenti i Mbrojtjes
Departamenti i Arsimit
Departamenti i Energjisë
Departamenti i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore
Departamenti i Sigurisë Kombëtare dhe Zhvillimit Urban
Departamenti i Brendshëm
Departamenti i Drejtësisë
Departamenti i Punës
Departamenti i Shtetit
Departamenti i Transportit
Departamenti i Thesarit
Departamenti i Çështjeve të Veteranëve
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit
Administrata Kombëtare e Aeronautikës dhe Hapësirës
Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar
Administrimi i Shërbimeve të Përgjithshme
Fondacioni Kombëtar i Shkencës
Komisioni Rregullator Bërthamor
Zyra e Menaxhimit të Personelit
Administrata e Biznesit të Vogël
Administrata e Sigurimeve Shoqërore

Anëtarët e Këshillit identifikojnë çështjet kyçe të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të Aktit të ZKF, të vitit 1990 dhe për të përmirësuar udhëheqjen e menaxhimit financiar. Që kur ky akt u përkthye në ligj ka pasur progres substancial dhe shumë arritje pozitive. Anëtarët e Këshillit Individual kanë bërë përpara për të udhëhequr komitetet dhe projektet e veçanta për të përmirësuar menaxhimin financiar në mbarë qeverinë. Këshilli vazhdimisht shqyrton përparimin në secilën fushë të theksuar. Prioritetet aktuale janë:

- Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit financiar;
- Zbatimin efektiv të Aktit të Performancës dhe Rezultateve të Qeverisë;
- Opinione të sigurta mbi agjencitë dhe pasqyrat financiare të audituara në mbarë qeverinë;
- Zhvillimi i fuqisë punëtore cilësore në fushën e menaxhimit financiar;
- Përmirësimi i menaxhimit të huave, mbledhjes së taksave dhe borxheve;
- Hartimi i sistemeve të menaxhimit për të përmirësuar llogaridhënien për performancë;
- Modernizimi i pagesave dhe metodave të biznesit nëpërmjet tregtisë elektronike.

Kryesuesi i Këshillit është Zëvendësdrejtori për Menaxhimin e Zyrës së Menaxhimit dhe Buxhetit. Kontrollori i Zyrës së Menaxhimit dhe Buxhetit, udhëheq aktivitetet e Këshillit në emër të Kryesuesit.

Konferenca Federale E Menaxhimit Financiar (PPPMF)

Programi i Përbashkët i Përmirësimit të Menaxhimit Financiar (PPPMF) është një aksion i përbashkët dhe bashkëpunues i ndërmarrë nga Departamenti Amerikan

i Thesarit, Zyra e Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO), Zyra e Menaxhimit dhe Buxhetit dhe Zyra e Menaxhimit të Personelit. Duke punuar në bashkëpunim me njëra-tjetrën dhe agjenci të tjera, qëllimi i PPPMF është të përmirësojë praktikat e menaxhimit financiar në qeverinë federale. Kjo përpjekje arrin kulmin në një konferencë vjetore të menaxhimit financiar federal, ku

morën pjesë qindra profesionistë të menaxhimit financiar dhe prezantime nga drejtuesit e qeverisë.

Iniciativat e Këshillit aktual të Zyrtarit Financiar:

Janë dizajnuar Alarme të Kontrolluesit për të nxjerrë në pah çështjet emergjente të menaxhimit financiar që mund të kërkojnë vëmendje ose veprime të agjencisë. Këto njoftime kanë për qëllim të informojnë Zyrën e Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF) për çështjet kyçe, ku Zyra e Menaxhimit dhe Buxhetit (OBM) beson se veprimet e mëtejshme mund të garantohen, por nuk përbëjnë udhëzime zyrtare ose nuk përcaktojnë detyra specifike për agjencitë përtej shqyrtimit të hapave për të adresuar çështjen.

Programi i CXO Fellows përbëhet nga yjet në rritje në financat federale, prokurimet dhe sektorët e TI, në nivelin e mesit të karrierës, që kanë treguar potencial të lidershipit dhe përgatit këta liderë të ardhshëm mendimtarë të ecin përpara në hapësirën e menaxhimit federal.

Programi CXO Fellowship është i përkushtuar për të siguruar pasurimin e mundësive të zhvillimit profesional për gjeneratën e ardhshme të udhëheqësve federalë në prokurimet, financat, burimet njerëzore dhe teknologjinë e informacionit. Programi ofron një mundësi për udhëheqësit federalë të rriten profesionalisht përmes një grupi unik seminaresh dhe ngjarjesh edukative.

Gjatë programit njëvjeçar, praktikantët takohen me udhëheqësit në komunitetin e menaxhimit federal dhe mësojnë rreth operacioneve të reja qeveritare nëpërmjet seminareve edukative dhe ngjarjeve "Brenda Qeverisë". Qëllimi i programit është të sigurojë një perspektivë unike në misionet inovative të udhëhequra nga agjencitë federale.

Praktikantët e përzgjedhur mbeten në pozicionet e tyre aktuale të punës dhe marrin pjesë në dy ose tre ngjarjet e programit çdo muaj, me një angazhim total kohor prej dhjetë deri në pesëmbëdhjetë orë në muaj. Të gjithë praktikantët pritet të marrin pjesë në aktivitetet unike të Programit përfshirë seminaret, ngjarjet "brenda qeverisë", dhe programet speciale. Praktikantët janë punonjës federal të nivelit të mesëm që kanë demonstruar potencial të lidershipit.

Menaxhimi i Riskut të Ndërmarrjeve

Ndërsa njësitë federale vazhdojnë të përqendrohen në zgjidhjet e agjencive për të menaxhuar risqet që ndikojnë në objektivat strategjike dhe taktike dhe përdorimin e burimeve, Këshilli i ZKF-së do të punojë në partneritet me Këshillat e tjerë për të përkthyer konceptin e menaxhimit të riskut të ndërmarrjes, duke kaluar abstraktin në zgjidhje praktike që mbështesin performancën.

Grantet

Këshilli i ZKF-së është i përkushtuar në koordinimin e ndihmës financiare për të ofruar, mbikëqyrur dhe raportuar në mënyrë efektive grantet dhe marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe ndarjen e praktikave më të mira me departamentet ekzekutive e agjencitë dhe idetë inovative për transformimin e ofrimit të ndihmës për grante.

Kapitali njerëzor

Me një numër të paprecedentë të punonjësve federalë të kualifikuar për pension, Këshilli i ZKF është i përkushtuar të mbajë një fuqi punëtore të fuqishme dhe profesionale në menaxhimin financiar federal. Duke punuar në të gjitha agjencitë, Këshilli i ZKF-së do të koordinojë gjeneratën e ardhshme të programeve për të rekrutuar, trajnuar dhe mbajtur më të mirën e fuqisë punëtore të menaxhimit financiar federal.

Pagesat e gabuara

Zvogëlimi i normës së pagesave të papërshtatshme në nivel qeveritar është një prioritet i Këshillit të ZKF. Një pagesë e parregullt është çdo pagesë që nuk duhet të jetë bërë, nuk ka

dokumentacion të mjaftueshëm, ose që është bërë në një sasi të gabuar, potencialisht që rezulton me humbje monetare për qeverinë. Si një kujdestar efektiv i dollarëve të taksapaguesve, anëtarët e Këshillit të ZKF-së, punojnë në mënyrë aktive për të zvogëluar pagesat e parregullta dhe raste të tjera të mashtrimit dhe abuzimit.

Raportet e Menaxhimit Financiar Federal

Në përputhje me Ligjin e ZKF-së të vitit 1990, informacioni në vijim paraqet raportin e statusit të menaxhimit financiar dhe një plan menaxhimi financiar 5-vjeçar të qeverisë. Raporti i referohet Sektorit të Përparimit të Menaxhimit Financiar dhe Prioriteteve në kuadër të Raportit Financiar të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Përveç kësaj, raporti thekson rezultatet më të fundit të raportimit financiar të vitit fiskal.

IV. Rekomandimet dhe Konkluzionet

Për të përmirësuar kuadrin e kontrollit të brendshëm të Shqipërisë dhe për të rritur llogaridhënien dhe transparencën e përdorimit të fondeve publike me më shumë ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet, si dhe për të rritur kështu respektin dhe besimin e publikut në institucionet publike Shqiptare, duhet të

merren në konsideratë sugjerimet e mëposhtme:

I. Duke përdorur standardet e kontrollit të brendshëm të pranuara përgjithësisht:

KLSH-ja duhet të vazhdojë të ndikojë në degën legjislative dhe palët e tjera të interesit, për të vendosur udhëzime të reja për kontrollin e brendshëm në sektorin publik, bazuar në Standardet Ndërkombëtare (Modeli COSO) dhe gjithashtu në Librin Jeshil.

Auditimet e KLSH duhet të përqendrohen më shumë në përmirësimin e boshllëqeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik Shqiptar, duke ndihmuar kështu subjektet publike për t'u përshtatur me mjediset që ndryshojnë, evoluimin e kërkesave, ndryshimin e risqeve dhe vendosjen e prioriteteve të reja.

II. Krijimi i një programi me risk të lartë:

KLSH duhet të marrë në konsideratë krijimin e një programi të Riskut të Lartë të ngjashëm me modelin GAO. Në krijimin e këtij programi të ri, KLSH duhet të bazohet në fushat kryesore të riskut të auditimeve të veta, fusha kryesore e diskutimit të Parlamentit dhe / ose perceptimi i përgjithshëm i publikut për programet që kanë nevojë për më shumë vëmendje të menjëhershme.

Në krijimin e programit të vet të riskut të lartë, KLSH duhet të përcaktojë kritere të qartë dhe objektivisht cilësore dhe sasiore, për përcaktimin e risqeve të mëdha të Qeverisë. Këto kritere duhet të synojnë të ndihmojnë KLSH-në, Parlamentin Shqiptar dhe degën e ekzekutivit, t'i kushtojnë vëmendje e duhur identifikimit dhe zgjidhjes së sfidave të performancës e llogaridhënies dhe problemeve me risk të lartë.

III. Vendosja e bashkësive të praktikës:

KLSH-ja duhet të organizojë në vazhdimësi konferenca të përbashkëta me pjesëmarrjen e zyrtarëve autorizues dhe zbatues, dhe njësive të auditimit të të gjitha subjekteve publike, të përqendruar kryesisht në sfidat e kontrollit të brendshëm dhe mënyrat për përmirësim.

KLSH-ja bazuar në përvojën e saj, duhet të ofrojë trajnime për zyrtarët e tjerë publikë, kryesisht të zyrtarëve autorizues dhe zbatues, njësive të auditimit dhe/ose drejtuesve të enteve publike, për përfitimet e institucioneve në përmirësimin e kontrolleve të brendshme.

Përfundime

Duke vuajtur korrupsionin e institucionalizuar për dekada, Sektori Publik Shqiptar sot pranon se mashtrimi dhe keqmenaxhimi i financave publike vetë minon besimin e njerëzve në zhvillimin ekonomik, investimet e huaja dhe integrimin europian. Sistemet e kontrollit të brendshëm janë jetësore për identifikimin dhe adresimin e

risqeve të rëndësishme për arritjen e rezultateve të një njësie ekonomike.

Duke vlerësuar sistemet e kontrollit të brendshëm nëpër operacione dhe jo thjesht nga një perspektivë e raportimit financiar, do të ndihmojë zyrtarët qeveritarë që në mënyrë efektive t'i përgjigjen riskut të mashtrimit dhe korrupsionit.

Zbatimi i modelit COSO për kontrollin e brendshëm, do të përmirësonte ndjeshëm statusin aktual të kontrollit të brendshëm, duke bërë kështu përmirësimin e performancës së sektorit publik dhe përmirësimin e perceptimit të përgjithshëm publik ndaj institucioneve shqiptare.

Marrja në konsideratë e mendimeve të subjekteve të tjera publike në sfidat e kontrollit të brendshëm, do të luante një rol kyç në përmirësimin e kuadrit të kontrollit të brendshëm në sektorin publik shqiptar.

Krijimi i programeve me risk të lartë në auditimet e KLSH do të ndihmonte indirekt Parlamentin dhe Qeverinë Shqiptare për të përcaktuar sfidat e performancës dhe llogaridhënies, si dhe për t'i shërbyer më mirë qytetarëve Shqiptar dhe interesave të tyre.

V. Bibliografia

-Libri Jeshil i GAO`s;

-GAO: Përcaktimi i Sfidave të Performancës dhe Llogaridhënies dhe Riskut të Lartë;

-Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;

-Strategjia e Menaxhimit Financiar Publik Shqiptar 2014-2020;

-Akti i U.S. i Zyrtarëve Kryesorë Financiar i 1990;

-Këshilli i U.S.i Zyrtarëve Kryesorë Financiarë (https://cfo.gov/);

-ISSAI 9100 “Udhëzimet për Standardet e Kontrollit të Brendshëm në Sektorin Publik”;

Nga: Alfonc Gabili, Auditues i Lartë, KLSH

NJË SAI NË KONGRES: POZICIONI I GAO-s DHE AUDITIMET DREJT KONGRESIT TË SHBA

Intervistë me Kate Siggerud, Zyrtar i Lartë Operativ i GAO, SHBA

Për shumë institucione të auditimit suprem që operojnë në një demokraci parlamentare, kushti thelbësor për pavarësinë e tyre është të operojnë veçmas legjislativit dhe ekzekutivit.

Nga: Gaston Moonen, Drejtoria e Presidencës, ECA

Botuar në Revistën e ECA, nr.6-7, qershor-korrik 2018

Për shumë institucione të auditimit suprem që operojnë në një demokraci parlamentare, kushti thelbësor për pavarësinë e tyre është të operojnë veçmas legjislativit dhe ekzekutivit. Si funksionon kjo në GAO, kur ky institucion mbart atributet e "rojtarit" të Kongresit? Çfarë roli luan GAO në lidhje me aktivitetet e vetë Kongresit dhe si e përcakton ky i fundit buxhetin e vetë? Gjatë intervistës me Kate Siggerud, zyrtarja më e lartë operative në GAO, na jepet një informacion konciz dhe i përpiktë në lidhje me këto çështje.

Mbështetje për Kongresin e SHBA

Ideja fillestare për të intervistuar Kate Siggerud lidhet me pozicionin specifik që Zyra Kombëtare e Auditimit (GAO) ka në organizimin institucional, për të siguruar kontrollet dhe balancat në SHBA. GAO u miratua për herë të parë në 1921 dhe ashtu si tani, emërohej nga legjislativi, i cili përfaqësohet nga Kongresi dhe jo nga ekzekutivi që përfaqësohet nga Presidenti. Kate Siggerud thekson se GAO i vë në dispozicion raportet dhe mbështet Kongresin e SHBA. "Ne jemi një nga degët e legjislativit, krijuar pikërisht për të dhënë një shumëllojshmëri këshillash dhe mekanizmash mbështetës për Kongresin. GAO funksiononte në fillim si një organizatë që vetëm kontrollonte dhe auditonte faturat. Nga viti 1960 e më pas, ne u shndërruam në një institucion që zhvillon auditime të mirëfillta financiare dhe performance."

Kate Siggerud shpjegoi qartësisht misionin e GAO-s: "Misioni ynë primar është mbështetja e Kongresit në aktivitetin e tij mbikëqyrës dhe legjislativ. Kongresi ka si mision mbikëqyrjen e ekzekutivit, mënyrën se si ky i fundit kryhen funksionet e veta

dhe se si i shpenzon fondet që i ka vënë në dispozicion Kongresi. Kështu, misioni ynë kryesor është të asistojmë në këtë aktivitet mbikëqyrës nëpërmjet auditimit të performancës. Pjesa më e madhe e raporteve tona i adresohen Kongresit, ku prezantohen gjetjet tona mbi efektivitetin dhe eficencën e programeve federale, si dhe mbi shpenzimin e të ardhurave." Për sa i përket elementit të dytë të aktivitetit të legjislativit, ajo shprehet: "Raportet tona shërbejnë për të ndihmuar aktivitetet legjislative të Kongresit. Kështu këtij të fundit mund t'i duhet të miratojë një buxhet apo të autorizojë një program dhe auditimet tona financiare dhe të performancës mund ta informojnë në lidhje me to."

Kate Siggerud është personi i duhur për të diskutuar, kur bëhet fjalë për perspektivat e marrëdhënieve midis GAO-s dhe Kongresit. Përpara se të mbulonte pozicionin aktual, ajo ishte drejtoreshë në Zyrën e Marrëdhënieve me Kongresin në GAO. Ajo ka mbi 30 vite eksperiencë në GAO dhe tashmë mbulon pozicionin e Zyrtarit të Lartë Operativ. Kur pyetet në lidhje me këtë, ajo shpjegon se: "GAO ka një komitet ekzekutiv, i cili përbëhet nga katër anëtarë. Njëri është padyshim Audituesi i Përgjithshëm, drejtuesi i mandatuar i GAO. Më tej janë edhe tre anëtarë të tjerë: Zyrtari i Lartë Operativ, pozicioni që unë mbuloj. Unë fokusohem në punën audituese, planifikimin dhe rishikimin e saj dhe duhet të sigurohem që ajo po bëhet në mënyrën e duhur. Ne kemi edhe Zyrtarin e Lartë të Administratës/Financave, i cili i mban të dy titujt dhe merret me çështjet administrative dhe buxhetore të nevojshme për GAO-n. Gjithashtu, në Komitetin Ekzekutiv kemi edhe Këshilltarin e Përgjithshëm, i cili mbikëqyr juristët e institucionit dhe njëkohësisht këshillon pjesën tjetër të institucionit."

Puna që drejton dhe menaxhon Kate Siggerud është me të vërtetë e madhe, kur bëhet fjalë për produktin e GAO. "Ne zakonisht nxjerrim rreth 700 deri në 800 raporte në vit, kështu që është shumë për tu menaxhuar. Ne jemi organizuar në formë grupesh pune, të drejtuara nga një përgjegjës."

Garancitë për pavarësinë

Një element thelbësor për garantimin e pavarësisë së GAO-s është pozicioni i Audituesit të Përgjithshëm. "Presidenti e emëron atë me një mandat 15-vjeçar. Lista e kandidatëve paraqitet nga Kongresi, pasi është ndërtuar nga drejtuesit e Dhomës së Përfaqësuesve dhe të Senatit. Ndryshe nga mandatet e tjera në qeverinë federale, zgjedhja bëhet nga lista e miratuar nga drejtuesit e Kongresit." Kate Siggerud thekson një tjetër element të rëndësishëm në lidhje me pavarësinë e Audituesit të Përgjithshëm. "Ai është një zyrtar i emëruar për 15 vite, i cili nuk mund të shkarkohet nga Presidenti, por vetëm nëpërmjet një procedure

"impeachment" të Kongresit. Kjo e bën atë shumë të rëndësishëm!" Ajo thekson se pavarësia e GAO-s është rishikuar disa herë nëpërmjet "peer review" dhe rezulton se përputhet me standardet e auditimit. "Besueshmëria e punës sonë bazohet në aftësinë tonë për të nxjerrë një produkt objektiv, të pavarur dhe të bazuar në fakte, duke u perceptuar si një burim informacioni dhe institucion i pavarur."

Një tjetër element i rëndësishëm në lidhje me pavarësinë janë protokollet që GAO ka zhvilluar me Kongresin."Ne kemi vendosur një grup protokollesh. Ne i japim përparësi raporteve të përcaktuara në ligj dhe kërkesave të drejtuesve të Dhomës dhe Senatit dhe atyre të komisioneve të Kongresit. GAO pranon kërkesat nga të dyja partitë politike (qoftë mazhoranca apo opozita) për sa kohë që Anëtari i Kongresit që kërkon auditimin është drejtues i një Komiteti juridiksioni në temën që ai ose ajo dëshiron të shqyrtojë. Ne rezervojmë të drejtën të mos pranojmë kërkesa nga Kongresi, nëse besojmë se nuk mund të ndërmarrim një rishikim të pavarur dhe objektiv të fakteve ose nëse puna që ata na kërkojnë të bëjmë është jashtë juridiksionit dhe qasjes tonë në informacion. Këto protokolle kanë qenë në fuqi që nga viti 2001 dhe ato punojnë shumë mirë për të siguruar që GAO mban reputacionin e saj si një organizatë e pavarur dhe jopartiake. Mandatin na e jep legjislativi, por ne jemi të pavarur për të kryer punën në mënyrën më të përshtatshme.

Formalisht, shumica e punës së GAO-s rrjedh nga kërkesat e Kongresit. Kate Siggerud shpjegon se 'fotografia ka më shumë nuanca': "95% e punës ose kërkohet nga Kongresi ose vjen si rezultat i një ligji të miratuar. Ne rezervojmë rreth 5% të burimeve tona për të bërë auditime nën autoritetin e Audituesit të Përgjithshëm. Ne mund të fillojmë një auditim kur GAO mendon se kjo do të ishte një fushë produktive. Ne gjithashtu prodhojmë një plan strategjik çdo katër vjet, bazuar në konsultimet me Kongresin dhe ndër të tjera skanimin e mjedisit. Ne vendosim temat kyçe që mendojmë se GAO duhet të përqendrohet në katër-pesë vitet e ardhshme dhe të punojë ngushtë me komitetet përkatëse në Kongres, për të rënë dakord mbi një program të përgjithshëm pune që do të kryhet. Në shumicën e rasteve kërkesat që marrim për auditime pasqyrojnë një përpjekje të përbashkët planifikimi midis Kongresit dhe GAO-s. Gjithashtu, për këtë qëllim drejtuesit tanë janë në kontakt të vazhdueshëm me Kongresin."

Sa i përket asaj që përbën një kërkesë nga Kongresi, ajo i referohet protokolleve më lart.

"Ato paraqesin në mënyrë specifike një skemë prioritizimi për të trajtuar kërkesat. Prioriteti ynë kryesor është kur një ligj është miratuar dhe kërkon një raport ose një studim nga GAO. Ato janë

dypartiake, sipas natyrës së tyre. Prioriteti i dytë kërkohet nga kryetari i një komiteti ose nga anëtari më i lartë i pakicës në atë komision - atë që ne e quajmë "anëtar i rangut". Secili prej tyre mund të kërkojë nga GAO një studim për shembull për Shërbimin Postar, nëse komiteti i tyre ka juridiksion në atë pjesë të qeverisë federale. Kate Siggerud shpjegon se GAO do të trajtojë kërkesat e pakicës njësoj me kërkesat e shumicës. "Shumë kërkesa vijnë nga të dyja palët së bashku. Edhe nëse Kryetari i Komisionit (partia e shumicës) nuk e ka kërkuar auditimin, ne do t'i përgjigjemi kërkesave, megjithatë vetëm për sa kohë vjen nga një udhëheqës partie të pakicës në atë komision dhe është brenda juridiksionit tonë.

Palë të shumta që punojnë për llogaridhënien

Kur diskutojmë nëse ekzistojnë disavantazhe të qarta për faktin e të qenit aq afër Kongresit, Kate Siggerud thekson se brenda pjesëve të ndryshme të qeverisë federale të SHBA ka shumë elementë të ndryshëm të llogaridhënies. "Ne e shohim përgjegjësinë tonë si të qenit efektivë në nxitjen e përmirësimit të programeve të ekzekutivit, ku kryejmë shumicën e auditimeve tona. Dhe Kongresi mbështetet tek ne për qëllimin e shqyrtimit të legjislacionit, i cili sigurisht është i mundur aty ku mund të arrihet ndryshimi në programet e ekzekutivit. "Ajo tregon se nga rekomandimet e GAO-s, në përgjithësi 75-80% e tyre janë zbatuar brenda katër viteve të dhënies së tyre. "Ne shohim se kemi një efekt tek ekzekutivi edhe pse jemi të vendosur aty ku jemi. Duhet të theksohet se shumica e agjencive të ekzekutivit kanë edhe inspektorë të përgjithshëm që janë përqendruar në kryerjen e auditimeve financiare dhe të performancës dhe bërjen e rekomandimeve. Dhe, ashtu si raportet e GAO, ato raporte përgjithësisht bëhen publike."

Vendimi për buxhetin e Kongresit

Duke folur për vendimmarrjen mbi financat e Kongresit, bëhet e qartë se nuk ka përfshirje të ekzekutivit apo gjyqësorit. Kate Siggerud shpjegon se në ndarjen e fondeve midis agjencive dhe programeve federale, Kongresi ka komisione që bëjnë alokime vjetore të financimit. "Agjencitë e ekzekutivit zhvillojnë propozimet e tyre dhe i dërgojnë ato përmes Zyrës së Buxhetit, e cila i rishikon dhe i përpilon për shqyrtim nga Kongresi. Buxheti i lëvruar për Kongresin dhe për agjencitë legjislative si ne, është zhvilluar nga vetë ai pa kontributin e Presidentit. Ne si GAO propozojmë një buxhet çdo vit, dhe Audituesi i Përgjithshëm dëshmon para Komitetit përkatës, por në fund, komisionet e Dhomës dhe Senatit vendosin për shumën."

Në lidhje me procedurat e 'shkarkimit', Kate Siggerud shpjegon se kjo ndoshta është më e lidhur me kontekstin e BE. "Shkarkimi nuk është fjalë që ne e përdorim këtu, por unë do të përpiqem

të flas për këtë. Për ekzekutivin, të gjitha agjencitë federale duhet të propozojnë një buxhet çdo vit që gjithashtu shpjegon se si janë përdorur fondet në vitet e mëparshme. Pra, vetë buxheti është një dokument që regjistron fondet e përdorura në vitin paraprak dhe fondet e planifikuara për vitin pasardhës. Secila organizatë pritet të përpilojë një deklaratë financiare. Kjo e fundit është audituar nga inspektori i përgjithshëm i saj ose nga një firmë kontabiliteti e kontraktuar nga ai. Ajo tregon se pasqyrat financiare janë përpiluar në Raportin Vjetor Financiar të Shteteve të Bashkuara nga Departamenti i Thesarit dhe Zyra e Menaxhimit dhe Buxhetit. GAO auditon pasqyrat financiare dhe përgatit konkluzionet e veta, të cilat përfshihen në Raportin Vjetor Financiar. Ajo vazhdon: "Gjatë viteve, inspektorët e përgjithshëm dhe GAO kanë parë përmirësime në këto deklarata, edhe pse Departamenti i Mbrojtjes nuk ka marrë ende një opinion të qartë. Ne kemi ngritur edhe çështje për transferimin ndërqeveritar të fondeve dhe ndër të tjera për mënyrën se si këto janë shpërndarë."

Në kundërshtim me kuadrin e BE-së, ku Parlamenti Evropian është i detyruar të shkarkojë fondet, nuk ka një veprim të ngjashëm me të nga Kongresi. Kate Siggerud: "Ky raport vjetor financiar i transmetohet Zëvendëspresidentit dhe Kongresit dhe vihet në dispozicion në faqet e internetit të institucioneve. Kur lëshohet kjo deklaratë, Kongresit nuk i duhet të ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me të."

Auditimi i Kongresit

Lidhur me pyetjen se kush kontrollon implementimin e buxhetit dhe aktivitetet e Kongresit, Kate Siggerud së pari i referohet agjencive mbështetëse të Kongresit. Ajo jep si shembuj Bibliotekën e Kongresit, e cila menaxhon bibliotekën më të madhe në SHBA. Biblioteka gjithashtu përfshin Shërbimin Kërkimor të Kongresit (CRS) që ofron ndihmë kërkimore për anëtarët e Kongresit dhe është disi e krahasueshme me Shërbimin Evropian të Kërkimit (të Parlamentit Evropian); ndërsa Zyra e Buxhetit të Kongresit, e krijuar 40 vjet më parë, bën vlerësime të kostos së legjislacionit për Kongresin, kur ky i fundit shqyrton faturat e reja që mund të kenë implikime të rëndësishme financiare. "CRS kryesisht bën hulumtime duke përdorur burime dytësore dhe ofron ekspertizë në leximin e ligjeve apo statuteve. Puna e GAO-s për auditimin financiar dhe të performancës është më e fokusuar në auditimin dhe vlerësimin e programit, duke përfshirë gjenerimin e të dhënave, analizimin e tyre dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e performancës së qeverisë. Puna e CRS zakonisht përqendrohet në përshkrimet e programeve dhe çështjeve."

Ajo tregon se shumica e këtyre agjencive mbështetëse kanë Inspektorët e tyre të Përgjithshëm, me raporte

publike: “Ata kanë inspektorët e tyre të përgjithshëm. Edhe vetë Dhoma e Përfaqësuesve ka një inspektor të përgjithshëm, por megjithatë Senati nuk e ka një të tillë. Ekziston për shembull edhe Zyra e Pajtueshmërisë, e cila është një zyrë që i raporton Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit, duke siguruar që politikat e caktuara lidhur me punësimin dhe infrastrukturën të kryhen në mënyrën e duhur ".

Ndërsa GAO-s ndonjëherë i kërkohet të shqyrtojë operacionet e agjencive të tjera të legjislativit, Kate Siggerud shpjegon se atij zakonisht nuk i kërkohet të auditojë operacionet e brendshme të Dhomës ose Senatit. “Ne kemi një procedurë, e cila është përshkruar në protokollin që përmenda më herët. Në përgjithësi, për një kërkesë që përfshin punën për programet ose aktivitetet që kanë të bëjnë me operacionet e brendshme të Kongresit, GAO do të kërkojë mbështetje bipartizane nga drejtuesit e lartë të Dhomës ose Senatit. Lidhur me auditimet e agjencive të tjera të legjislativit, ky është një rishikim që GAO bën në Sistemet TI të Bibliotekës së Kongresit.

Në përgjithësi, praktika është se GAO do të kontrollojë në mënyrë të tërthortë aktivitetet e Kongresit duke parë agjencitë e varura nga to, më shumë në nivel politikash dhe programesh, pasi shumica e tyre kanë inspektorin e përgjithshëm përkatës. Kate Siggerud shton se, përveç inspektorit të përgjithshëm në Dhomën e Përfaqësuesve, Dhoma dhe Senati kanë edhe komitete etike. “Ata mund të marrin referime nga palët e jashtme, nga anëtarët e Kongresit lidhur me çfarëdo shkelje etike në lidhje me shpenzimet e fushatës apo sjellje të tjera të papërshtatshme. Kjo për të kompletuar pamjen e mbikëqyrjes të Kongresit.”

Përktheu: Krisi Anastas, Auditues Departamenti i Auditimit të Performancës

Nga: Kate Siggerud, Zyrtar i Lartë Operativ i GAO, SHBA

LLOGARIDHËNIA E PARLAMENTEVE KONTRIBUON NË BALANCËN E PUSHTETEVE

Intervistë me Daniele Lamarque, Anëtare e ECA

Financimi dhe auditimi i parlamenteve është një çështje me interes për Daniele Lamarque. Kjo është arsyeja se pse ajo organizoi simpoziumin "Financimi publik i parlamenteve në Evropë

Nga: Daniele Lamarque, Anëtare e ECA

Botuar në Revistën e ECA, nr.6-7, qershor-korrik 2018

Shkëmbime mes akademisë dhe audituesve

Financimi dhe auditimi i parlamenteve është një çështje me interes për Daniele Lamarque. Kjo është arsyeja se pse ajo organizoi simpoziumin "Financimi publik i parlamenteve në Evropë: autonomia financiare në diskutim" që u mbajt në ECA në mars të këtij viti. Ky ishte simpoziumi i dytë në një seri simpoziumesh ndërkombëtare mbi financat publike. Kam bashkëpunuar me Universitetin e Lille që prej 2014-ës, ku kam bërë një prezantim të çështjes në simpoziumin e parë për koordinimin e politikës fiskale në Evropë. U fokusova tek roli i ECA-s në këtë fushë. Universiteti i Lille ka një seksion mjaft aktiv për financat publike dhe ligje krahasuese. Pra ideja ishte që të mbahej simpoziumi dhe të publikoheshin rezultatet në revista. Ajo theksoi se pikat e simpoziumit të dytë do të publikohen tek Revista "Administrimi i financave publike" dhe besoj se do të publikohet në anglisht dhe frëngjisht.

Çështja e shqyrtimit të financave të parlamenteve është një çështje me rëndësi e cila ndodhet në ADN e institucionit. Për çdo vend ne kemi dy prezantime: një nga akademia dhe një nga praktika. Ajo beson se kjo çështje është mjaft me rëndësi edhe për Parlamentin Evropian. Llogaridhënia e Parlamentit Evropian varet edhe nga praktika në vendet anëtare. Për shembull, në Britani gjërat ndryshuan pas publikimit të skandalit me Information Act. Kur e krahasoj tani nivelin e transparencës atje me Francën, llogaridhënia e Asamblesë Kombëtare Franceze nuk është aq e fortë sa në Britani apo në BE.

Informacion mbi ushtrimin e detyrave kryesore

Daniele Lamarque thekson dy funksione kryesore në simpozium: Llogaridhënia e parlamentit ndaj publikut, se si i kryen detyrat dhe realizon aktivitetet dhe se si i përdor parlamenti burimet ka në dispozicion? Këtu nuk e kam fjalën për rrogat dhe dietat por më shumë për mjetet që ka në dispozicion për kryerjen e veprimtarisë.

Ajo thotë se tani në Francë debatet fokusohen tek mënyra se si parlamenti vlerëson implementimin e politikave. Në Francë shohim se shpenzohet shumë pak kohë për alokimin e buxhetit. Ai debat zakonisht zgjat një ditë. Pjesa tjetër e kohës shpenzohet për të folur se si duhet përdorur buxheti. Ajo thekson se roli i parlamentit është të vendosë mbi ligjet me apo pa buxhet. Por ka edhe për detyrë të vlerësojë nivelin e implementimt të buxhetit që është patjetër një çështje kryesore për ne audituesit, si në terma të procedurës ashtu edhe të aplikimit.

Të ndjekësh paranë edhe në parlament.

Për Daniele Lamarque, roli i ECA-s në auditimin e përdorimit të fondeve të parlamentit Evropian është një praktikë e re dhe interesante. Gjykata Franceze e Auditimit nuk ka kompetencë në marrëdhënie me fondet e përdorura nga Parlamenti Evropian. Por nëse është para e BE-së atëherë mund ta auditojë ECA. Ne e bëjmë këtë ashtu sikurse raportojmë për parregullsi në menaxhimin e fondeve prej disa grupimeve politike sikurse kemi bërë në kapitullin 10, të raportit vjetor të vitit 2016. Daniele Lamarque jep një tjetër shembull që lidhet me studimin që ECA bëri mbi kostot e parlamentit Evropian me seli në Strasburg, Bruksel dhe Luksemburg. “Ne pamë të gjitha kostot e udhëtimeve duke parë përdorimin e parave. Kjo është interesante për shkak se Parlamenti Evropian mund të na kërkojë në llogari për përdorimin e fondeve tona gjithashtu. Sigurisht që ne nuk mund të angazhohemi në aktivitete politike. Por besoj se ky është një shembull i mirë i demokracisë dhe transparencës. “Në vitin 2016 Parlamenti Evropian kërkoi për më shumë auditime dhe jo më pak. “MEP e dinë shumë mirë se disa parti i shkelin rregullat. Dhe kjo mund të rrezikojë reputacionin e institucionit.

Daniele Lamarque e konsideron pozitive që ka hapa nga Gjykata Franceze e Audituesve që të auditojë Parlamentin Francez. “Në 2013-ën nuk kishte bazë ligjore për këtë, më pas u bë një marrëveshje. Këtu fokusi është tek përputhshmëria. “Ajo më pas i referohet një prej folësve në simpozium, Rene Dosiere, një deputet i dikurshëm. “Ai e nisi para 10 vitesh duke kërkuar më shumë transparencë. Aty ai dha një shpjegim për privilegjet e pensionit dhe

llastime të tjera dhe kërkon për më shumë transparencë.

Balanca në kontroll dhe pushtete

Në të njëjtën kohë Daniele Lamarque bën thirrje për balancë dhe arsye. "Në Britani pati një skandal që çoi në dorëheqjen e Kryetarit të Dhomës së Komunave: diçka që nuk kishte ndodhur që prej shekullit të 17-të. Por sistemi i ri i kontrollit mund të jetë duke shkuar në ekstremin tjetër, dhe kjo konsiderohet burokratike. "Si auditues ne e dimë se duhen ngritur sisteme të kontrollit të brendshëm. Nga ana tjetër, edhe shumë kontroll nuk është i mirë; njerëzit nuk e përballojnë dot. Duhet gjetur balanca mes transparencës dhe kontrollit të brendshëm. Pse na duhet t'i auditojmë ata që janë zgjedhur prej popullit dhe kush duhet mbajtur përgjegjës për paratë e alokuara atyre? Kjo është çështja që u analizua edhe në simpozium. "Ajo mendon se llogaridhënia është e rëndësishme por puna audituese nuk duhet të pengojë deputetët në kryerjen e detyrës së tyre si përfaqësues të popullit. Në fund, demokracia është më e rëndësishme se llogaridhënia. Llogaridhënia është pjesë e një sistemi demokratik por nuk duhet të bëhet barrierë për funksionimin. Duhet gjetur balanca. Mendoj se ne këtu në ECA e bëjmë mirë detyrën pasi kemi marrëdhënie shumë të mirë me Parlamentin Evropian dhe vetë parlamentet mendojnë se duhet të ketë më shumë audit dhe transparencë. Prandaj duhet të bëjmë më shumë punë në këtë fushë deri sa të arrijmë një pikë ku të themi. "Dakord, ky është roli politik dhe ne nuk duhet të përfshihemi".

Më pas Daniele Lamarque flet për balancën e pushteteve, sikurse e ka përshkruar Montesquieu. "Nga perspektiva e auditit me degën gjyqësore të pavarur nga ajo legjislative dhe ekzekutive, do të hasësh të njëjtat limite në auditin e jashtëm. Në Francë nuk mund të ndërhysh në punët e gjyqësorit. Pra ka balancë pushtetesh dhe audituesi duhet ta kuptojë këtë pamundësi për të ndërhyrë tek pushtetet."

Kur flasim se si kjo aplikohet tek vetë ECA, anëtarët sjellin shembullin e auditimeve të kërkuara nga parlamenti. Kjo është një çështje sensitive për Gjykatën Franceze të Audituesve e cila është shumë e varur prej pavarësisë dhe marrëdhënieve me ekzekutivin dhe legjislativin. Ideja është që të ruhet baras largësia. Mund të ketë edhe kërkesa nga ekzekutivi por janë të rralla." Ajo e vlerëson si më të rëndësishëm marrëdhënien me parlamentin. "Ne i japim llogari parlamentit dhe parlamenti i jep llogari qytetarëve. Ne jemi mjeti që e mundëson këtë". Kush e ekzaminon atëherë parlamentin? Ajo thotë "Deputetët zakonisht thonë se janë vazhdimisht të kontrolluar prej elektoratit të tyre. Mbaj mend se kur

ngritëm degët rajonale të auditimit në Francë në 1983, për kontrollimin e bashkive, ata përdorën të njëjtin argument: ju nuk keni pse raportoni mbi aktivitetin tonë. Dhe se si i shpenzojmë paratë. Ne u japim llogari qytetarëve në çdo palë zgjedhje"

Vlerësimi i punës së ekzekutivit

Me një buzëqeshje, Daniele Lamarque rrëfen për kohën kur ajo ishte përgjegjëse për zyrën rajonale të auditimit në Normandi dhe Marsejë. " I njoh këto situata mirë dhe ndonjëherë janë edhe më të vështira se marrëdhëniet me ministritë në nivel kombëtar. Ndonjëherë kryebashkiakët mund të jenë shumë të fuqishëm. Më kujtohet kur duhet të raportoja mbi një partneritet publik-privat për stadiumin e Marsejës. Edhe pse ky partneritet ishte shumë i kushtueshëm në afatgjatë, u shit prej kryebashkiakut si një mundësi e madhe suksesi. Bazuar tek raporti që publikuam, media bëri disa pyetje . Mendoj se ai kryebashkiak është ende i inatosur me mua. "Ajo shpjegon se çështjet lokale mund të jenë edhe më të prekshme se ato në nivel lokal duke qenë se ke të bësh me teatrot, shkollat, ujësjellësin. "Kjo të bën të punosh në terren. Por shumicën e kohës është e parehatshme duke qenë se ke të bësh me politikanë të nxehur të cilët të shohin si kërcënim".

Anëtarja e ECA e lidh këtë me çështjen për të cilën foli më parë: vlerësimi i implementimit të politikave nga parlamenti francez. "Aktualisht ka reflektim në Francë se si të vlerësohet aktiviteti i ekzekutivit. Një studim i Parlamentit Evropian i para disa kohëve zbuloi se në krahasim me Kongresin Amerikan, me Parlamentin Evropian, apo edhe me atë gjerman apo britanik, Parlamenti Francez nuk është aq i furnizuar me jete për të bërë një vlerësim të politikave publike të qeverisë. "Ka një lëvizje Brenda parlamentit e cila kërkon më shumë vlerësim. "Ata duan ta vlerësojnë buxhetimin me ekspertë të pavarur dhe jo me ata të vetë qeverisë".

Kur diskutojmë rolin e Gjykatës Franceze të Audituesve në ofrimin e kësaj ekspertize ky institucion i ka duart e lidhura. "Gjykata Franceze e Audituesve duhet t'i bindet disa ligjeve për dhënien e informacionit tek parlamenti dhe gati gjysma e kapaciteteve të saj i dedikohet kësaj. Raportet mbi çështjet sociale dhe buxhetimin janë të vazhdueshme. Më tej, 15% e auditimeve shpenzohet me kërkesat që vijnë nga parlamenti, dhe mos harroni ne kemi raporte 300 faqe me kontribut për informimin e qytetarëve. Krahasojeni këtë me 60 faqe që është raporti special më i gjatë në ECA."

Të gjesh rrugën e mesme

Daniele Lamarque e mbyll këtë intervistë duke thënë se financimi i aktiviteteve të parlamentit shkon tek auditimi përtej rrogave dhe dietave.

Çështja kryesore nuk është se sa fitojnë deputetët. Kjo gjë vlen vetëm për skandale në media. Ata duhet medoemos të jenë transparentë. Por çështja kryesore është se si punon, se si i zhvillojnë aktivitetet dhe se si kontribuojnë në përmirësimin e qeverisjes drejt eficiencës dhe efektivitetit. Ajo mendon se është me rëndësi të bëhet dallimi mes mjeteve që deputetët kanë në dispozicion për punën e tyre politike dhe asistencës së drejtpërdrejtë për rritjen e nivelit të tyre të njohurive dhe informacionit. Diferenca dhe balanca mes këtyre dy aspekteve është rruga e mesme për audituesin për të parë se sa larg mund të shkohet për të mundësuar transparencë për këto çështje.

Përktheu: Brenton Kotorri, Auditues

Departamenti i Auditmit të Performancës

Nga: Daniele Lamarque, Anëtare e ECA

NDRYSHIMET KANË NEVOJË PËR NJË PERSON PRAPA TYRE

Në zhvillimin e një sistemi të administrimit publik, i cili është i bazuar në prova dhe i orientuar në rezultate në Lituani, qëllimi ishte përdorimi i të dhënave të performancës kryesisht për t'a përmirësuar performancën. Duke përdorur këto të dhëna ekskluzivisht për të raportuar ka disa efekte negative, si kriteri i tepërt i përformancës, spekulime në vlerat e kritereve dhe synimin për të implementuar setin e kërkesave, më shumë se sa për të përmirësuar efektivisht rezultatet.

Nga: Arūnas Dulkys, PhD, Auditues i Përgjithshëm i Republikës së Lituanisë

Botuar në Revistën e INTOSAI-t, verë 2018

Burimet e shtetit janë të limituara, kështu që të dëshirosh më shumë se sa është e nevojshme mund të jetë e rrezikshme. Nga vetë natyra jonë, jemi të prirur të shikojmë vetëm anët pozitive të pritshmërive tona. Rrallë herë, mund të mendojmë që ëndrrat tona të realizuara vijnë me një çmim të paguar nga dikush tjetër. Çfarë ndodh nëse ne ndërmarrim veprime pa menduar për pasojat e mundshme? Pasojat e një dëshire të gabuar nxisin, me emergjencë kryerjen e një veprimi tjetër të gabuar. Nëse ky proces nuk parandalohet, pasoja të ndryshme do të vijnë në mëyrë eksponenciale.

Lituania nuk përbën përjashtim. Me resurse të limituara, paraqitet një detyrë e vështirë – shfrytëzimi i tyre në një mënyrë të tillë që të nxisë rritjen ekonomike. Proceset që përbëjnë një përfundim në vetvete nuk do të tolerohen. Auditimet e kryera nga Institucioni Suprem i Auditimit të Lituanisë paraqesin një imazh ku objektivat e programeve, synimet, masat dhe kriteret e financuara nga buxheti i shtetit, shpesh janë të zhvilluara artificialisht. Si pasojë, barra administrative rritet, dhe nuk krijohet vlera e shtuar.

Në zhvillimin e një sistemi të administrimit publik, i cili është i bazuar në prova dhe i orientuar në rezultate në Lituani, qëllimi ishte përdorimi i të dhënave të performancës kryesisht për t'a përmirësuar performancën. Duke përdorur këto të dhëna ekskluzivisht për

të raportuar ka disa efekte negative, si kriteri i tepërt i përformancës, spekulime në vlerat e kritereve dhe synimin për të implementuar setin e kërkesave, më shumë se sa për të përmirësuar efektivisht rezultatet.

Në punimet e tij shkencore, Dr. Norbert Wiener, shkencëtar dhe themelues i teorisë së kibernetikës dhe inteligjencës artificiale, sinjalizoi se ne duhet me doemos te ndjekim objektivat dhe të presim vetëm rezultatet që janë vërtetë të nevojshme (jo vetëm ato që janë të tilla në dukje). Studimet shkencore në çështjet e menaxhimit na kanë orientuar në përdorimin e shprehjes "efekti i putrës së majmunit". Kjo frazë simbolizon një defekt dhe paparashikueshmëri të çfarëdolloj procesi kur rezultati i dëshiruar pozitiv shoqërohet nga një pasojë negative e padëshiruar, duke rezultuar në humbje që i tejkalojnë rezultatet pozitive, dhe në të njëjtën kohë i zhvlerësojnë ato.

Kjo përrallë bën fjalë për një familje-bashkëshorti, bashkëshortja dhe djali i tyre, të ulur pranë oxhakut duke dëgjuar histori të aventurave të një miku të familjes, i cili sapo është kthyer nga detyra si marinar. Ai i tregon familjes një putër majmuni, që e kishte sjellë me vete nga udhëtimet e tij, e cila kishte fuqinë t'i plotësonte pronarit të saj tre dëshira. Megjithëse dëshirat dhe pasojat e tyre mbeten një mister, historia që u tregoi miku i tyre kishte një fund tragjik.

Pavarësisht historisë që dëgjoi, babai vendos t'a tërheqi putrën e majmunit nga zjarri. Pasi miku i tij largohet, djali niset për në punë, dhe për kuriozitet, babai provon fatin e tij duke dëshiruar për të para. Dëshira e tij realizohet në momentin që një punëtor nga fabrika në të cilën punonte djali i tij troket në derë dhe i jep familjes një shumë parash prej 200 paundësh. Por kjo shumë erdhi si kompensim për vdekjen e djalit të tyre në një aksident misterioz në fabrikë. Mamaja, mendon spontanisht një mënyrë për t'ju kthyer djali, duke dëshiruar kthimin e tij nga vdekja. Një trokitje ogurzezë dëgjohet në derë. Babai, nxitimthi shpreh një dëshirë të tretë, duke kërkuar që mos të kishte shprehur kurrë asnjë dëshirë, por ndërkohë dera hapet dhe prindërit shikojnë djalin e tyre duke qëndruar pas derës, në të njëjtën gjendje fizike që e kishte lënë aksidenti. Putra, simboli i lakmisë, mund të plotësonte dëshira, të cilat shoqëroheshin me pasoja të tmerrshme, që buronin nga mendime egoiste. Duke e lidhur këtë histori me dorën e autoritetit publik, putra nënkupton që personat të cilët kanë të drejtë vendimarrje, duhet të mendojnë për pasojat e vërteta të veprimeve të tyre.

Mesazhi që kjo histori përcjell është i dyfishtë: të zhvillojmë kurajon për të mësuar nga gabimet, dhe të investojmë në sistemin tonë të edukimit publik për

të nxitur metoda të tilla të të mësuarit eksperimental.

Ne duhet të kuptojmë si mund të mësojmë nga gabimet dhe duhet të mësojmë me guxim. A reflektohen parimet tona kombëtare në buxhetin shtetëror, apo vetëm në retorikën tonë? A jemi në gjendje ne të përkufizojmë, të biem dakort në atë çka përbën vlerë të shtuar?

Të diskutojmë me sinqeritet për mënyrën se si e përballojmë financimin e edukimit është sot më e rëndësishme se kurrë. Për më shumë se 10 vite, rezultatet e të mësuarit në Lituani kanë rënë poshtë mesatares së vendeve anëtare të Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD).

Numri i shkollave është duke u zvogëluar me një hap më të ngadaltë, se sa numri i nxënësve. Rezultatet e procesit të të mësuarit në shkolla më të vogla rurale janë më të ulëta se në qytetet e mëdha. Kjo dukuri e rrit akoma më tepër përjashtimin. Studimet më të fundit për të ardhmen e edukimit kanë arritur në përfundimin se nxënësit me rezultate të ulëta të mësuari përbëjnë potencialisht një barrë publike- pjesa më e madhe e tyre nuk do të jetë e aftë të jetojë dhe punojë në pavarësi. Atyre do t'u nevojitet të mbahen nga dikush.

Krijimi i vlerës së shtuar ka një efekt kombëtar shumë pozitiv sa i përket problemeve shoqërore të tilla si emigrimi dhe përjashtimi shoqëror. Prandaj, hapi i parë i madh duhet të jetë identifikimi i qartë i këtyre objektivave. Së dyti, u duhet dhënë prioritet masave synojnë të rrisin vlerën e shtuar. Së treti, aktiviteti i organizmave të sektorit publik, nuk duhet të fokusohet vetëm në funksionin social dhe ruajtjen e punës, por në garantimin e një cilësie sa më të lartë të shërbimit publik.

Të tilla ndryshime kërkojnë një person që të jetë pas realizimit të tyre. Prandaj, duhet të rriten rrogat për nëpunësit civil të sektorit publik. Duke realizuar këtë, rrjedhimisht do të rritet potenciali për të tërhequr punonjës më të kualifikuar dhe të motivuar. Është një objektiv shumë ambicioz.

E dini çfarë është akoma më tepër ambicioze? Të bësh vetëm gjëra kuptimplota. Shkencat shoqërore shpeshherë vënë në dukje mungesën e racionalitetit në sjelljen njerëzore, dhe historia e putrës së majmunit na tregon se pritshmëritë e shtrembra, shpesh çojnë në pasoja negative, të shkaktuara jo nga një objekt, por nga sistemi në të cilin jetojnë personazhet.

Përmbushja e gjërave të rëndësishme nuk mund të bëhet me anë të putrës së majmunit. Sepse kështu, thjesht do të gjejë një pronar tjetër me anë të së cilit do të vijojë qarkullimin në tregun e lakmisë. A nuk na sjell ndërmend praktikën kur një kërcënim i fshehur – qeverisja buxhetore e thatë si putra e

majmunit – udhëton nga një administratë politike në një tjetër.

Nëse do të kërkonim për 200 paund nga buxheti i shtetit, pa diskutuar hapur dhe me sinqeritet kushtet, ndoshta ne vërtet do t'i pranonim këto fonde, pavarësisht pasojave të mundshme. Megjithatë, nëse ne nuk mund të biem dakord mbi atë çka përbën vlerë të shtuar, mbi atë çka është një investim moral dhe i drejtë, atëherë një "fantazmë rezultatesh" mund të vijë të trokasë në dyert tona.

Përktheu: Amantja Patozi, Audituese

Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Arūnas Dulkys, PhD, Auditues i Përgjithshëm i Republikës së Lituanisë

DUKE TRANSFORMUAR BOTËN NËPËRMJET PËRPJEKJEVE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Përfitimet që sigurojnë SAI-t janë përmbledhur në Standardin Ndërkom-bëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI 12), "Vlera dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit – Të bërit e diferencës në jetën e qytetarëve".

Nga: Shourjo CHATTERJEE, Krye-llogaritar (Kontabilist i Përgjithshëm), SAI i Indisë

Botuar në Revistën e INTOSAI-t, verë 2018

Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) i kanë shërbyer qytetarëve duke siguruar përdorim të përgjegjshëm të burimeve publike për zhvillimin kombëtar. Pavarësisht nga kufijtë, në të gjithë Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), anëtarët bashkëpunojnë me kolegët ndërkombëtarë dhe homologët e tyre për të siguruar ofrimin e shërbimeve të vlefshme për qytetarët.

Kjo bindje e dëshmuar në aftësitë e SAI-eve është ilustruar në raportet gjithëpërfshirëse të auditimit të shoqëruar me ndërveprim të rregullt mes Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe INTOSAI, në simpoziume të UN/INTOSAI. Bashkëpunimet e vazhdueshme çuan në Asamblenë e Përgjithshme të 66-të të Kombeve të Bashkuara, në të cilën u miratua rezoluta e vitit 2011 mbi Pavarësinë e SAI, e cila u përforcua më pas nga Rezoluta e 69-të e AP të OKB, që u përqendrua në promovimin dhe nxitjen e efikasitetit të administratës publike, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën duke forcuar SAI-t.

Përfitimet që sigurojnë SAI-t janë përmbledhur në Standardin Ndërkom-bëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI 12), "Vlera dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit – Të bërit e diferencës në jetën e qytetarëve".

Në këtë kontekst, studimi i rolit të SAI-ve në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) është i rëndësishëm, pasi këto synime kërkojnë të shkojnë përtej adresimit të përdorimit të burimeve dhe ofrimit të

shërbimeve. Përkundrazi, ato kanë të bëjnë me çështjen shumë më të madhe. Atë të mbështetjes së botës për brezat e ardhshëm, siç ilustrohet nga Axhenda e vitit 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm. 17 OZHQ-të që dalin nga Axhenda 2030-tës kërkojnë të mbështeten mbi sukseset e OZHM-ve, një fushatë e OKB-së e nisur në vitin 2002 që mbështeti dhe frymëzoi veprimet globale për të arritur tetë qëllime deri në vitin 2015.

Ky artikull kërkon të përmbledhë kontributet e SAI-ve dhe rëndësinë e tyre, për t'i shërbyer botës nëpërmjet përpjekjeve të qëndrueshmërisë dhe për të ndihmuar në arritjen e përgjegjësive të OZHM-ve dhe OZHQ-ve.

Realizimi i OZHM-ve

Ndryshe nga bashkëpunimi i institucionalizuar dhe përpjekjet formale për përfshirjen e SAI-ve në zbatimin e OZHQ-ve, përpjekjet t qarta të OZHM-ve ishin relativisht të kufizuara. Megjithatë, zbatimi i OZHM-ve u shënua nga një rritje në adoptimin e auditimeve të performancës dhe auditime të tjera të veçanta që përfshinin aspektet gjinore, mjedisore dhe sociale.

Tabela 1. ilustron auditimet indikative që korrespondojnë me çdo OZHM të ndërmarrë nga një mostër globale SAI. Këto lloje të auditimit kanë ndihmuar në realizimin e OZHM-ve. Në veçanti, Grupi i Punës i INTOSAI mbi Auditimin Mjedisor (WGEA) vazhdimisht ka kontribuar në OZHM 7 duke krijuar mundësi bashkëpunimi dhe mbështetje nga kolegët.

SAI	MDG	TITULLI I AUDITIMIT	VITI	SKICA E PËRMBLEDHJES
SAI i KINËS	1	Rezultatet e auditimit të 40 shteteve të fondeve për lehtësimin e varfërisë financiare nga Zyra Kombëtare e Auditimit	2016	Performanca e autoriteteve kompetente në shpërndarjen dhe menaxhimin e fondeve për zbutjen e varfërisë
OLACEFS (SAI-të e Brazilit, Kilit, Kolumbisë, Kosta Rikës, Kubës, Ekuadorit, Guatemalës, Hondurasit, Meksikës, Panamasë dhe	2	Auditim i Koordinuar mbi Indikatorët e Edukimit	2016	Auditimi i Performancës në gjenerimin e statistikave të edukimit vlerësoi sjelljen e treguesve të qëllimeve të arsimit në kontekstin e OZHM-ve dhe programit "Arsimi për të gjithë"

Republikës Domenikane)				
SAI I UGANDËS	3	Raporti i Auditimit të VFM mbi përpjekjet e qeverisë për arritjen e barazisë gjinore	2013	Pabarazia gjinore si shkak dhe pasojë e varfërisë dhe një pengesë për rritjen kombëtare. Politika e Gjinisë në Ugandë dhe Gender Mainstreaming Tool
SAI I INDISË	4	Auditim i Performancës i Integrimit të Skemës së Shërbimit të Zhvillimit të Fëmijëve i Bashkimit Qeveritar, Ministria e Zhvillimit të Grave dhe Fëmijës	2013	Shërbimet e mundësuara nga shteti për fëmijët para dhe pas lindjes dhe periudhën e rritjes për të siguruar zhvillimin e tyre holistik
ZKA E TANZANISË	5	Auditim Performance mbi Vlerësimet e Monitorimit dhe Alokimin e Buxhetit për Aktivitetet e Kujdesit Shëndetësor tek Nënat në Tanzani	2011	Vdekshmëria e nënave, edukimi shëndetësor i nënës, vlerësimi i komponentëve të sistemit shëndetësor që lidhet me shëndetin e nënës dhe alokimin e fondeve për kujdesin shëndetësor të nënës
ZKA E MB	6	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar në lidhje me HIV/AIDS	2004	Strategjia e HIV/AIDS; partneritete globale për të arritur objektivat e saj për HIV / AIDS; lufta ndaj epidemisë; përdorimi i hulumtimit mbi HIV/AIDS
PASAI (SAI-të e Ishujve Kuk, Shteteve të Federuara të Mikronezisë, FSM Kosrae, FSM Pohnpei, Fixhi, Palau,	7	Auditim i Performancës i koordinuar i Rajonit të Paqësorit në Strategjitë e Reduktimit dhe Menaxhimit të Ndryshimeve Klimatike dhe Strategjive të Reduktimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë	2015	Përgatitja për efektet e ndryshimeve klimatike; planifikimi dhe menaxhimi i efekteve të ndryshimeve klimatike, të tilla si erozioni bregdetar; dhe menaxhimin e efekteve të ndryshimeve klimatike në sigurinë e

Samoa, Tuvalu dhe dy Ishuj Pacifik dhe Territore të tjera)				ushqimit

Zbatimi i OZHQ - Rolet e SAI

Roli i SAI-t në zbatimin e OZHQ u pasqyrua në aktivitetet më të fundit të UN-INTOSAI-t të mbajtura në 2015 dhe 2017, me simpoziumin e 2015-ës të fokusuar në agjendën e zhvillimit të OKB-së pas vitit 2015 dhe mënyrat se si SAI duhet të zbatojë Zhvillimin e Qëndrueshëm, ndërsa Simpoziumi i 2017 theksoi se si dixhitalizimi, të dhënat e hapura dhe minierat e të dhënave ndikojnë në punën e auditimit të SAI dhe ndihmojnë në rritjen e kontributeve të SAI drejt ndjekjes dhe shqyrtimit të zbatimit të OZHQ.

Kongresi XXII i INTOSAI në vitin 2016 gjithashtu zbatoi një qasje tematike ndaj OZHQ, që adresoi rolin e SAI në zbatimin e OZHQ, duke i kushtuar vëmendje të veçantë asaj se si INTOSAI mund të kontribuojë në Axhendën e OKB-së 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm përmes qeverisjes së mirë dhe forcimit të luftës kundër korrupsionit. Agjencitë e OKB-së po bashkëpunojnë me Iniciativën e Zhvillimit të INTOSAI (IDI) për të ndërtuar kapacitetin e SAI përmes programit IDI "Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Auditimit", dhe bashkëpunimi i INTOSAI rajonal, dypalësh dhe multilateral ndërmjet SAI-ve është gjithashtu i nxitur për të promovuar kapacitetet në rishikimin dhe ndjekjen në përputhje me përpjekjet kombëtare të zbatimit të OZHQ. Sipas Raportit të IDI-t për Statistikat e SAI 2017, 193 vende kanë nënshkruar për zbatimin e OZHQ dhe INTOSAI e ka njohur këtë si një prioritet ndërsektorial në planin e saj strategjik. Pesëdhjetë e gjashtë përqind e SAI-ve kanë shprehur gatishmëri për të përfshirë temat ose për zbatimin e OZHQ-ve në programet pasuese të auditimit.

Qëndrueshmëria - Adresimi i Sfidave të SAI

SAI-t kanë përgjegjësinë e vështirë për të siguruar llogaridhënie në procesin e transformimit të botës deri në vitin 2030. Është e rëndësishme të njihen me sfidat e hasura dhe se si mund të adresohen këto sfida.

Sfidat institucionale: Statistikat e IDI-së për vitin 2017 të SAI-t tregojnë se shumica e SAI-ve kanë mandatet, kapacitetin dhe gatishmërinë për të audituar zbatimin e OZHQ ose gatishmërinë kombëtare për zbatimin e OZHQ. SAI-t e tjera duhet të forcojnë

mandatet dhe të ndjekin përpjekjet duke u angazhuar me aktorët relevantë.

Sfidat e kapaciteteve: SAI-t duhet të mundësojnë aftësinë për të trajtuar OZHQ-të duke u fokusuar në mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve, shkëmbimin e njohurive, mbështetjen e kolegëve dhe trajnimin. Ato gjithashtu duhet të zhvillojnë tregues të duhur të performancës për të vlerësuar dhe korrigjuar sfida të tilla.

Sistemet Kombëtare të të Dhënave: Raporti i IDI-t i vitit 2017 mbi SAI-t, citon: "30% të SAI-ve treguan se nuk dinin nëse qeveritë e tyre (1) kanë krijuar të dhëna bazë të OZHQ ose (2) synojnë të mbledhin të dhëna dhe të raportojnë për progresin e OZHQ. Vetëm 21% e qeverive kanë përcaktuar të dhëna bazë për të monitoruar dhe vlerësuar progresin e implementimit të OZHQ, dhe 24% janë në fazat e hershme të përgatitjes. Është e domosdoshme që SAI-t të angazhohen me zyrtarë qeveritarë dhe të rekomandojë mjete dhe teknika të përshtatshme.

Lidershipi dhe angazhimi i palëve të interesuara: Lidershipi i SAI-t duhet të udhëheqë si shembull, të vendosë tonin dhe vazhdimisht të kërkojë angazhimin dhe bashkëpunimin me palët e interesuara.

Lidhjet mbështetëse: Rëndësia e lidhjeve mbështetëse është kritike. Për ta bërë këtë, SAI-t duhet të përdorin ISSAI-t e përshtatshme dhe të përdorin treguesit e performancës për të asistuar në vlerësimin e punës në një mënyrë të tillë, që çon në përmirësim të vazhdueshëm.

Përfundime

Komuniteti ndërkombëtar i ka besuar SAI-t me një rol të rëndësishëm në vlerësimin e OZHQ-ve. Mandatet dhe ekspertiza e SAI-ve, së bashku me përvojën në kryerjen e auditimeve në përputhje të OZHM-ve, do t'u mundësojnë atyre që të përmbushin më mirë kërkesat e OZHQ-ve dhe t'i shërbejnë njerëzimit duke transformuar botën.

Përktheu: Reinis Xhelili. Auditues

Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Shourjo CHATTERJEE, Kryellogaritar (Kontabilist i Përgjithshëm), SAI i Indisë

KAPITALIZIMI I STANDARDEVE, NDARJA E NJOHURIVE PËR TË AUDITUAR PËRPJEKJET PËR RIMËKËMBJEN NGA FATKEQËSITË

Botuar në Revistën e INTOSAI-t, verë 2018

Rezultatet e auditimit, të pasqyruara në 60 raporte të aprovuara dhe të publikuara nga SAI i Ekuadorit, treguan se veprimet e koordinuara të autoriteteve publike për të pakësuar dhe lehtësuar impaktin e tërmetit - zhvendosja e brigadave mjekësore, përfshirja e personelit të punëve publike dhe e pajisjeve të rënda për të hequr mbetjet e tërmetit, dhe organizimi, paketimi, transportimi dhe dorëzimi i ndihmave humanitare.

Nga: Betty Carrion Ruiz, Audituese, Zyra e Kontrolluesit të Përgjithshëm të Republikës së Ekuadorit

Në 2016, një tërmet me magnitudë 7.8 ballë tronditi brigjet e Ekuadorit, duke rezultuar në një nga tragjeditë me përmasat më katastrofike në historinë e vendit. Një numër prej 663 njerëzish humbën jetën gjatë këtij tërmeti, 6.274 mbetën të plagosur, 80.000 njerëz u zhvendosën, u shkaktuan dëme të mëdha në infrastrukturë dhe më shumë se 2.300 tronditje pas tërmetit u ndjenë në muajt në vijim.

Si pasojë, masat për rikuperim kushtuan përafërsisht 3.344 milionë dollarë, duke përbërë një sfidë të vërtetë për kapacitetin e disa institucioneve publike, duke përfshirë Zyrën e Kontrolluesit të Përgjithshëm të Republikës së Ekuadorit - Institucionin Kombëtar Suprem të Auditimit.

Qeveria e Ekuadorit ju përgjigj krizës duke deklaruar menjëherë gjendjen e jashtëzakonshme dhe duke implementuar disa veprime: aktivizoi planin e emergjencave, duke krijuar Komitetet Kombëtare, Provincialedhe Kantonale të Veprimeve Emergjente, dhe duke krijuar Komitetin e Rikonstruktimit dhe Riaktivizimit Produktiv.

Qeveria gjithashtu vuri në jetë Ligjin Organik të Solidaritetit dhe të Përgjegjësisë së Përbashkët Qytetare për Rikonstruktimin dhe Riaktivizimin e Zonave të Prekura (Ligji i Solidaritetit) dhe kërkoi përfshirjen e disa enteve publike, duke përfshirë forcat e

armatosura, Shërbimet e Integruara të Sigurisë (ECU911), Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Transportit dhe Punëve Publike, Policinë Kombëtare dhe Sekretarin e Menaxhimit të Riskut.

Ligji i Solidaritetit, i cili hyri në fuqi në Maj të 2016-ës, përcaktonte kontributet që kërkoheshin nga qytetarët për të ndihmuar lehtësimin e pasojave që kishte lënë tërmeti – një rritje në vlerën e shtuar të taksës për një vit, një 3.3.% të mbajtur nga rroga mujore e individëve që do të zgjaste 8 muaj, një shifër më pak se 1% të mbledhur nga të ardhurat e entiteteve që tejkalonin shumën 1 milionë dollar në fitime, taksën e pronës së paluajtshme ekzistuese 3.3%, dhe një kontribut 3% nga të ardhurat e fituara.

Këto fonde (së bashku me ndihmat ndërkombëtare) lejuan planifikimin, konstruktimin dhe rikonstruktimin e infrastrukturës publike dhe private. Paratë promovuan gjithashtu riaktivizimin duke kontribuar në implementimin e një game të gjerë iniciativash dhe duke bërë të mundur që SAI i Ekuadorit (si organizmi teknik përgjegjës për kontrollin dhe përdorimin e resurseve publike) të fillonte auditimin e entiteteve përgjegjëse për të menaxhuar fondet e këtyre iniciativave.

Synimet e SAI-t të Ekuadorit ishin: (1) të mundësonte saktësi, vërtetësi, dhe ligjshmëri të veprimeve, kontrolleve dhe resurseve të emergjencës; (2) të verifikonte përputhshmërinë ligjore dhe rregullatore, (3) të ekzaminonte shpërndarjen e fondeve duke u siguruar se ishin shpërndarë në përputhje me zonat e prekura, dhe (4) të vendoste nëse resurset ju ishin shpërndarë viktimave në përputhje me procedurat përkatëse ligjore.

Rezultatet e auditimit, të pasqyruara në 60 raporte të aprovuara dhe të publikuara nga SAI i Ekuadorit, treguan se veprimet e koordinuara të autoriteteve publike për të pakësuar dhe lehtësuar impaktin e tërmetit - zhvendosja e brigadave mjekësore, përfshirja e personelit të punëve publike dhe e pajisjeve të rënda për të hequr mbetjet e tërmetit, dhe organizimi, paketimi, transportimi dhe dorëzimi i ndihmave humanitare.

Pavarësisht veprimeve pozitive të kryera, u identifikuan gjithashtu dobësi me impakt të rëndë social, duke përdorur resurset për qëllime të tjera që nuk kishin të bënin me tërmetin, të meta në dorëzimin e pakove me ushqime të cilat pengonin shpërndarjen e tyre në kohë; dhe mungesa e dokumentacionit të nevojshëm për të përcaktuar përfituesit finalë. Resurset u harxhuan në blerje të panevojshme, përdorimi i të mirave jashtë kushteve kontraktuale rezultoi në vënien e gjobave, pastrimi doganor dhe procesi i shpërndarjes ndikuan negativisht në dorëzimin e ndihmave humanitare tek personat, të cilëve u nevojiteshin, dhe pati në përgjithësi një mungesë

dokumentacioni për monitorimin dhe kontrollin e operacioneve administrative dhe financiare, duke përfshirë pagesat e fundit për shpenzimet nga fondi i Ligjit të Solidaritetit.

Për më tepër, disa parregullësi u zbuluan, të tilla si kontratat që nuk kishin klauzola shtesë për gjobat dhe garancitë, mungesa e një plani emergjencash për eventet sizmike, mungesa e policave të sigurimit; dhe një mungesë e strehave të kualifikuara dhe të vlerësuara.

Gjetjet e SAI-t të Ekuadorit rezultuan në rekomandimet e mëposhtme:

- Projektimi i një sistemi që të sigurojë se donacionet do të mbërrijnë në destinacionet e parashikuara;
- Përforcimi i koordinimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimeve për të planifikuar, organizuar dhe ekzekutuar parandalimin e katastrofave natyrore, shpëtimin dhe asistencën për rikuperim;
- Implementimi dhe zbatimi i rregullava sa i përket donacioneve humanitare, ruajtjes dhe organizimit të tyre në mënyrë që të sigurohet konservimi dhe mbërritja e tyre në destinacion;
- Lëshimi i udhëzimeve të qarta ndihmëse në mënyrë që donacionet të kalojnë doganat në kohën më të shkurtër të mundshme dhe të mund të shkojnë në kohë pranë viktimave;
- Realizimi i trajnimeve dhe stimulimeve për menaxhimin e riskut (për nëpunësit publik dhe privat, institucionet edukative dhe komunitetin në përgjithësi).

Standardi Ndërkombëtar për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI) 5520 në lidhje me “Auditi i Ndihmës në raste katastrofash natyrore” parashikon se audituesit duhet të jenë në dijeni të të gjithë ciklit të menaxhimit të katastrofave, i cili në një fazë të mëvonshme të tij përfshin aktivitetet e lehtësimit dhe rikuperimit nga emergjencat, rehabilitimin dhe rikonstruktimin. Për më tepër, audituesit duhet të kuptojnë që katastrofa të niveleve të tilla kërkojnë një farë fleksibilitetit. Kjo mund të nënkuptojë një moszbatim të përkohshëm të rregulloreve dhe/ose aplikimin e një kuadri ligjor specifik për të tilla situata emergjente. ISSAI 5520 gjithashtu i fton audituesit të konsiderojnë mundësinë për të nisur audite në një fazë të hershme (në kohë reale), të mbledhin prova në praktikë dhe të performojnë një vlerësim të riskut që përfshin: vonesat, ekonominë, dëmin mjedisor, riskun e deklarimeve financiare, mashtrimin dhe korrupsionin, fondet, inefektivitetin dhe ineficcensën, shpërndarjen e burimeve dhe të asistencës, marrës të padëshiruar, ndihma të paregjistruara. Në rastin e Ekuadorit, vlerësimi i këtyre risqeve i lejon audituesit të idenfitikojnë

dobësitë dhe parregullsitë duke propozuar veprime të përmirësuara për të optimizuar menaxhimin e eventeve të tilla në të ardhmen.

Procesi i të mësuarit nga SAI të tjera që janë përballur më parë me të tilla situata është gjithashtu një mundësi shumë e mirë për të përfituar eksperiencë. Zyra Kombëtare e Auditit të Popullit të Republikës së Kinës (NAO), një drejtues botëror sa i përket kontrollit të fatkeqësive natyrore, ka implementuar strategji për të shmangur dështime të mëdha për rikonstruksionin, identifikimin e pengesave, idenfitikimin e të metave në lidhje me koordinimin dhe menaxhimin e fondeve, dhe propozimin e korrigjimeve nëpërmjet rekomandimeve konstruktive.

Fatkeqësitë natyrore nuk mund të parandalohen, por disa nga efektet e tyre mund të minimizohen. Të kthehemi pas në kohë, në eventet e ndodhura, në praktikat e zbatuara më parë, dhe të mësojmë nga eksperiencat e të tjerëve mund të ndihmojnë audituesit të propozojnë përmirësime të lidhura me mbikqyrjen, të ndihmojnë në krijimin e mekanizmave të reja për të përmirësuar dobësitë dhe parregullsitë, dhe si përfundim, për të patur një impakt pozitiv mbi jetët e shtetasve.

Përktheu: Elisa Metaj, Audituese

Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Betty Carrion Ruiz, Audituese, Zyra e Kontrolluesit të Përgjithshëm të Republikës së Ekuadorit

Info Kontrolli i Lartë i Shtetit
AKTIVITETE TË KLSH-së PËR PERIUDHËN MAJ-GUSHT 2018

Ambasada e Republikës së Polonisë në Tiranë dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit organizuan promovimin e librit "100 Simbolet Polake"

Në datën 3 maj 2018, me rastin e Ditës së Kushtetutës polake të vitit 1791, kushtetuta më e vjetër demokratike e Evropës dhe e dyta në botë, pas asaj amerikane, Ambasada e Republikës së Polonisë në Tiranë dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit organizuan promovimin e librit "100 Simbolet polake".

Në këtë aktivitet të rëndësishëm morën pjesë Ambasadori i Republikës së Polonisë në Tiranë, SHTZ Karol Bachura, Ministri i Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Polonisë, znj. Edyta Bielak Jomaa, Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, z.Wojciech Kutyla, Zv/President i SAI-t Polak, z.Jacek Jezierski, ish-President i SAI-t Polak dhe aktualisht Këshilltar i Presidentit të këtij SAI, profesorë, analistë, anëtarë të Shoqatës "Shqipëri-Poloni", përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, përfaqësues të medias, drejtues dhe auditues të KLSH-së.

Në respekt dhe në nderim të dy shteteve u dëgjuan himnet kombëtare të të dy vendeve. Fjalen e hapjes e mbajti Ambasadori i Republikës së Polonisë në Tiranë, SHTZ Karol Bachura.

Gjatë fjalës së tij zoti Bachura, në emër të qeverisë polake, shprehu vlerësimin e lartë mbi partneritetin e Institucioneve Supreme të Auditimit të Shqipërisë dhe Polonisë dhe bashkëpunimin e tyre të ngushtë në kuadër të implementimit të Projektit të Binjakëzimit, IPA 2013.

"Libri "100 simbolet polake"- vijoi zoti Bachura," mbart vlera të jashtëzakonshme njohëse të Polonisë, të shpirtit të popullit polak të paepur për liri, të kulturës, artit, traditave, thesareve historike, arkeologjike, ekologjike, ekonomike dhe shkencore të këtij vendi të madh të Evropës dhe botës, mik i Shqipërisë dhe shqiptarëve. Ai është një udhëtim në kohë mbi vendet më tërheqëse, doket e një kombi, ngjarjet më epike, krijuesit më përfaqësues dhe personazhet që nuk shlyhen kurrë nga kujtesa e tij".

Më pas e mori fjalën Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj, i cili u shpreh: *"Në këtë ditë të madhe për kombin polak, si KLSH promovojmë librin-album "Simbolet polake: 100 vende, figura, ngjarje, arritje të rëndësishme për Poloninë, Europën dhe Botën", i cili tani vjen i përkthyer i plotë edhe në gjuhën shqipe,*

nga një grup audituesish të KLSH, në dedikim të Presidentit të institucionit suprem të auditimit të Polonisë (NIK), z. Krzysztof Kwiatkowski, të ish-Presidentit dhe sot Këshilltar i Lartë i NIK, z. Jacek Jezierski, si dhe të Zv-Presidentit të NIK, z. Wojciech Kutyla, për ndihmesën e tyre të spikatur në ngritjen e kapaciteteve të audituesve shqiptarë.

Ky libër kontribuon jo vetëm ne njohjen e historisë, traditave dhe vlerave te kombit Polak por edhe në forcimin e njohjes dhe miqësisë mes dy popujve tanë.

Është e vështirë t'i sjellësh në një fjalë të gjitha këto ikona të historisë, kulturës, artit dhe ekzistencës së popullit polak, kushtuar 100 simboleve të një kombi të madh".

Në përfundim te fjalës se tij zoti Leskaj u shpreh: *-Po e mbyll këtë vlerësim modest të këtij Libri-Album të jashtëzakonshëm "100 Simbolet Polake", me një konsideratë. Rreth 40 simbole të Librit janë shumë të përafërt me simbole të historisë, kulturës, arteve, traditave dhe natyrës së kombit shqiptar. Polakët dhe shqiptarët i bashkojnë sakrificat e panumurta në luftën dhe etjen e tyre të pashuar për liri, jetesë në Familjen e Madhe Evropiane, me dinjitet dhe krenari për origjinën dhe zakonet e tyre. Për krenarinë dhe dijet e brezave të rinj që vijnë, por edhe për të huajtë që na vizitojnë përherë e më shumë, do të ishte me vlerë të kishim edhe ne një Album të ngjashëm me njëqind simbole shqiptare, të shoqëruar me një tekst që i shpjegon kaq thjesht, shkurt dhe bukur ato, sa teksti i Librit-Album polak. Nëse ndërkohë, ndonjë institucion shqiptar nuk do ta ndërmarrë këtë nismë, pasi të largohem nga detyra e Kryetarit të KLSH, mendoj t'ia përkushtoj një pjesë të kohës dhe përpjekjeve të mija*

përgatitjes së librit-album të 100 Simboleve Shqiptare.

Ceremonia vijoi me recitimin e disa poezive të zgjedhura polake të përkthyera në gjuhën shqipe, recituar nga dy figura të shquara të skenës dhe artit shqiptar, nga "Nderi i Kombit", z. Mirush Kabashi dhe "Mjeshtri i Madh", z. Bujar Asqeriu. Të dy interpretimet u mirëpritën nga të pranishmit dhe ngjallën emocione.

Më pas e mori fjalën z. Wojciech Kutyla, i cili theksoi bashkëpunimin e ngushtë dhe efektiv mes dy SAI-ve, veçanërisht në ngritjen e kapaciteteve të stafit. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm ka luajtur projekti IPA 2013, i financuar nga Bashkimi Europian, *"Ngritja e kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm"*, që po implementohet prej dy vitesh në KLSH nga SAI Polak dhe SAI Kroat.

Këtë ceremoni e përshëndeti dhe analisti dhe shkrimtari z. Prec Zogaj, i cili i bëri një analizë librit, për të cilin u shpreh:

"Jam vërtetë i nderuar, e lexova me etje të madhe librin, do t'i kthehem përsëri si të isha duke vizituar majat ku ka kaluar historia e Polonisë, galerinë e personazheve të shquar që ky vend i ka dhënë botës".

Duke lexuar librin, pashë se zgjedhja ime për të qenë polak nëse do të kisha mundësi të zgjidhja një kombësi tjetër nga kjo që kam, përforcohej në një numër të madh gjërash të përbashkëta".

Me shumë interes u ndoq në fund një performancë e shkëlqyer e Grupit polifonik "Çipini", anëtarët e të cilit i kishin kushtuar një këngë polifonike popullit polak dhe miqësisë mes dy vendeve. Kënga prekte me mjeshtërinë e polifonisë labe vlerat, virtytet dhe figurat historike të Polonisë.

Misioni i Anëtarëve të Parlamentit Europian për Kontrollin e Buxhetit takon Kryetarin e KLSH-së

Në datën 9 maj 2018, misioni i Deputetëve të Komisionit për Kontrollin e Buxhetit në Parlamentin Evropian, i kryesuar nga Europarlamentari Derek Vaughan, i përbërë nga deputetët Joachim Zeller, Gjermani, Wolf Klinz, Gjermani, Ryszard Czarnecki, Poloni dhe Anëtari i Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Hannu Takkula zhvilloi një takim me Kryetarin e KLSH, z.Bujar Leskaj.

Deputetët europianë u interesuan të dinë për pavarësinë e institucionit kushtetues të KLSH për të përmbushur misionin kushtetues, dhe progresin e auditimit suprem publik në Shqipëri në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit, si në pikëpamje të

kapaciteteve ashtu dhe të aktivitetit auditues.

Kryetari i KLSH-së, Zoti Leskaj i falenderoi deputetët e Parlamentit Europian, duke shprehur kënaqësinë për vizitën e tyre në një ditë të madhe dhe kuptimplotë edhe për Shqipërinë, sikurse është 9 Maji, Dita e Evropës. Ai u shpreh se *"Për të siguruar pavarësinë e plotë dhe një ligj për KLSH-në, në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t, luftuam gjatë. I jemi mirënjohës Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit DG-Budget të Komisionit Evropian dhe Programit SIGMA, që na ndihmuan me ekspertizë të vlefshme dhe na mbështetën".* Europarlamentarët vlerësuan prezantimin e bërë nga Kryetari Leskaj për modernizimin e institucionit të auditimit të jashtëm publik në Shqipëri dhe rritjen e kapaciteteve audituese, duke e cilësuar impresionues progresin e arritur. Eurodeputeti Derek Vaughan, Kryetar i Misionit, falenderoi z. Leskaj për informacionin e dhënë, si dhe për materialet e detajuara, njohëse të vëna në dispozicion, të cilat mundësonin krijimin e një pamje të plotë mbi aspektet kryesore të punës shumë dimensionale të KLSH-së, duke cilësuar se do t'i shqyrtojë me imtësi dhe do t'i pasyrojë në raportin e Misionit. Nga ana e tij, Anëtari i Gjykatës Evropiane të Audituesve(ECA), z. Hannu Takkula foli për një auditim tërësor të zhvilluar disa vite më parë në vendet e Ballkanit Jug-Perëndimor nga ECA dhe nënvizoi bashkëpunimin e deritanishëm me KLSH-në. Kryetari i KLSH e falenderoi ECA-n për intershipet e organizuara prej saj për audituesit e KLSH-së dhe u shpreh se në institucion po rritet dhe konsolidohet një brez audituesish që kanë marrë përvojën e mirë audituese të ECA-s. Në mënyrë specifike interesi i Anëtarit të Gjykatës Evropiane të Audituesve ishte mbi nivelin e bashkëpunimit të institucioneve publike nga pikëpamja e ofrimit të informacionit, si dhe mbi bashkëpunimin e KLSH-së me median, si partneri kryesor në mbrojtjen e interesit publik. Faktet dhe treguesit e paraqitura nga KLSH-ja në përgjigje të këtij interesi u vlerësuan për diversifikimin e instrumentave të përdorura për të rritur si shkallën e bashkëpunimit me subjektet publike që auditohen ashtu edhe me median, pavarësisht se KLSH është ballafaquar me raste të shkëptura të një reagimi jo pozitiv të institucioneve publike.

Pyetjes së Eurodeputetit Wolf Klinz, në lidhje me shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të institucionit të auditimit të jashtëm publik në Shqipëri,

z. Leskaj iu përgjigj duke cilësuar se mesatarisht ky nivel zbatimi është i kënaqshëm, në shifrat 60-70 përqind, i ngjashëm me nivelet e SAI-ve të rajonit dhe atyre të zhvilluara, por problematike ngelet zbatueshmëria e ulët e propozimeve të KLSH për largim nga puna të zyrtarëve të lartë të denoncuar nga institucioni. *"Si një mjet efiçient për të luftuar antikulturën e pandëshkueshmërisë, kemi rekomanduar përgatitjen dhe miratimin e Ligjit për Përgjegjësinë Materiale të Nëpunësit Publik. Kemi kërkuar edhe ndihmën e Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe të disa Ambasadave të vendeve perëndimore në Shqipëri, për ta çuar përpara këtë nismë"*. KLSH beson se nëpërmjet bashkëpunimit me Parlamentin dhe veçanërisht me Komisionin e Ekonomisë dhe të Finanacave, si dhe me Qeverinë, shoqërinë civile dhe median do të rrisin efektivitetin dhe pavarësinë reale të KLSH-së duke zbatuar rekomandimet e dhëna, si një tregues i drejtëpërdrejtë i vullnetit politik për luftën reale ndaj korrupsionit.

Deputeti gjerman Joachim Zeller kërkoi të dinte opinionin e Kryetarit të KLSH lidhur me zbatimin e ligjit "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", si një mjet efektiv për të denoncuar korrupsionin. Z. Leskaj u shpreh se ligji është i mirë, por zbatohet pak ose nuk zbatohet fare, ndërkohë që duhet që institucionet shtetërore të mbrojnë sinjalizuesit. KLSH ka qenë institucioni i cili e ka konsideruar si një instrument të rëndësishëm, duke dhënë kontributin e tij për ndërtimin e një ambienti sa më pranues në lidhje me këtë instrument, për ta bërë atë efektive.

Në fund të takimit, eurodeputetët, pasi falenderuan për pritjen dhe informacionet e shumta te marra, vizituan muzeun e KLSH dhe vlerësuan punën e bërë për informimin e publikun dhe për botimet KLSH.

Takimi i Rrjetit të Koordinatorëve të SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së, vendeve Kandidate dhe Kandidate të mundshme për në BE

Në datat 9-11 maj 2017, u zhvillua në Maltë, takimi i radhës i rrjetit të koordinatorëve të SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së, Kandidate dhe Kandidate të mundshme për në BE, me pjesëmarrjen e ECA-s dhe SIGMA-s. Takimi ishte i organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Maltës.

Në datën 9 maj, ishte takimi i vendeve Kandidate dhe Kandidate të mundshme

për në BE, me pjesëmarrjen e ECA-s dhe SIGMA-s. Në këtë takim u raportua nga SAI-t pjesëmarrëse lidhur me aktivitetet e organizuara prej tyre në periudhën midis dy takime të koordinatorëve të SAI-ve. Prezantimi i parë ishte i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, ku u raportua lidhur me ecurinë e seminarit, "Bashkëpunimi me Parlamentin për të rritur impaktin e auditimeve", që do të organizohet me mbështetjen e SIGMA në Prishtinë. Seminari ishte parashikuar të zhvillohej gjatë muajit Maj 2018, por për arsye teknike u ra dakort që të zhvillohet në datën 4 tetor 2018. Më pas SAI i Serbisë prezantoi çështjet që mund të trajtohen në një aktivitet të përbashkët me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të rrjetit për të diskutuar lidhur me zhvillimin e indikatorëve të

Performancës. Takimi vijoi me prezantimin e KLSH-së për workshop-in që do të zhvillohet gjatë muajit nëntor në Tiranë, *"Mbështetja e IT në procesin e auditimit dhe auditimi i software"*. Përfaqësuesit e KLSH-së paraqitën një draft-program, i cili do t'u dërgohet të gjitha SAI-ve anëtare të rrjetit për të bërë komentet e mundshme nga specialistë të auditimit të IT. Më pas grupi përgatitor i këtj workshop-i që përbëhet nga KLSH, SAI i Maqedonisë, Serbisë dhe Turqisë do të hartojë draftin final të axhendës së workshopit dhe do të përcaktojë lektorët.

Në datat 10 dhe 11 maj, aktiviteti vijoi me takimin e koordinatorëve të vendeve anëtare të BE-së. Takimin e hapi me një përshëndetje, Audituesi i Përgjithshëm i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Maltës, z. Charles Deguara, i cili gjatë fjalës së tij theksoi: *"..Eksperienca ka treguar që takime të këtij lloji, të bazuara mbi diskutime të hapura për të gjithë dhe të sinqerta, si edhe shkëmbimi i eksperiencave dhe praktikave më të mira, janë thelbësore në drejtim të mbështetjes që u japin SAI-ve pjesëmarrëse për t'u dhënë përgjigje pyetjeve thelbësore që lidhen me masat që duhet të ndërmarrim me qëllim që të kryejmë auditimet tona në mënyrën më të mirë..".*

Më pas përshëndeti, përfaqësuesi i ECA, z.Leo Brincat, i cili u fokusua në sfidat e SAI-ve të BE-së, veçanërisht në drejtim të mirëmenaxhimit të buxhetit të BE-së, duke u parapërgatitur për të ardhmen, duke krijuar mekanizma të tjerë, si p.sh krijimi së fundmi i Task Forcës për t'u

përgatitur më mirë në përballjen me sfidat e së ardhmes. Task Forca do të shikojë përtej strategjisë së ECA 2018-2020, duke menduar në terma më afatgjatë se cilat do të jenë trendet e së ardhmes dhe si mund të afektojnë këto trende ECA-n.

Më pas takimi u përqëndrua gjerësisht në diskutime mbi takimin e ardhshëm të Komitetit të Kontaktit të vendeve anëtare që do të zhvillohet në Dubrovnik, në datat 11-12 tetor 2018. Përfaqësuesit e SAI-t të Kroacisë që do të jetë SAI organizator paraqitën Draft-Programin e aktivitetit dhe pjesëmarrësit u përfshinë në diskutime dhe sugjerime, në mënyrë që në takim të diskutohet për çështje të rëndësishme për BE.

Më pas, SAI të ndryshme të BE raportuan për aktivitete të përbashkëta që do të organizohen në periudhën në vijim :

- SAI-et e Italisë dhe Gjermanisë mbi Grupin e punës së Tatimit mbi Vlerën e shtuar;
- SAI i Italisë mbi ecurinë e Grupit të Punës për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe parregullsive;
- SAI i Greqisë dhe Portugalisë mbi seminarin për Prokurimet publike që do të zhvillohet në Greqi, në data 31 maj-1 qershor 2018;
- SAI i Turqisë mbi aktivitetet e rrjetit të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme;
- SAI i Polonisë mbi të Dhënat e gabimeve në Prokurimet Publike (rezultatet e një pyetësori);
- SAI i Estonisë mbi Rregullat e mbrojtjes së të dhënave të përgjithshme.

Gjatë paradites së datës 11 maj, takimi trajtoi çështje që lidhen me temat e seminarit që do të zhvillohet në takimin e Komitetit të Kontaktit që do të mbahet në qershor të vitit 2019 në Poloni dhe për takimin e vitit 2019 të rrjetit të koordinatorëve të SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së, Kandidate dhe Kandidate të mundshme për në BE që do të zhvillohet në Rumani gjatë muajit prill.

KLSH u përfaqësua në këtë aktivitet nga tre përfaqësuese të Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, zj.Irena Islami, zj.Elisa Metaj dhe zj.Irma Idrizaj.

Konferenca e nivelit të lartë në Sofje për rolin e SAI-ve në rritjen e Përgjegjshmërisë, Transparencës dhe Integritetit

Në datën 15 maj 2018, në Sofje të Bullgarisë, Zyra Kombëtare e Auditimit të Bullgarisë (BNAO) organizoi, nën Presidencën Bullgare të Këshillit të Bashkimit Evropian, Konferencën e Nivelit të Lartë me titull *"Roli i*

Institucioneve Supreme të Auditimit në rritjen e Përgjegjshmërisë, Transparencës dhe Integritetit në Sektorin Publik".

Merrnin pjesë përfaqësues të lartë të Parlamentit të Bullgarisë dhe të auditimit suprem evropian, ndër të cilët z. Tzvetan Tzvetkov, Presidenti i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Bullgarise, z. Klaus-Heiner Lehne, Presidenti i Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Krzysztof Kwiatkovski, President i Zyrës Kombëtare të Auditimit Shtetëror të Polonisë (NIK), z. Miloslav Kala, President i SAI-t të Cekisë, z. Wolfgang Wicklicky, Drejtor i Përgjithshëm i Gjykatës së Auditimit të Austrisë(ACA), si dhe Presidentët e SAI-ve të Sllovakisë, Finlandës, Sllovenisë dhe të SAI-ve të vendeve të Ballkanit Jugperëndimor.

KLSH mori pjesë me një delegacion të kryesuar nga Kryetari, z. Bujar Leskaj, i përbërë nga zj. Lindita Milo (Lati), Drejtore e Përgjithshme dhe z. Fatos Çoçoli, ekspert i jashtëm.

Në fjalën e tij përshendetëse, Presidenti i SAI-t Bullgar, z. Tzvetan Tzvetkov shprehu dëshirën dhe vullnetin e SAI-t bullgar për një partneritet sa më të plotë të SAI-ve të Ballkanit Jugperëndimor në strukturat e bashkëpunimit të SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së, si dhe ofroi kontributin e institucionit të tij dhe të shtetit bullgar, në cilësinë e Presidencës së Këshillit të Bashkimit Evropian, për një integrim të shpejtë.

Presidenti i Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA) theksoi rëndësinë që i jep ECA bashkëpunimit me SAI-t e vendeve të Ballkanit Jugperëndimor, si dhe zhvillimit të kapaciteteve të tyre dhe kryerjes së auditimeve të përbashkëta me ekspertë të ECA-s dhe të SAI-ve të vendeve anëtare te BE-se. Ai përmendi rrjetin e krijuar mes SAI-ve të vendeve të Ballkanit Jugperëndimor si një strukturë që po i shërben me këmbimin e informacionit dhe të eksperiencave të mira të auditimit, jo vetëm modernizimit të SAI-ve por edhe integrimit të vendeve të tyre.

Në Panelin e Parë të Konferencës, me temë *"Pavarësia institucionale-Faktor kyç për efektivitetin e institucioneve supreme të auditimit"*, referuan Kryetari i KLSH dhe Drejtori i Përgjithshëm i ACA-s, z. Wolfgang Wiklicky.

Z. Wiklicky u ndal në zbatimin nga SAI-t e të tetë shtyllave të pavarësisë së tyre, të përcaktuara në parimet e Deklaratës së Meksikos. Ai theksoi se nga një pyetësor i zhvilluar nga INTOSAI dhe IDI, Instituti për Zhvillim i INTOSAI-t, rreth 50 përqind e SAI-ve të intervistuara kanë deklaruar probleme me pavarësinë e tyre.

Kryetari i KLSH-së, z. Leskaj paraqiti sfidat e institucionit të auditimit suprem në Shqipëri për forcimin e pavarësisë institucionale dhe kushtetuese. Ai theksoi miratimin e ligjit organik të KLSH në vitin 2014, si një hap konkret dhe përcaktues ne drejtim të një pavarësie

të plotë dhe reale të institucionit. Zoti Leskaj solli përvojën pozitive të KLSH në bashkëpunimin me palët e interesit si në vend, ashtu dhe me partnerët ndërkombëtarë, në mbrojtjen e pavarësisë institucionale dhe funksionale të institucionit, gjatë procesit të miratimit te ligjit të ri organik të KLSH. Ai nënvizoi se pa mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë si Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit e Komisionit Evropian DG-Budget, SIGMA, program i BE dhe OECD, ligji i ri tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-t, nuk do të ishte e mundur të miratohej.

Kryetari i KLSH theksoi partneritetin e institucionit të auditimit suprem në vend me Parlamentin dhe sidomos me Komisionin e Kuvendit për Ekonominë dhe Financat, me Kryetarin dhe Sekretarin e tij, si tepër të rëndësishëm dhe vital.

Anëtari i Gjykatës Europiane të Audituesve, z. Rimantas Sadziu e cilësoi prezantimin dhe rastin e KLSH si një shembull dhe eksperiencë me vlerë për SAI-t që duan të forcojnë pavarësinë e tyre institucionale. Kumtesa u vlerësua si një *"case study"* nga diskutuesit.

Në Panelin e Dytë me temë *"Në rruge e auditimeve të udhëhequra nga vlera për qytetaret",* Presidenti i SAI-t te Cekisë, z. Miloslav Kala solli eksperiencat dhe arritjet e institucionit të tij, por edhe bashkëpunimet e frytshme në auditimet e përbashkëta dhe paralele. SAI i Serbisë solli sfidat e ndryshimit të qasjes së auditimeve nga ato tradicionale në auditimet e orientuara nga qytetari.

Në forumin e diskutimeve *"SAI: të qenit një organizate model për qeverisjen e mirë",* Audituesit e Përgjithshëm dhe Presidentët e SAI-ve të Finlandës, Kosovës, Sllovenisë dhe Turqisë sollën vizionin e tyre dhe përpjekjet e institucioneve që drejtojnë për të dhënë shembullin e integritetit dhe profesionalizmit në punën audituese.

Paneli i Tretë me temë *"Modernizimi i Kapaciteteve administrative të SAI-ve"* solli diskutimin e z.Krzysztof Kwiatkovski, President i NIK, me ide të reja në drejtim të rritjes së përvojës qeverisëse të SAI-ve dhe përmirësimit të përdorimit me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të burimeve njerëzore dhe financiare që ato kanë në dispozicion.

Në panelin e Katërt me temë *"Komunikimi me Palët e interesit dhe rritja e besimit të qytetarëve"* u paraqitën prezantime dhe diskutime me vlerë për të gjithë të pranishmit, në drejtim të zbatimit të strategjive të reja

në komunikimin me partnerët dhe aleatët e natyrshëm të SAI-ve, si dhe në fitimin e besimit të qytetarit për përfitimet nga shërbimet e tyre.

Kryetari i KLSH-së, z. Leskaj u takua në Sofje me Presidentin e Gjykatës Rumune te Llogarive, z.Mihai BUSUIOC, me të cilin ra dakord të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy SAI-ve në muajt e ardhshëm në Bukuresht. SAI rumun është një SAI i madh dhe me eksperiencë në auditim dhe ky bashkëpunim do t'i vlejë KLSH për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira të punës.

Gjatë dy ditëve të qendrimit në Sofje, Kryetari i KLSH zhvilloi takime pune me Presidentin e BNAO-s, z. Tzvetan Tzvetkov dhe me anëtarë të Gjykatës së BNAO-s, me anëtarë të Gjykatës Evropiane të Audituesve, me Presidentin e Zyrës Kombëtare të Auditimit Shtetëror të Polonisë(NIK), z. Krzysztof Kwiatkovski, me Presidentin e SAI-t të Sllovakisë, z. Karol Mitrik, me Presidentin e SAI-t të Çekisë, z. Miloslav Kala, me Audituesin e Përgjithshëm të Kosovës z. Besnik Osmani, me Zv/Audituesin e Pergjithshëm të Maqedonisë z. Naser Ademi, me Presidentin e Senatit të Dhomës Shtetërore të Auditimit të Malit të Zi, z. Milan Dabovic dhe me Audituesin e Përgjithshëm të SAI-t të Serbisë, z. Dusko Pejovic, si dhe Drejtorin e Përgjithshëm të ACA-s, z. Wolfgang Wiklicky. Në këto takime u diskutua për ecurinë e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe rritjen e partneritetit përmes shkëmbimeve të experiencës së përbashkët, sipas motos së INTOSAI-t *"Experentia mutual Omnibus prodest (Nga eksperienca e përbashkët fitojnë të gjithë)".*

Vlerësimet dhe rekomandimet e KE në Progres Raportin 2018

Në kapitullin 32 "Kontrolli financiar", në faqet 93 dhe 95 të Progres Raportit 2018 për Shqipërinë, i cili u publikua në prill të vitit 2018, Komisioni Evropian ka vlerësuar performancën e KLSH, si më poshtë:

Auditimi i Jashtëm. Pavarësia funksionale, operacionale dhe financiare e Institucionit Shtetëror të Auditimit është garantuar në Kushtetutë dhe në kornizën ligjore, në përputhje me standartet e INTOSAI-t. Implementimi më i plotë i bazës ligjore duhet të garantohet edhe më tej.

Përsa i përket **kapacitetit institucional**, zhvillimi profesional i audituesve ka qenë prioritar në vitet e fundit, duke kryer mesatarisht 25 ditë trajnimi/për auditues çdo vit. SAI ka miratuar planin

e auditimit për vitin 2018 duke përdorur një metodologji vlerësimi bazuar në risk. Plani i ri i zhvillimit strategjik për 2018-2022 është miratuar në dhjetor të 2017-ës. Strategjia mbi komunikimin për periudhën 2017-2019 është aprovuar në korrik 2017.

Sa i përket cilësisë së punës audituese, aktivitetet audituese ende nuk përputhen me Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI). Fokusi është në auditimet e përputhshmërisë për të përcaktuar dëmin ekonomik dhe shkeljen e rregullave, më tepër se sa në auditimet që mund të ndihmojnë në parandalimin e dëmeve të tilla. Përqëndrimi në realizimin e një numri të madh vjetor auditimesh ndikon negativisht në cilësinë e punës audituese dhe rekomandimeve.

Auditimet financiare nuk rezultojnë ende me opinione profesionale të auditimit. Manualet e reja për auditimet e përputhshmërisë dhe financiare janë pilotuar për herë të parë në 2016-ën. Auditimet e para të IT janë zhvilluar në 2016-ën dhe 2017-ën. Duke nisur që nga dhjetori i 2016-ës një Kod Etike udhëheq veprimtarinë audituese. Në 2017, SAI ndërmori hapa drejt përmirësimit të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë dhe për të qenë në të njëjtën linjë me ISSAI-t. Në maj të 2017-ës SAI dhe CHU (Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm) firmosën një Memorandum Mirëkuptimi të ri, për të koordinuar dhe monitoruar më mirë ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve.

Impakti i **punës audituese** është i limituar. Në 2017, 52% e rekomandimeve të SAI për përmirësime legjislative dhe organizative janë pranuar nga të audituarit dhe 68% e tyre janë duke u implementuar. Raportet e auditimit janë përmbledhur dhe publikuar rregullisht në faqen zyrtare të internetit të SAI. Raporti vjetor i SAI-t për 2016 i është paraqitur parlamentit dhe i është prezantuar Komisionit të Ekonomisë dhe Financës në tetor të 2017-ës.

Në vitin e ardhshëm duhet që Shqipëria:

.....të miratojë një qasje të auditimit të jashtëm bazuar në risk, mbështetur në të cilën do të planifikojë se si do të reduktohen gradualisht auditimet e përputhshmërisë dhe do të rriten auditimet e performancës dhe ato financiare;

Shënim: Progres raportin e plotë në gjuhen angleze e gjeni në linkun:https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf

Dëgjesa e auditimit të performancës "Kostimi i Shërbimit Spitalor" në Komisionin Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

I nderuar z. Kryetar i Komisionit!

Të nderuar Anëtarë!

Më së pari ju falenderojmë në emër të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Departamentit të Auditimit të Performancës në KLSH për interesin Tuaj ndaj punës audituese mbi Kostimin e Shërbimit Spitalor në vendin tonë. Kjo dëgjesë vjen në një moment kritik për punën e departamentit të performancës, si një departament i ri brenda KLSH-së, me një moshë vetëm 6-vjeçare dhe i mandatuar nga Kuvendi për kryerjen e auditimeve të tilla, shumë të përhapura në botën e zhvilluar, vetëm 4 vjet më parë me Ligjin e Ri Institucional 154/2014. Në strategjinë e zhvillimit institucional 2013-2017, aktiviteti i këtij departamenti u konceptua si vital për zhvillimin dhe modernizimin e KLSH-së dhe testi i vërtetë i punës sonë është impakti tek qytetarët, Kuvendi, Qeveria dhe palët e tjera të interesit.

(Informacion më të plotë mbi këtë çështje mund të gjeni në web-in e parlamentit:https://www.parlament.al/komisioni-per-punen-ceshtjet-sociale-dhe-shendetesine-zhvilloi-seancen-degjimore-per-shqyrtimin-e-raportit-te-auditimit-te-klsh-se).

KLSH merr pjesë në trajnimin mbi komunikimin në CEF, Lubjanë

Në datat 22-24 maj 2018, në Qendrën për Ekselencë në Financë, në Lubjanë të Sllovenisë, u mbajt trajnimi "Përmirësimi i aftësive të komunikimit të folur dhe të shkruar". Në këtë trajnim morën pjesë specialistë dhe drejtues të departamenteve të komunikimit me mediat, publikun dhe marrëdhënieve me jashtë të institucioneve financiare të rajonit. Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë aktivitet nga z. Brenton Kotorri, Specialist në Drejtorinë e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Gjatë ditës së parë të trajnimit, Znj. Mary Gregg, eksperte e komunikimit institucional nga Administrata Tatimore e Irlandës, parashtroi për pjesëmarrësit, disa nga teknikat e të shkruarit institucional, të cilat nëse aplikohen përmirësojnë komunikimin efektiv. Dita e dytë e trajnimit u fokusua tek menaxhimi i deklaratave për shtyp dhe situatave të krizave. Z. David Curtin, ekspert nga "Carr Communications" – Irlandë, trajnoi pjesëmarrësit me simulime të situatave konkrete të cilat duhen menaxhuar në përditshmërinë e punës me mediat dhe publikun.

Trajnimi u realizua më së shumti përmes interaktivitetit dhe detyrave praktike. Në ditën e tretë të trajnimit, z. Brenton Kotorri u ftua përkrah trajnuesve për të ndarë me pjesëmarrësit për rreth një orë disa këshilla praktike mbi

komunikimin politik, gjuhën e trupit dhe menaxhimin e imazhit në studio televizive.

Pjesëmarrja e KLSH në trajnimet cilësore të CEF ka qenë e suksesshme në vazhdimësi, dhe pritet që audituesit e KLSH të vijojnë të përfaqësojnë denjësisht institucionin në këto aktivitete.

KLSH kremton 93 vjetorin e krijimit

Në datën 28 maj 2018, në ambientet e Kontrolli të Lartë të Shtetit u zhvillua ceremonia e kremtimit të 93 vjetorit të krijimit të institucionit. Në këtë ceremoni ishin të ftuar të merrnin pjesë ish drejtues të institucionit në vite dhe ish punonjës të dalë tashmë në pension si dhe stafi i KLSH.

Të mbledhur në ambientet e Muzeut të institucionit, i cili ka marrë emrin "Këshilli Kontrollues 1925-1939", Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj mbajti një fjalë përshëndetëse për të pranishmit.

Në fjalën e tij zoti Leskaj theksoi se kujtesa historike është një nga përbërësit më të fuqishëm në krijimin e identitetit të qëndrueshëm jo vetëm të një kombi, por edhe të një institucioni kryesor shtetëror. Vlerësimi i historikut të çdo institucioni ndërgjegjëson punonjësit e tij për vlerat e institucionit të shtrira në vite dhe të vyera për rolin kushtetues që ai ka, por edhe për përgjegjësinë që çdo auditues mbart kur përfaqëson institucionin me punën, sjelljen dhe rezultatet e tij.

Së dyti, si copëz historie, historiku jo vetëm shfaqet mjaft i dobishëm për cilindo qytetar që kërkon të njohë evoluimin në vite të institucioneve tona, por edhe për ata që duan të kontribuojnë në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të këtyre institucioneve. Kujtesa historike i shërben po ashtu pasurimit të dijeve të brezit të ri dhe kontribuon në pasurimin e asaj kulture ligjore dhe institucionale që duhet të kenë së pari vendim-marrësit publikë, por edhe çdo qytetar shqiptar i përgjegjshëm, i interesuar për shtetin dhe mënyrën e funksionimit të tij.

Formësimi i kulturës së institucioneve tona shtetërore me vlerat dhe përgjegjësitë e tyre përbën një prej objektivave të rëndësishëm të projektit të evropianizimit të administratës shqiptare, të forcimit të shtetit ligjor dhe punës për një qeverisje të mirë.

Me vlerësimin maksimal qytetar, stafi i sotëm i KLSH-vijoi z.Leskaj- përkulet përpara figurave dhe personaliteteve që kanë drejtuar këtë institucion, veçanë-risht në vitet 1925-1944, si Kol Thaçi, Lac Gera, Llambi Aleksi, Lame Kareco,

Eqerem Libohova, Xhafer Ypi, Rrok Gera, Fejzi Alizoti, Izedin Beshiri dhe të tjerë më tej.

Vlerësojmë po ashtu punën reformuese të kryer nga Dr. Blerim Çela, ish-Kryetar i KLSH në vitet 1992-1997 dhe Mustafa Kërçuku ish-Kryetar në vitet 1997-2004, si dhe kontributin e ish-kryetarëve Zydi Pepa, Ylli Memisha, Alfred Karamuço e Robert Çeku, ish-kryetar deri në vitin 2011.

Si institucion i pavarur, nëpërmjet këtij aktiviteti për 93 vjetorin e krijimit të KLSH-së dëshirojmë të vijojmë traditën e mirë të vlerësimit institucional të veprimtarisë, duke kontribuar në kulturën e vlerave dhe të përgjegjësisë publike në vend, për t'ia kundërvënë "kulturës" së harresës.

Në mbyllje të fjalës së tij, z.Leskaj iu referua Presidentit te SAI-t Polak, z.Kwiatowski, i cili referuar historikut të NIK është shprehur se audituesit e sotëm kanë përgjegjësinë e punës së brezave paraardhës që do të thotë se me dije, profesionalizëm dhe integritet duhet që punën e tyre ta respektojnë, vlerësojnë dhe ta ngrenë në një shkallë më të lartë.

Më pas audituesit e KLSH-së u danë në tre salla të ndryshme sipas strukturave në të cilat bëjnë pjesë dhe shkëmbyen përvojat dhe eksperiencat e tyren në funksion edhe të periudhës gjatë së cilës kanë punuar në KLSH. Me interes nga audituesit u ndoqën diskutimet dhe përvojat e z.Qemal Shehu, z.Niko Nako, zj.Lindita Lati, Zj. Manjola Naco, zj.Luljeta Nano, z.Bexhet Zeqiri, z.Kozma Kondakciu, etj.

Aktiviteti u mbyll me biseda miqësore mes audituesve të brezave të ndryshëm.

Aktivitet i përbashkët KLSH-SIGMA "Zhvillimi i Marrëdhënieve Efektive të punës ndërmjet KLSH dhe Parlamentit"

Në datën 4 qershor 2018, në Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe SIGMA–një nismë e OSCE, e financuar kryesisht nga Bashkimi Evropian, organizuan takimin sensibilizues *"Zhvillimi i Marrëdhënieve Efektive të punës ndërmjet KLSH dhe Parlamentit",* si dhe prezantimin për palët e interesit të Strategjisë për Zhvillim të Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën 2018 -2022.

Qëllimi i takimit ishte ndërgjegjësimi i palëve të interesit mbi rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, për krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve efektive me Kuvendin, shoqërinë civile dhe grupet e interesit, me qëllim rritjen e impaktit të punës audituese dhe mbështetjen e misionit të KLSH-së, si institucion *"watchdog"* në shërbim të qytetarit shqiptar dhe Kuvendit, për të përmbushur në vijimësi rolin e vet kushtetues dhe për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie në përdorimin e fondeve publike.

I organizuar mbi bazën e Dokumentit të SIGMA-s Nr. 54 *"Zhvillimi i Marrëdhënieve efektive të punës ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve",* ky takim prezantoi eksperiencat e mira evropiane në ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit mes institucioneve të larta të auditimit dhe parlamenteve, për t'i ndihmuar parlamentet në mbajtjen e qeverive përgjegjëse për shpenzimin me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë të parasë publike dhe për t'i ndihmuar institucionet e larta të auditimit të kenë më shumë ndikim në jetën e qytetarit, me punën e tyre audituese.

Takimi mblodhi së bashku rreth 60 përfaqësues të institucioneve të pavarura, të organizatave të shoqërisë civile, profesoratit dhe gazetarë, për të diskutuar mbi një nga elementët kyç në forcimin e llogaridhënies, marrëdhëniet SAI-Parlament. Në takim morën pjesë Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruci, Sekretari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Akademik Anastas Angjeli, deputeti Florion Mima, Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrisë, z. Engjëll Agaçi, Këshilltari i Lartë i SIGMA, z.Alastair Swarbrick, përfaqë-suesi i Delegacionit të BE-së në Tiranë, z.Stephen Stork, etj.

Zoti Gramoz Ruçi, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, vlerësoi në fjalën e tij faktin që Kuvendi dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit kanë bashkëpunuar si partnerë. Komisionet parlamentare dhe deputetët i kanë shfrytëzuar dhe janë mbështetur në indiciet nga auditimet e KLSH në ushtrimin e detyrave të tyre funksionale për kontrollin parlamentar, si edhe në angazhimin për të qenë konkret e aktiv në luftën kundër korrupsionit, abuzimeve dhe defekteve të tjera të qeverisjes. Kuvendi po punon paralelisht për fuqizimin e rolit të tij ligjbërës e kontrollues theksoi-z.Ruçi- dhe për të dyja funksionet, një shërbim të madh praktik japin edhe rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Fuqizimi i të dy funksioneve të Kuvendit do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e punës së ekzekutivit, nëpërmjet llogaridhënies e transparencës, si dy parime themelore të mirëqeverisjes. Kjo do të garantojë që fondet publike të shkojnë në përfitim të publikut e qytetarit, duke garantuar shërbime publike efektive, cilësore dhe të përballueshme për të gjithë.

Në zbatim të detyrimeve kushtetuese dhe rekomandimeve të Progres-raportit të Komisionit Europian, në vitin 2017 Kuvendi, me një vendim të veçantë, krijoi mekanizmin ndërinstitucional Kuvend-Qeveri-Institucione të Pavarura, si një instrument efikas për monitorimin sistematik të ndjekjes e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura ndaj ekzekutivit. Praktikat e deritanishme të drejtuara kryesisht në dy raportimet vjetore të KLSH-vijoi z.Ruçi-do të plotësohen nga instrumente të tjerë të kontrollit parlamentar, të tilla si dëgjesat, seancat e pyetjeve në komisionin përgjegjës të ekonomisë e financave dhe komisione të tjera, si edhe ngritja e komisioneve të posaçme hetimore. Pra, rekomandimet e Kontrollit të Shtetit do të kalojnë përmes një procesi diskutimesh e debatesh midis Kuvendit, ju si institucion rekomandues dhe institucioneve të tjera e grupeve të interesit. Kjo do të mbështetet dhe për nismat ligjvënëse të propozuara nga KLSH, të cilat do të finalizohen nëpërmjet një konsultimi të gjerë publik. Kjo do të mundësojë që gjetjet e auditimeve dhe rekomandimet e auditimit të kalojnë nëpërmjet një procesi të gjerë shqyrtimi, sensibilizimi e llogaridhënieje. Në këtë mënyrë, rekomandimet apo propozimet për penalizime ndaj shkeljeve e shkelësve të ligjit nuk do ta kenë të lehtë të fshihen apo zvarriten pas teknikaliteteve e justifikimeve të burokratëve përgjegjës.

Në fund të fjalës së tij, zoti Ruçi theksoi: *"Kuvendi po mbështetet gjithnjë e më shumë në indiciet dhe gjetjet e institucionit suprem te auditimit ne vend. Rezoluta e Kuvendit e tetorit 2016 për Kontrollin e Larte të Shtetit ka rritur pritshmëritë e Kuvendit qe auditimet tuaja të dalin më analitike dhe cilësore. Ju jeni gardiane te ligjshmërisë, ndershmërisë dhe efiçiencës se aktivitetit qeveritar. Do të marr masa qe brenda këtij sesioni legjislativ te mundësojmë krijimin e nënkomisionit te posaçëm për shqyrtimin e raporteve te auditimit te KLSH-së".*

Më pas e mori fjalën, Kryetari i KLSH-së, z.Leskaj, i cili theksoi se si audites të jashtëm publikë, jemi të bindur se ekziston një marrëdhënie simbiotike (e domosdoshme, jetike) mes Parlamentit dhe institucionit më të lartë të auditimit të jashtëm publik (SAI-t). Parlamenti dhe SAI kanë role reciprokisht mbështetëse për të siguruar një qeverisje efektive. Marrëdhëniet mes Parlamenteve dhe SAI-ve janë forcuar dhe rritur gjatë dy-tre dekadave të fundit gati në të gjitha vendet e botës, përfshi dhe Shqipërinë, sidomos pas shpërthimit të krizës së përbotshme financiare dhe ekonomike të vitit 2008, kur roli i SAI-ve në shëndoshjen e financave publike u rrit ndjeshëm.

Marrëdhëniet e Kontrollit të Lartë të Shtetit me Kuvendin e Shqipërisë, e sidomos me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, reflektojnë kërkesat e standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t për më shumë përgjegjësi në sistemin e llogaridhënies për përdorimin e fondeve publike, në veçanti të Deklaratës së Limës, e quajtur ndryshe *"Magna Carta",* Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 1, Neni 8 *"Marrëdhënia me Parlamentin",* i cili thekson se: *"Institucioni Suprem i Auditimit duhet të fuqizohet dhe të mandatohet nga Kushtetuta për t'i raportuar gjetjet e tij në mënyrë të pavarur dhe çdo vit Parlamentit".*

Në filozofinë tonë të punës si institucion *"watchdog"* i qytetarit dhe Kuvendit, zgjodhëm qasjen e promovimit të trekëndëshit të llogaridhënies "Parlamenti (qytetarët)" - KLSH - Qeveri", në dobi të forcimit të llogaridhënies dhe transparencës së qeverisjes. Për këtë, synuam dhe kërkuam komunikim më të shpeshtë me Parlamentin, duke respektuar rregullin bazë që si institucion suprem i auditimit, si SAI, ne nuk bëjmë politika, por auditojmë zbatimin e tyre.

Si KLSH, jemi përpjekur të konturojmë raportin me Kuvendin, në shinat e forcimit të llogaridhënies dhe transparencës. Në këtë konturim, na kanë ndihmuar gjetjet, përsiatjet me eksperiencat e SAI-ve të zhvilluara evropiane dhe konkluzionet e Raporteve të SIGMA-s nr. 33 dhe Nr. 54, sidomos të këtij të fundit. Zoti Leskaj cilësoi kontributin e rëndësishëm që ka dhënë

Programi SIGMA i Bashkimit Evropian dhe i OECD-së (Mbështetja për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim) prej tashmë 26 vitesh në përmirësimin e qeverisjes publike në vendet kandidate dhe potenciale kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Në vitin 2016, Kuvendi miratoi Rezolutën e datës 20 tetor 2016, *"Mbi perfomancën e Kontrollit të Lartë i Shtetit të vitit 2015",* ku theksohet që *"Kuvendi i Shqipërisë, në funksion të detyrimeve të tij kushtetuese, por dhe në zbatim të rekomandimeve të Progres Raportit 2015 te Komisionit Evropian për ngritjen e një mekanizmi më efiçient nga Kuvendi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, shpreh angazhimin e tij maksimal në këtë drejtim, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe ushtrimin e kontrollit parlamentar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, sa më poshtë:*

- *Të bashkëpunojë me KLSH-në dhe Qeverinë, që të rritet shkalla e ndërveprimit gjithëpërfshirës me të gjitha institucionet e administratës publike për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së;*
- *Të shikojë mundësinë e krijimit të Nën-komisionit Parlamentar brenda Komisionit për Ekonominë dhe Financat për të monitoruar në mënyrë sistematike aktivitetin e KLSH-së dhe zbatimin e rekomandimeve".*

Menjëherë kemi dhënë dakortësinë tonë për krijimin e nën-komisionit të dedikuar parlamentar. Për të gjitha detyrat e lëna nga rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë, ato të viteve 2012, 2014 dhe 2016, si SAI kemi hartuar plane konkrete pune për zbatimin e tyre. Zoti Leskaj propozoi nënshkrimin e një marrëveshje kuadër bashkëpunimi mes KLSH-së dhe Kuvendit të Shqipërisë, për të cilën z.Ruçi shprehu dakortësinë që ajo të nënshkruhet brenda këtij viti.

Zoti Leskaj përfundoi, "*...Na pret përpara një sfidë e madhe. Me Vendimin e Kryetarit Nr. 56, datë 30 prill 2018, KLSH miratoi Kodin e Etikës të Kryetarit, i cili njeh dhe pranon pa asnjë kushtëzim Kodin e Etikës së Deputetit të Kuvendit. Ky standard hap rrugën, në kushtet e mungesës totale të konfliktit të interesit për 6 muajt e ardhshëm në përfundim të mandatit të kryetarit aktual, për një marrëveshje të gjerë kuadër KLSH-Kuvend, të cilën me këtë rast ia propozoj Kryetarit të Kuvendit".*

Në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022, Pika 4 *"Partnerët strategjikë"*, theksohet se *"Cilësia dhe besueshmëria e raporteve të auditimeve të KLSH po tërheq gjithnjë e më shumë vëmendjen e parlamentarëve, duke rritur mundësinë e funksionimit të mekanizmave të "Trekëndëshit të Llogaridhënies" (SAI-Parlament-Qeveri), pasi gjetjet dhe rekomandimet e auditimit orientohen pikërisht drejt identifikimit dhe zgjidhjes*

së problematikave të qeverisjes publike, duke kontribuar për mirëqeverisjen".

Aktivitetin e përshëndeti edhe z. Stephen Stork, përfaqësues i Delegacionit të BE-së në Tiranë, i cili vlerësoi rolin e KLSH-së si gardian i parasë publike dhe gjithashtu duke u nisur nga Progres Raporti i fundit i KE për Shqipërinë veçoi progresin e bërë nga KLSH, veçanërisht në përmirësimin e cilësisë së raporteve të auditimit dhe të rritjes së transparencës së veprimtarisë audituese.

Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, akademik Anastas Angjeli, në cilësinë e Sekretarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, vlerësoi punën e viteve të fundit të KLSH-së, veçanërisht rritjen e nivelit profesional të audituesve dhe trajnimet e zhvilluara.

Alastair Swarbrick, Këshilltar i Lartë për Politikat në SIGMA, vijoi duke theksuar se element kyç për të siguruar llogaridhënien dhe transparencën është rritja e angazhimit më të madh të palëve të interesuara, veçanërisht me parlamentet. Në këtë koncept, SIGMA analizoi marrëdhëniet e SAI-ve me parlamentet në BE dhe në vendet e zgjerimit dhe prezantoi Dokumentin Nr. 54 të SIGMA-s. Qëllimi i këtij Dokumenti është ofrimi i udhëzimeve për forcimin e marrëdhënieve të punës mes SAI-ve dhe Parlamenteve, identifikimi i faktorëve kyçë që mbështesin marrëdhëniet efektive, identifikimi i shembujve të praktikave të mira, etj.

Z. Swarbrick falënderoi në mënyrë të veçantë Kryetarin e KLSH, z. Bujar Leskaj për arritjet e institucionit gjatë këtyre viteve të fundit, në drejtim të rritjes së cilësisë së punës në auditim, transparencës dhe hapjes së institucionit. Zoti Swarbrick falënderoi z.Leskaj, gjithashtu për bashkëpunimin në realizimin e këtij takimi dhe frymën e krijuar, duke bërë së bashku përfaqësues nga të gjitha palët e interesit si nga Kuvendi ashtu dhe nga shoqëria civile, media, etj.

Çështja e dytë e aktivitetit u fokusua në prezantimin e Strategjisë së KLSH për pesë vitet e ardhshme 2018–2022. Zoti Joop Vrolijk, ekspert nga SIGMA, ofroi një pamje të përgjithshme të vlerësimit dhe opinionit që SIGMA ka dhënë lidhur me këtë strategji zhvillimi.

Si një nga arritjet më të mëdha të KLSH z. Vrolijk theksoi se si politika e ndjekur

nga Kryetari z. Leskaj ka ndikuar në *"profesionalizimin e institicionit".*

Në mënyrë të veçantë, z. Vrolijk theksoi progresin e bërë nga institucioni duke

nënvizuar "gjashtë vite më parë Kryetari i KLSH kërkoi asistencën e SIGMA-s për të hartuar Planin e Zhvillimit të KLSH 2013 – 2017, ndërsa strategjinë e re të KLSH-së 2018-2022, institucioni e ka përgatitur vetë dhe SIGMA ka dhënë opinion mbi Strategjinë e Zhvillimit. Pra, ky është rasti kur mbështetja e ekspertizës teknike nga jashtë tregon se krahas zhvillimit janë rritur dhe aftësuar kapacitetet njerëzore të institucionit : "... Gjatë kësaj kohe KLSH ka ndryshuar nga një institucion që shikon vetëm nga brenda me një qasje tradicionale të auditimit të përputhshmërisë në një institucion largpamës me lloje të reja të auditimit, auditimin e performancës dhe auditimin financiar, në pajtueshmëri me ISSAI-t".

Në këtë aktivitet krahas audituesve të KLSH-së morën pjesë përfaqësues të Delegacionit të BE-së në Tiranë, USAID-t, përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë civile dhe të profesionistëve të fushës dhe gazetarë, nga të cilët mund të përmendim: Zj.Darcie Nielsen (drejtore e projektit të USAID-t), zj.Sybille Schmidt (delegacioni i BE-së ne Tiranë), Prof. Dr. Jorgji Bollano, Prof. Dr. Sazan Guri, z. Sotiraq Hroni, z.Engjëll Musai, z.Artur Çani, z.Sami Neza, z.Fatos Hodo, zj.Ornela Liperi, etj.

KLSH merr pjesë në seminarin e zhvilluar mbi "Auditimet në prokurimin publik 2018"

Në datat 31 Maj dhe 1 Qershor 2018, u zhvillua në Athinë, Seminari mbi Auditimin e Prokurimeve Publike, i cili ishte organizuar nga Gjykata Greke e Auditimit, si një aktivitet lidhur me përditësimin e dokumenteve të Auditimit të Prokurimit Publik, të përgatitura nga Komiteti i Kontaktit i Institucioneve Supreme të Auditimit të Bashkimit Evropian.

Gjatë punimeve të dy ditëve, u paraqitën 18 prezantime nga eksperienca në auditimet e prokurimeve publike të SAI-ve të ndryshëm si dhe u realizuan workshope në grupe të ndryshme. Në këtë event, KLSH u përfaqësua nga z. Vullnet Karafilaj Kryeauditues, znj. Mariola Llanaj Kryeauditues dhe znj. Miranda Haxhia Auditues i Lartë.

Komiteti i Kontaktit i Institucioneve Supreme të Auditimit të Bashkimit Evropian krijoi, në vitin 2004, një Grup Pune për Prokurim Publik, me iniciativën e SAI të Irlandës. Ky grup prodhoi katër dokumente që synonin të ndihmonin audituesit në auditimet lidhur me prokurimin publik, të cilat u përditësuan dhe u zhvilluan më tej nga një grup pune i ardhshëm i bashkë kryesuar nga SAI i Belgjikës dhe Sllovenisë:

1. Udhëzues për Audituesit, bazuar në Direktivën 2004/18 / EC të Prokurimit të Sektorit Publik të Bashkimit Evropian (BE), duke përfshirë përmbledhjet e vendimeve më të rëndësishme të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (NJBGJ) 2. Modeli i Performancës së Prokurimit, duke

përfshirë pyetjet kyçe të zhvilluara si referenca referuese për audituesit që vlerësojnë performancën e funksionit të prokurimit në organet e sektorit publik. 3. Një listë kontrolli për Auditimin Financiar dhe Pajtueshmërisë së Prokurimit Publik, që duhet të përdoret gjatë auditimit të proceseve të prokurimit publik. 4. Përmbledhje të raporteve të auditimit të publikuara nga Institucionet Supreme të Auditimit të BE-së (SAI).

Seminari i Auditimit të Prokurimit Publik 2018 i mbajtur në Athinë, si objektiv kryesor të tij kishte që SAI-t dhe audituesit e tyre të jenë të vetëdijshëm për dokumentet e përditësuara dhe për të promovuar përdorimin efektiv të këtyre dokumenteve në auditimet e SAI-t.

Seminari u mbajt për të përmbushur objektivat e mëposhtme:

a) Diskutimi mbi ndryshimet kryesore të paraqitura nga Direktivat 2014 të Prokurimit Publik të BE-së;

b) Njohja e SAI-ve dhe audituesve me dokumentet e përditësuara të Komitetit të Kontaktit të BE-së mbi Auditimin e Prokurimit Publik;

c) Sigurimi i vlerësimit përfundimtar dhe kontributit për shqyrtimin e këtyre dokumenteve;

d) Nxitja e përdorimit efektiv të këtyre dokumenteve në auditimet e SAI-ve;

e) Shpërndarja e rezultateve të përditësuara të auditimit në fushën e auditimit të prokurimeve publike.

Ky event u hap me fjalën përshëndetëse të Presidentit të Gjykatës së Llogarive Greke znj. Androniki Theotokatou, si dhe nga z. Vítor Caldeira, President i Gjykatës së Llogarive të Portugalisë dhe z. Dimitrios Avlonitis, Sekretari i Përgjithshëm i Tregtisë i Qeverisë së Republikës Greke, të cilët krahas fjalëve mikpritëse, theksuan se objektivi kryesor i këtij seminari ishte që SAI-t dhe audituesit e tyre të jenë të vetëdijshëm për dokumentet e përditësuara dhe të promovojnë përdorimin efektiv të këtyre dokumenteve në auditimet e tyre.

Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj zhvillon një takim me deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Në datën 7 qershor 2018, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj zhvilloi në ambientet e Kontrolli të Lartë të Shtetit një takim me deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z.Nait Hasani, Deputet i GP të Partisë Demokratike të Kosovës, z.Muharrem Nitaj Deputet i GP

të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zj.Albulena Balaj - Halimaj Deputete e GP të NISMA Socialdemokrate, z.Dardan Molliqaj, Deputet i GP të Partisë Socialdemokrate, z.Naim Jakaj, Këshilltar i Nënkryetares së Kuvendit dhe z.Kreshnik Gashi, Kryetar i Bordit të ARKEP-it, Kosovë. Në takim ishte i pranishëm edhe Ambasador i Republikës se Kosovës ne Republikën e Shqipërisë, SH.T.Z. Syle Ukshini.

Deputetët nga Kosova u njohën nga Kryetari i KLSH-së me mënyrën e funksionimit të institucionit që bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së" që është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në nëntor të vitit 2014. Ky ligj është në përputhje të plotë me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Gjatë këtyre viteve KLSH është modernizuar dhe është fokusuar drejt auditimeve të Performancës dhe atyre financiare, stafi i KLSH-së është rritur shumë profesionalisht dhe kjo falë edhe shkëmbimit të eksperiencave me Institucionet Homologe Europiane të Auditimit me të cilat KLSH ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi (deri tani 16 marrëveshje të tilla).

Zoti Leskaj theksoi dhe nënvizoi faktin që marrëveshja e parë e bashkëpunimit që ka nënshkruar është ajo me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës (ZKA) në vitin 2012 dhe me këtë zyrë ka bashkëpunimin më të mirë, falë traditës sonë, historisë dhe vullnetit të Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, z.Besnik Osmani.

Në qendër të bisedimeve ishte diskutimi i raportit të Auditimit të ushtruar nga KLSH, gjatë vitit 2017 lidhur me "Unifikimi i pikave doganore të Shqipërisë me Kosovën", auditim i cili është parë me shumë interes nga deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Ky auditim është ushtruar në subjektet: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe subjektet në varësi të saj: Dega e Doganës Kukës - Morinë dhe Dega e doganës Durrës, duke u shtrirë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, që kanë si detyrim aktet nënligjore për konkretizimin dhe zbatimin e masave të përcaktuara në marrëveshjet e përbashkëta qeveritare ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, etj., duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me efektivitetin e funksioneve menaxhuese, monitoruese dhe performancën e strukturave përgjegjëse të DPD dhe MF, etj.

Një ndihmesë të çmuar në realizimin e këtij auditimi ka dhënë bashkëpunimi, shkëmbimi i informacioneve dhe intervistat e zhvilluara në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, Ministrinë e Financave të Kosovës dhe Odën Ekonomike të Kosovës.

Në përfundim të auditimit, Kryetari i KLSH-së me Vendimin nr.202, datë 29/12/2017, ka adresuar 24 rekomandime të rëndësishme, si :

- Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të ndërmerren studime, bazuar tek feedback-et e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë e Industrisë të Shqipërisë dhe Odës Ekonomike të Kosovës, dhe të hartohet një Strategji Kombëtare e posaçme për bashkimin doganor me Kosovën, për ta veçuar Kosovën nga përgjithësimi i një bashkëpunimi me Europën Juglindore.
- Në grupet e përbashkëta të punës midis Shqipërisë dhe Kosovës, të parashikuara në marrëveshjet midis dy vendeve, të përfshihen edhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë e Industrisë të Shqipërisë dhe Oda Ekonomike e Kosovës, si organizata që përfaqësojnë bizneset e të dy vendeve.
- Me qellim të ndarjes së përgjegjësive, rregullimit dhe krijimit të funksionalitetit brenda zonës doganore në Portin e Durrësit për të dy administratat doganore Kosovë – Shqipëri, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të merren masa për hartimin e procedurave standarde të operimit në mënyrë që të qartësohet ku fillon dhe ku përfundon mbikë-qyrja doganore e mallrave nga autoritetet respektive, në mënyrë që mos të interferohet në detyrat dhe përgjegjësit e njëra tjetrës.
- Në konsultim me komunitetin e biznesit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masat e nevojshme për të finalizuar procesin e operimit të zyrës së doganës së Kosovës në Portin e Durrësit (brenda 6 mujorit të parë të vitit 2018).
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrin masa për hartimin e një studimi dhe zbatimin e tij mbi vendosjen e Portit të Shëngjinit në shërbim të Doganës së Kosovës (brenda 6 mujorit të parë të vitit 2018), etj..

Zoti Leskaj bëri një përshkrim të plotë të raportit të Auditimit dhe KLSH është e hapur që të vijojë më tej punën në këtë drejtim, duke bashkëpunuar me ZKA e Kosovës dhe veçanërisht do të shikojë mundësinë që brenda këtij viti të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe Ambasadori i Republikës së Kosovës në Tiranë e falënderuan z.Leskaj për realizimin e këtij auditimi të rëndësishëm.

Gjatë vizitës në KLSH, deputetët vlerësuan figurat dhe faktet simbolike dhe e cilësuan KLSH si një institucion të veçantë me flamujt e Shqipërisë dhe Kosovës, si edhe me simbole të personaliteteve të Kosovës.

KLSH merr pjesë në trajnimin e zhvilluar nga Gjykata Evropiane e Audituesve mbi "Teknikat dhe metodat e vlerësimit"

Në datat 11 dhe 12 Qershor 2018, u zhvillua në Luksemburg, në ambientet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, trajnimi i përqendruar tek metodat dhe mjetet e vlerësimit.

Në fokus të këtij trajnimi, qëndronte përditësimi i audituesve publikë lidhur me teknikat dhe metodat e përdorura nga Komisioni Evropian dhe institucionet publike vendimmarrëse për vlerësimin e projekteve të ndryshme, proces i cili kontribuon në mirëmenaxhimin e fondeve publike.

Trajnuesja, Znj. Gisele Hites, është konsulente pranë "Institutit Evropian të Administratës Publike" (European Institute of Public Administration) dhe pedagoge e metodave kërkimore në Universitetin e Lilës, Universitetin e Parisit dhe në disa universitete në Belgjikë. Në trajnim morën pjesë audites publikë nga Gjykata Evropiane e Audituesve (European Court of Auditors), Gjykata e Llogarive të Francës (Cour des Comptes) dhe dy audites nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Z. Qeram Cibaku dhe Znj. Eva Leka.

Trajnimi identifikoi 19 mjete sasiore dhe cilësore vlerësimi, të cilët janë mjete të përdorura masivisht jo vetëm nga Komisioni Evropian, por edhe nga institucionet publike vendimmarrëse në Bashkimin Evropian, ku disa prej tyre janë: Modelet logjike, analiza e rrjeteve sociale, analiza SWOT, teknika Metaplan, pyetësorët, anketimet, rastet studimore, anketimi Delphi, CBA, panelet e ekspertëve, grupet krahasimore, analiza e vendimit me shumë kritere (Multi-criteria decision analysis), etj.

Qëllimi i trajnimit dy ditor ishte që pjesëmarrësit nga gjykata të ndryshme evropiane dhe KLSH të familjarizoheshin me mjetet sasiore dhe cilësore, që janë të mundshme për të përmbushur nevoja të ndryshme brenda kontekstit të vlerësimit të një procesi vendimmarrës.

U trajtuan hollësisht të katër fazat e procesit të vlerësimit:

1. Strukturimi- Identifikimi i pyetjeve që duam të marrim përgjigje;
2. Mbledhja e të dhënave – grumbullimi i të dhënave primare dhe sekondare;
3. Analizimi i të dhënave – trajtimi i të dhënave për të gjeneruar përgjigjet e pyetjeve të ngritura në fazën e parë;
4. Formulimi i opinionit – konkludimi në gjykim objektiv, bazuar në rezultatet e të dhënave.

Secila nga këto 4 faza të procesit të vlerësimit, u trajtuan sipas objektivave specifike të secilës fazë dhe të mjeteve që janë të nevojshme për arritjen e këtyre objektivave.

Qasja e trajtimit të këtyre teknikave dhe mjeteve vlerësimi ishte një kombimin mes asaj teknike dhe konceptuale, duke përqendruar më shumë vëmendje tek metodat e reja të vlerësimit dhe tek ato teknika që janë më jetike në vlerësimin e projekteve me risk të lartë. Secila teknikë dhe metodë vlerësimi u prezantua duke përkufizuar mjetin, qëllimin përse shërben, hapat që duhet të ndiqen për një implementim sa më korrekt si nga ana e institucioneve publike vendimmarrëse ashtu edhe nga ana e institucioneve të larta audituese, avantazhet dhe anët e dobëta të secilës prej tyre dhe implementimi i këtyre mjeteve në raste reale.Përveç prezantimit të një game të gjerë mjetesh vlerësimi, (si sasiore ashtu edhe cilësore), ky trajnim ishte i frytshëm për të bërë të vetëdijshëm audituesit publikë, se mënyrat e vlerësimit të evidencave me të cilat punohet çdo ditë, mund të tejkalojnë ato tradicionale dhe të prezantojnë qasje të reja të cilat shtojnë vlerë në gjetjet e audituesve për të dhënë rekomandime sa më të sakta dhe sa më koherente me situatën në të cilën ndodhen institucionet publike, duke synuar performancën e tyre dhe jo vetëm përputhshmërinë ligjore të vendimeve që merr çdo ent publik.

KLSH merr pjesë në trajnimin e Qendrës së Ekselencës në Financë mbi auditimin e performancës

Datat 12-14 Qershor 2018 mblodhën në selinë e Qendrës së Ekselencës në Financë, në Lubjanë të Sllovenisë, audituesit e jashtëm dhe të brendshëm publikë të disa prej Institucioneve Supreme të Auditimit dhe njësive publike të ndryshme në Ballkan. Vendet pjesëmarrëse ishin Shqipëria, Sllovenia, Maqedonia, Mali i Zi, Kosova, Serbia, Bosnja & Hercegovina dhe Moldavia. Ndër radhët e KLSH-së, ishin të pranishëm audituesit e performancës znj. Redina Karapici, znj. Miranda Berdo dhe z. Dorel Balliu. Takimi i Lubjanës pasoi një fazë tjetër: atë online dyjavore, me anë të përzgjedhjes së audituesve, seminarëve të realizuar me video-konferencë mbi auditimin e performancës, përgatitjen e punimeve në grupe, si dhe përfundimin me sukses të saj. Zhvillimet e këtij trajnimi u fokusuan në të gjitha fazat nëpër të cilat

kalon auditimi i performancës: nga përzgjedhja e një teme për auditim, tek studimi i saj, kryerja, faza raportuese, sigurimi i cilësisë e deri tek strategjia e auditimit të performancës nga Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA), duke marrë shembuj auditimesh konkretë, zhvilluar nga homologët evropianë. Në këtë kuadër, politikat gjithëpërfshirëse të ECA-s dhe rishikimi i riskut bëjnë të mundur që kjo Gjykatë të përzgjedhë temat dhe çështjet që reflektojnë më së miri (i) risqet (ii) interesin publik dhe potencialin e Gjykatës për të kontribuuar në të dhe (iii) llogaridhënien e BE-së.

Z. Jussi Bright, audites në Njësinë Mbështetëse dhe të Metodogjisë Audituese në ECA, si dhe ekspert në auditimin e performancës, paraqiti një panoramë të përgjithshme të funksioneve audituese të Gjykatës Evropiane të Llogarive, organizimin e saj (të ndarë në Presidencë, Sekretariat i Përgjithshëm dhe 5 Dhomat e Auditimit), mandatin dhe llojet e auditimit. "Auditimet e performancës duhet të mirëpriten, jo të kihet frikë prej tyre. Ata rezultojnë gjithnjë në kursime parash", ishte lajtmotivi i gardianes së financave të Bashkimit Evropian rreth shqyrtimit të efektivitetit, efiçiensës dhe ekonomicitetit të përdorimit të parasë dhe pronës publike nga vendet anëtare. Z. Bright e krahasoi, gjithashtu, auditimin e performancës me shkollën dhe idealin platonian që mbartet në kryeveprën e tij "Etika" dhe kumtin që ai përcjell: I vërtetë, I mirë, I bukur.

E një rëndësie të veçantë është edhe Strategjia e re e 2018 mbi Ballkanin Perëndimor, nën presidencën bullgare, e cila në një nga 4 prioritetet e saj parashikon bashkëpunimin midis vendeve ballkanase përmes auditimeve paralele të performancës. Në këtë aspekt, lidershipi i KLSH-së, si në nivel të lartë drejtues, ashtu edhe departamental, si dhe kultura menaxheriale kanë bërë që këto auditime të rezultojnë të frytshme dhe dobiprurëse për palën shqiptare dhe qytetarët. Audituesi i ECA-s vlerësoi, kështu, projektin më të madh bashkëpunues midis Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe 6 SAI-ve të Ballkanit Perëndimor, i cili është auditimi paralel mbi prokurimin publik, kryer nga audituesit e Shqipërisë, Bosnje & Hercegovinës, Maqedonisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë.

Gjatë punimeve treditore në Qendrën e Ekselencës në Financë, audituesit pjesëmarrës u ndanë në grupe të ndryshme, duke hulumtuar mbi raste studimore dhe ku detyrat e tyre bazoheshin në vlerësimin e aftësive analitike gjatë përballjes me evidenca

konfliktuese në një auditim të caktuar. Audituesit e KLSH-së prezantuan zgjidhjet e mundshme, duke reflektuar idetë e tyre dhe eksperiencën e punës në institucionin suprem shqiptar të auditimit, si dhe duke udhëhequr grupet përkatëse të punës, përbërë nga kolegë të SAI-ve ballkanase. Audituesit e KLSH-së zhvilluan, ndër të tjera, takime miqësore edhe me kolegët e tjerë nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës, duke shkëmbyer eksperiencat dhe metodat e punës nën frymën e motos së INTOSAI-t "Experientia Mutua Omnibus Prodest".

KLSH nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit me Dhomën e Llogarive të Ukrainës

Në datën 15 qershor 2018, në Kiev të Ukrainës, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit z. Bujar Leskaj nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes Dhomës së Llogarive të Ukrainës dhe KLSH-së. Presidenti i Dhomës, z. Valeriy Pastkan tha se për të personalisht kjo ishte marrëveshja e dytë që nënshkruante me institucionet supreme të auditimit (SAI-t) simotra evropiane, pas marrjes së detyrës ne mars 2018 dhe u shpreh se *"momenti më i rëndësishëm vjen menjëherë pas nënshkrimit, kur palët duhet të përkthejnë në nisma konkrete vullnetin e tyre për punë të përbashkët".*

Kryetari Leskaj u shpreh se, bazuar në moton e INTOSAI-t *"Experentia mutua Omnibus prodest (Nga eksperienca e përbashkët fitojnë të gjithë)"* dhe në Nenin 15 *"Shkëmbimi ndërkombëtar i eksperiencave"* të Deklaratës së Limës, ISSAI 1, *"po nënshkruajmë këtë marrëveshje për tre arësye kryesore. Së pari, për shkak të lidhjeve historike mes popujve tanë, popullit shqiptar dhe atij ukrainas, pasi 300 vjet më parë ju mirëpritët në tokën tuaj mijëra familje shqiptare që erdhën për t'i shpëtuar sundimit ottoman dhe tani në jug të Ukranës jetojnë 5 mijë shqiptarë, duke ruajtur gjuhën dhe traditat e tyre mes mikpritjes ukrainase. Së dyti, nënshkruajmë bashkëpunimin në vlerësim të personalitetit të z. Valeriy Patskan, President i SAI-t ukrainas, një nga drejtuesit dhe frymëzuesit e manifestimeve dhe revoltës popullore të vitit 2014, që sollën një qeveri demokratike me orientim pro-perëndimor në Ukrainë. Së treti dhe më e rëndësishmja, pse besojmë se bashkëpunimi ynë mbi bazën e standardeve ISSAI, do të kontribuojë jo vetëm në zhvillimin dhe modernizimin e institucioneve tona, por edhe në progresin e të dyja vendeve në integrimin në Bashkimin Evropian".*

Në ceremoninë e nënshkrimit merrnin pjesë edhe pesë anëtarë të Bordit Kolegjial Drejtues të Dhomës së Llogarive të Ukrainës, të zgjedhur nga Parlamenti Ukrainas, z. Andrii Maisner, zv-President dhe anëtar i Bordit, z. Vasyl Nevidomyi, z. Tsezar Ohon, z. Oleksandr Yaramenko dhe z. Ihor Yaremchuk.

Presidenti Patskan, në prezantimin e tij, vlerësoi arritjet e SAI-t shqiptar, si dhe reformat e ndërmarra dhe rezultatet e Kryetarit Leskaj në punën audituese dhe në ngritjen e kapaciteteve të stafit. Ai e dalloi kontributin e KLSH si SAI anëtar aktiv në Grupin e Punës së EUROSAI-t *"Për Auditimin e fondeve të alokuara për katastrofat natyrore",* të cilin SAI i Ukrainës e kryeson. Z. Patskan tha: *"Për këtë arësye rashë menjëherë dakord me propozimin tuaj që Mbledhja e pestë Vjetore e Grupit të Punës së EUROSAI-t të bëhet në Shqipëri, pasi ju e meritoni me punën që keni bërë, që planet e ardhshme të këtij Grupi të rëndësishëm për EUROSAI-n, të diskutohen në Tiranë".*

Nga ana e tij, Kryetari i KLSH-se, pasi paraqiti profilin e KLSH dhe arritjet e institucionit shqiptar të auditimit të jashtëm publik, e cilësoi Dhomën e Llogarive të Ukrainës një SAI të madh të një vendi me tradita dhe që lufton për lirinë dhe dinjitetin e tij, institucion i cili, nën idetë dhe vrullin për ndryshim të drejtuesit Patskan, synon të shndërrohet në një SAI evropian modern, duke rritur nivelin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies publike në vend. *"Ne kemi miq dhe partnerë të përbashkët, si Presidentin aktual të SAI-t polak(NIK) z. Krzysztof Kwiatkowski, ish-Presidentin Jacek Jezierski dhe zv/Presidentin e NIK, Wojciech Kutyla, me të cilët bashkëpunojnë të dyja SAI-t tona"*, theksoi z. Leskaj. Ai e ftoi Presidentin Patskan të vizitojë Shqipërinë në 2-3 muajt e ardhshëm, për të diskutuar ide dhe plane të përbashkëta pune. Marrëveshja me SAI-n e Ukrainës është e 17-a marrëveshje me SAI-t evropiane simotra që KLSH ka nënshkruar gjatë viteve 2012-2018, duke zgjedhur qasjen e partneritetit të hapur dhe bashkëpunimit konkret e reciprok me institucionet e zhvilluara të auditimit suprem evropian.

Punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar organizuan ditën e dhurimit vullnetar të gjakut

Në kuadër të veprimtarive dhe nismave ndërgjegjësuese të 14 Qershorit, Ditës Botërore të Dhurimit të Gjakut, punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit

në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar organizuan në datën 22 qershor një sesion dhurim gjaku në mjediset e Institucionit.

Që prej vitit 2004, çdo vit në 14 Qershor në shumë vende të botës organizohet Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut. Qëllimi i kësaj dite është rritja e ndërgjegjësimit për sigurimin e gjakut të sigurt dhe produkteve të tij, si dhe për të falenderuar të gjithë dhuruesit e gjakut për jetët e shpëtuara nga ky dhurim.

Punonjësit e KLSH-së iu përgjigjen thirrjes për të dhënë gjak vullnetarisht dhe midis tyre ishte edhe Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj.

Zoti Leskaj është një dhurues i rregullt i gjakut që nga viti 2005 dhe për këtë arsye u nderua nga Kryqi i Kuq Shqiptar me certifikatë falenderimi *"Për mbështetjen dhe bashkëpunimin e ofruar për organizimin e dhurimit vullnetar të gjakut".*

KLSH merr pjesë në takimin përmbyllës të auditimit paralel "Cilësia e Ajrit"

Në datat 19-20 qershor 2018 u zhvillua takimi në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Polonisë në Varshavë mbi auditimin evropian të "Cilësisë së Ajrit" i iniciuar nga EUROSAI nën bashkë udhëheqjen e SAI-it (Institucionit Suprem të Auditimit) të Hollandës dhe Polonisë. Në këtë event krahas SAI-ve të Polonisë dhe Holandës morën pjesë edhe SAI-t e Shqipërisë, Bullgarisë, Estonisë, Hungarisë, Izraelit, Kosovës, Maqedonisë, Moldavisë, Rumanisë, Sllovakisë, Spanjës. Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë takim nga z. Artur Hasanbelliu, Drejtor i Auditit të Brendshëm në KLSH, z. Qemal Shehu, Drejtor i Departamentit te Njësive të Qeverisjes Vendore, z.Aulent Guri, Kryeauditues në Departamentin e Auditimit të Performancës në KLSH dhe z. Ryisim Xhaja, auditues në Departamentin e Njësive të Qeverisjes Vendore. Objektivi kryesor i këtij auditimi në të gjitha vendet pjesëmarrëse ka qenë vlerësimi i masave të ndërmarra për të luftuar ndotjen e ajrit. Takimi ishte i ndarë në

dy sesione kryesore. Në sesionin e parë të gjitha vendet pjesëmarrëse prezantuan raportet e tyre finale mbi auditimin me temë "Cilësia e Ajrit" që kanë kryer në vendet respektive, shoqëruar me gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme si dhe impaktin e deritanishëm të auditimeve të "Cilësisë së ajrit".

Grupi i auditimit të KLSH-së në prezantimin e tyre krahas gjetjeve dhe rekomandimeve u ndal edhe në impaktin e gjerë që ky auditim pati në median e shkruar dhe vizive. Gjithashtu, ky auditim është prezantuar edhe në dy Universitete të ndryshme të vendit tonë. Dita e dytë nisi siparin me fjalën përshëndetëse të Kryetarit të NIK-ut polak z. Krzysztof Kwiatkowski i cili vlerësoi dhe njëkohësisht falenderoi për punën e bërë të gjitha SAI-t pjesëmarrëse në këtë projekt duke theksuar njëkohësisht rëndësinë e këtij auditimi në dobi të qytetarëve. Ndër të tjera z. Kwiatkowski theksoi se më shumë se 15.000 njerëz në vit humbasin jetën në Poloni si pasojë e ndotjes së ajrit dhe më shumë se 200.000 njerëz në vit vuajnë pasojat e ndotjes së ajrit në gjithë Europën.

Në përfundim të takimit u diskutua me të gjithë audituesit pjesëmarrës mbi Raportin Përfundimtar (Joint Report) që do të publikohet me përmbledhjet e secilit SAI pjesëmarrës në këtë projekt. Me publikimin e "Joint Report" do të synohet të përcillen çështjet më kryesore drejtuar Komisionit dhe Parlamentit Evropian. Ky ishte dhe mesazhi përmbyllës i audituesve holandezë.

Dr. Hubert WEBER, një nga hartuesit e Deklaratës së Limës dhe ish-President i Gjykatës Europiane të Audituesve, viziton KLSH-në

Në datat 25-26 qershor 2018, me ftesë të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit z. Bujar Leskaj, vizitoi Shqipërinë dhe KLSH-në një nga personalitetet më të spikatura të auditimit të jashtëm publik modern, një nga hartuesit kryesorë të Deklaratës së Limës dhe firmosësit e saj, ish-Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t dhe Gjykatës Austriake të Auditimit, si dhe ish-Presidenti i Gjykatës Europiane të Auditimit, Dr. Hubert Weber.

Deklarata e Limës për parimet dhe rregullat e auditimit të jashtëm publik, e nënshkruar në vitin 1977 në Lima të Perusë, konsiderohet ndryshe edhe si

Kushtetuta, Magna Carta e institucioneve supreme të auditimit. Rëndësia e saj, si dokumenti bazë mbi të cilin ndërtojnë veprimtarinë e tyre Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-t), është parësore. Vlefshmëria e parimeve të përfshira në Deklaratën e Limës, jo vetëm i ka rezistuar kohës, por ka një vlerë të veçantë për veprimtarinë e sotme audituese të SAI-ve, për kontributin e tyre në përmirësimin e jetës së qytetarëve, si dhe për ruajtjen e asetit kryesor të tyre, pavarësisë.

Kryetari i KLSH-së pati rastin të takojë Dr. Hubert Weber në Peru, në dhjetor të vitit 2017, në aktivitetin e organizuar me rastin e 40 vjetorit të Deklaratës së Limës.

Në kuadër të kësaj vizite, në datën 26 qershor, zoti Weber u prit nga Presidenti i Republikës, SH.T.Z. Ilir Meta.

Gjatë takimit, Presidenti theksoi rolin e KLSH-së në forcimin e zbatimit të ligjit në ambientin shqiptar, si një vend në proceset e ndërtimit të demokracisë. Gjatë bashkëbisedimit, pas prezantimit të kontributit të Dr. Weber në ECA dhe në Organizatën ndërkombëtare të SAI-ve (INTOSAI), u cilësua niveli i bashkëpunimit me KLSH-në dhe sidomos me Kryetarin Leskaj, i cili në mënyrë sistematike iu referohet standardeve të INTOSAI-t. *"Termi i INTOSAI-t është bërë fjalë e zakonshme edhe për ne, sa herë flasim për KLSH-në"*, nënvizoi Presidenti Meta. Lidhjet me Austrinë shkojnë përtej historisë por lidhen edhe me dijen dhe kontributin e këtij vendi si burim dijesh për shumë shqiptarë të shkolluar në këtë vend, përfundoi z.Meta.

Kryetari i KLSH-së, duke e falënderuar për suportin e vazhdueshëm personal dhe institucional, i dorëzoi Presidentit Ilir Meta librin *"40 vjet Deklarata e Limës",* duke theksuar se një KLSH e modernizuar dhe e pavarur ka rëndësi jo vetëm për zbatimin e ligjit por edhe për rritjen e përgjegjshmërisë dhe profesionalizimit të administratës publike.

Në datën 25 qershor, z.Weber u prit në një takim nga Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z.Gramoz Ruçi.

Zoti Ruçi gjatë fjalës së tij theksoi se Kuvendi dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit po bashkëpunojnë në mënyrë të frytshme. Komisionet parlamentare dhe deputetët mbështeten në indiciet nga auditimet e KLSH në ushtrimin e detyrave të tyre funksionale për kontrollin parlamentar. Kuvendi jep të gjithë mbështetjen e vet që Kontrolli i Lartë i Shtetit të bëhet gardian i ligjshmërisë, ndershmërisë dhe eficiencës së qeverisjes. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Z. Bujar Leskaj, vlerësoi mbështetjen e madhe ligjore, institucionale dhe morale që Kuvendi i ka dhënë dhe vazhdon t'i japë KLSH-së. Nga ana e tij, Z. Weber, falënderoi Kryetarin e Kuvendit për pritjen dhe e informoi atë mbi bashkëpunimin e ngushtë me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë. Ai vlerësoi gjithashtu bashkëpunimin efektiv midis Kuvendit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke e konsideruar këtë bashkëpunim mjaft të dobishëm për plotësimin e misionit të KLSH-së dhe evidentoi rolin që po luan KLSH dhe Kryetari Leskaj në komunitetin e INTOSAI-t këto vitet e fundit.

Në datën 25 qershor, Dr. Weber u prit nga Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj në zyrat e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Zoti Weber u shpreh se u ndje shumë i nderuar nga ftesa e bërë nga Kryetari Leskaj në dhjetor 2017 për të vizituar KLSH-në, duke theksuar: *"Ne, jemi dy SAI të vogla, por dijet për auditimin na pajisin me një forcë të madhe. Pavarësia është një vlerë e shenjtë që kemi, dhe na takon detyra ta ruajmë atë në çdo moment, nga ndërhyrjet dhe influencat që vijnë nga të gjitha anët. Ne si SAI austriak jemi në qendër të aktiviteteve të INTOSAI-t, pasi mbajmë Sekretariatin e Përgjithshëm të organizatës. Vij për herë të dytë në Shqipëri, pas 11 viteve dhe ju keni bërë transformime të jashtëzakonshme".*

Duke ju referuar kolanës së botimeve të KLSH-së, e cila arrin në 83 tituj librash për periudhën 2012-2017, Dr. Weber vlerësoi këtë veprimtari të SAI-t shqiptar si shumë të veçantë, pasi përcjell dijet për auditimin dhe historinë e dokumenteve themelore të auditimit, nga njëri brez audituesish në tjetrin,

duke vlerësuar në mënyrë të veçantë botimin për 40 vjetorin e Deklaratës së Limës, i cili është botuar menjëherë pas përfundimit të aktivitetit të kremtimit të 40 vjetorit të kësaj deklarate.

Z. Leskaj e falenderoi personalitetin austriak për vizitën dhe tha se *"Prania Juaj sot është një nderim që i bëhet auditimit publik të Shtetit shqiptar, por edhe të gjithë shqiptarëve, pasi ndjenjat e tyre të krenarisë kombëtare janë të lidhura me popullin dhe qeverinë austriake, të cilët na kanë ndihmuar në Shpalljen e Pavarësisë sonë në nëntor 2012 dhe, që nga ajo kohë, kanë qëndruar në mënyrë konstante përkrah zhvillimit të kombit dhe Shtetit shqiptar".*

Z. Leskaj përmendi bashkëpunimin e vitit 2016 me Gjykatën Austriake të Auditimit në zhvillimin e procesit të rishikimit mes kolegëve (Peer Review) me KLSH-në, në lidhje me pavarësinë e saj, duke falënderuar për ndihmën e dhënë.

Në datën 26 qershor, në sallën e Akademisë së Shkencave, Dr. Hubert Weber mbajti një leksion në prani të audituesve të KLSH-së dhe drejtuesve të lartë të KLSH-së. Takimin e hapi Kryetari i KLSH-së, i cili duke falënderuar z. Weber për pranimin e ftesës për të vizituar KLSH-në dhe për të mbajtur këtë leksion me audituesit e jashtëm publikë shqiptarë, evidentoi vlerat dhe kontributin e z.Weber në të gjitha funksionet që ka ushtruar.

Zoti Leskaj e cilësoi këtë takim si vijim i takimeve me personalitete të shoqërisë civile dhe të profesionistëve të fushës së auditimit, duke konfiguruar profilin tonë si një SAI modern. Dr. Hubert Weber e nisi kumtesën e tij duke paraqitur një historik të shkurtër të hapave të ndërrmarë për të arritur në themelimin e Deklaratës së Limës dhe, në vijim, me Deklaratën e Meksikos dhe kongreset e tjera të INTOSAI-t që shënuan data shumë të rëndësishme në hartimin e standardeve ndërkombëtare të SAI-ve.

Nga viti 1953, me Kongresin e parë të SAI-ve, i mbajtur në Havana të Kubës, që shënon edhe krijimin e INTOSAI-t (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit) u deshën 24 vite deri në hartimin e një kushtetute e cila do të sanksiononte llojet e auditimeve, pavarësinë e SAI-ve, kompetencat e tyre, si dhe raportimin në Parlament.

Zoti Weber trajtoi në pjesën e parë të leksionit vlerat e patjetërsueshme të pavarësisë së institucioneve supreme të auditimit, si dhe iu përgjigjet pyetjeve dhe interesit të audituesve të KLSH-së. *"Megjithatë, duke qenë SAI pjesë e Shtetit, pavarësia e tyre riskohet në mënyrë të vazhdueshme. Për këtë shkak, është një nga detyrat e përditshme të këtyre institucioneve të përditësojnë dhe përmirësojnë kornizën e tyre ligjore, për të minimizuar këto risqe dhe forcuar pavarësinë e tyre.",* u shpreh z. Weber.

Zoti Weber theksoi rëndësinë e pavarësisë së SAI-t dhe sfidat e pavarësisë e profesionalizmit të audituesve. Me shumë interes u ndoq nga audituesit e KLSH-së raporti i auditimit i Gjykatës Europiane të Audituesve (ECA) mbi Cilësinë e Ujit të Pijshëm në Bullgari, Hungari dhe Rumani dhe cili ishte ndikimi i Bashkimit Europian mbi përmirësimin e cilësisë së ujit, sipas kërkesave të Direktivës mbi Ujin e Pijshëm. Ky auditim ishte fokusuar në kornizën ligjore të vendeve anëtare mbi ujin e pijshëm, duke marrë si praktikë të mirë Udhëzimet e Komisionit Evropian mbi të njëjtën temë.Nga ky raport arrihet në përfundimin se cilësia e ujit të pijshëm është përmirësuar ndjeshëm në këto vende pas anëtarësimit në Bashkimin Europian. Një auditim të ngjashëm performance mbi Cilësinë e ujit, është duke përfunduar aktualisht edhe Departamenti i Performancës në KLSH. Audituesit e performancës adresuan disa pyetje, lidhur me këtë cështje.

Pjesa e fundit e leksionit u zhvillua në ambientet e reja të punës së KLSH-së, në sallën e konferencave *"Lech Kaczynski".* Gjatë këtij takimi që u zhvillua në formë bashkëbisedimi, pati shumë pyetje lidhur me eksperiencën e gjatë profesionale të z.Weber, mbi konceptin e pavarësisë së SAI-ve, metodologjisë së përdorur në auditimin e ECA-s dhe marrëdhënien e audituesve të ECA-s me audituesit publikë të jashtëm të vendeve anëtare.

Gjatë vizitës së tij në Shqipëri, z.Weber vizitoi disa institucione të kulturës dhe historisë së vendit tonë.

Pas përfundimit të vizitës në Shqipëri, në datën 13 gusht 2018, Dr. Hubert

Weber i dërgoi një letër falënderimi z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në letrën e tij të falenderimit, Dr. Weber, ndër të tjera, cilëson se:

”Krahasuar me vizitën time të mëparshme, kam gjetur një Tiranë në mënyrë të konsiderueshme më moderne, pa humbur sharmin e saj… KLSH është pjesë e kësaj përpjekjeje për modernizim.

Fakti që gjeta në terren arsyet pse në qarqet e auditimit suprem publik, sidomos në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), KLSH është një SAI shumë e vlerësuar, si dhe që në vizitën time komunikova me drejtues dhe auditues tejet të motivuar të Institucionit tuaj, nënkupton për mua një kënaqësi të madhe.

Unë dua t'ju përgëzoj për "muzeun" e KLSH-së, të projektuar jashtëzakonisht mirë, gjë që më ka impresionuar”.

KLSH merr pjesë në Konferencën "Motivimi i SAI-ve për kryerjen e procesit të rishikimit midis kolegëve "Peer Review"

Konferenca "Motivimi SAI-ve për kryerjen e procesit të rishikimit mes kolegëve "Peer Review“ u zhvillua në datat 20-22 Qershor në Bratislavë. Në këtë konferencë morën pjesë 90 pjesëmarrës nga shtete të ndryshme anëtare të EUROSAI-t, ARABOSAI-t, AFROSAI-t, ASOSAI-t, PASAI-t, OLACEFS, përfaqësues të SIGMA, IDI dhe GAO.

Referuar nivelit të përfaqësimit në këtë konferencë morën pjesë gjithashtu edhe Kryetarë të Institucioneve Supreme të Auditimit, si i Sllovakisë, Maltës, Palestinës, Butanit, Sudanit, Indisë, zëvendës presidentë të SAI-ve etj. Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë konferencë nga Luljeta Nano, Sekretar i Përgithshëm dhe auditueset Irma Idrizaj dhe Jonida Gruda. Aktiviteti u organizua nga SAI i Slovakisë, njëherazi dhe kryesues i Nënkomitetit mbi Peer Review si pjesë e Komitetit të INTOSAI-t “Për ngritjen e Kapaciteteve” (CBC INTOSAI). Konferenca u fokusua në trajtimin e tre temave kryesore:

1. *SAI udhëheq nëpërmjet shembullit duke zhvilluar procese të peer review;*
2. *Instrumentet e Peer Reviewŵ për përmirësimin e performances në SAI;*
3. *Praktikat e mira në kryerjen e procesit të Peer Review.*

Në prezantimin e tij Drejtori i Përgjithshëm i IDI-t, z. Geinar Gorrison, solli në vëmendjen e pjesëmarrësve argumentet mbi domosdoshmërinë e kryerjes së procesit të peer review nga

SAI dhe impaktet në performancën institucionale të SAI-ve. U theksua fakti qe Peer review është një instrument efektiv për identifikimin e pikave të dobëta dhe të forta në menaxhimin institucional, një input efektiv për disenjimin e strategjive për periudhat ne vijim, një model i mirë për të vepruar si një institucion "par excellence" i cili promovon transparencën dhe përgje-gjshmërinë.

Krahas sa më sipër nëpërmjet procesit të peer review SAI krijon mundësinë e për shkëmbimin e eksperiencave dhe implementimin e praktikavë të mira midis SAI-ve, krijon një terren produktiv për krijimin dhe forcimin e marrëdhënieve e partnershipeve afatgjata, si dhe nxit frymën e vullnetarizmit, besueshmërisë dhe bashkëpunimit në komunitetin e INTOSAI-t.

Është mjaft e rëndësishme për SAI-n që kur planifikon kryerjen e një procesi të peer review të përcaktojë saktë objektin, aspektet, drejtimet, fushën së çfarë do i nënshtrohet procesit të rishikimit, bauar në ISSAI 5600 "Udhërrëfyesi për peer review".

Përgjatë konferencës theksi u vu mbi instrumentin e peer reviewŵ konsideruar një metodologji vlerësimi dhe jo auditimi që kryhet nga ekipet e përbërë nga SAI të tjera, IDI ose nga organizatat rajonale të INTOSAI-t. Objekt i prezantimit ishte dhe aplikimi i Instrumentit i vlerësimit nga jashtë (external assessment) që përfaqëson një metodologji që kryhet nga ekipe konsulente apo nga partnerë si SIGMA.

Në një session të veçantë të konferencës dedikuar shkëmbimit të eksperiencave midis SAI-ve përfaqësuesit e KLSH-së sollën në vëmendje përvojën e KLSH-së në drejtim të kryerjes së procesit të Peer Reviewŵ nga SAI Austriak dhe ai i Moldavisë bazuar në parimet e vullnetarizmit partneritetit dhe besimit reciprok. Përsa i përket objektit të procesit të peer reviewŵ në rastin e ALSAI-t ishte dhenja nga SAI-t partnere të vlerësimit mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare ISSAI 10, dhe 11 "Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI-ve" dhe "Udhëzime e praktika të mira", si dhe elementë qëndrorë të ISSAI 12 duke u fokusuar në tetë parimet pavarësisë. Po kështu u theksua fakti që KLSH në kohë reale kishte publikuar Raportin e Peer review në faqen zyrtare si dhe e dërgoi për njohje Kuvendit (Komisionit të Ekonomisë dhe Financave si struktura parlamentare që mbulon veprimtarinë e KLSH-së).

Tema e II-të, në të cilën u fokusuan diskutimet përgjatë konferencës ishin Teknikat e aplikuara për procesin e Peer riview me impakt përmirësimin e performancës në SAI; Përfaqësuesja e IDI-t zj. Dafina Dimitrova solli në vëmendje të të pranishmëve përdorimin e instrumentit të Matjes së Performancës (PFM) e aplikuar si një

teknikë në konteksin e procesit të peer reviewŵ, fokusuar në përfitimet e SAI-t kur përdor këtë metodë të vetëvlerësimit.

Po kështu përfaqësuesja e IDI-t prezantoi të dhënat mbi ekpertizën e ofruar nga IDI me ekspert të konfirmuar tashmë në të gjitha organizatat rajonale te SAI-ve ku vetëm EUROSAI dispononte 127 ekspertë në përdorimin e instrumentit të PMF-së sipas mënyrës Peer review. Përfaqësuesi i AFROSAI-e z. Meisie Nkau në cilësinë e Shefit Ekzekutiv të Bordit Qeverisës në këtë konferencë solli në vëmendje, një instrument vlerësimi përdorur gjerësisht në rajon e sikurse është Rishikimi i sigurimit të cilësisë bazuar në kuadrin e ndërtimit të kapaciteteve institucionale (ICBF). Në vitin 2006 bordi qeverisës i AFROSAI-e vendosi që çdo SAI anëtar i AFROSAI-e duhet të kryejë proces peer reviewŵ të paktë një herë në tre vjet dhe qëllimi i ishte vlerësimi i përputh-shmërisë me ISSAI-t dhe përcaktimi i fushave për ndërtimin e kapaciteteve.

Në përfundim të konferencës Presidenti i SAI-t Slovak z. Karol Mitrik theksoi se kjo konferencë ishte një hap përpara drejt identifikimit të praktikave të mira të INTOSAI-t, si dhe evidentimit të diversitetit të mjeteve dhe instrumenteve që INTOSAI përdor për vlerësimin e performancës së SAI-t, kjo në shërbim edhe të mirëqeverisjes dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve.

KLSH merr pjesë në trajnimin përmbyllës të projektit të USAID "Transparenca në Sistemin Shëndetësor"

Në datat 28-29 Qershor 2018, Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH mori pjesë në trajnimin përmbyllës të projektit të USAID "Transparenca në Sistemin Shëndetësor". Trajnimi me temë "Në zbatim të barazisë, efiçiensës dhe aksesit të shërbimeve shëndetësore" u zhvillua në qytetin e Rubikut dhe pati pjesëmarrjen e Drejtorit të departamentit, z. Rinald Muça dhe të gjithë audituesve të performancës, si dhe të trajnuesve dhe përfaqësuesve të USAID, BIRN e OpenData.

Trajnimi mbylli siparin e serisë së gjatë të takimeve dhe seminareve midis USAID dhe KLSH-së sa i përket këtij projekti në fushën e shëndetësisë dhe më konkretisht, transparencës në këtë sistem. Në fokus të tij, ishin procesi i prokurimit të barnave, kriteret standarde për përcaktimin e sasisë, procesi i vendimmarrjes, sigurimi i cilësisë së furnizuesve, si dhe sistemi i ankesave të pavarura dhe transparente.

Në ditën e parë të trajnimit, znj. Darcie Nielsen, drejtuese e Projektit, u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve, duke vlerësuar bashkëpunimin e frytshëm me KLSH sa i përket sektorit të shëndetësisë dhe duke e vlerësuar atë si një nga institucionet më të besuar dhe profesionale në vend. Znj. Flora Hobdari, këshilltare për politikat shëndetësore dhe qeverisjen dhe njëkohësisht, bashkëpunëtore e Projektit, diskutoi mbi sistemin e prokurimit të barnave, të përqendruar në spitalet publike. Mirëqeverisja në prokurimet e barnave ndikon fuqimisht në efektivitetin e sektorit të shëndetësisë dhe aksesin e barabartë në barna. Audituesit e performancës u rinjohën me bazën ligjore dhe mënyrat e procedurave të prokurimit të barnave në këtë sektor, si dhe me fushat prioritare për rritjen e transparencës.

Dita e dytë e trajnimit u hap me fjalën përshëndetëse të Drejtorit të Departamentit të Performancës në KLSH, z. Muça dhe vijoi me prezantimet e disa prej auditimeve korrente të performancës në të cilat KLSH është angazhuar dhe që lidhen me sistemin shëndetësor. Znj. Xhuljeta Çelaj, Audituese e Lartë, referoi mbi auditimin e ushtruar në Shërbimin e Urgjencës Mjekësore, auditim ky i asistuar edhe nga ekspertët e "Transparencës në Sektorin e Shëndetësisë".

Z. Aulent Guri, Kryeauditues, prezantoi auditimin e kryer mbi "Menaxhimin e mbetjeve spitalore", duke dhënë një panoramë të përgjithshme të kontekstit social në të cilin është ndërfutur ky auditim, subjekteve, metodologjisë së përdorur, qasjes audituese dhe piramidës së pyetjeve mbi të cilat është ngritur auditimi.

Z. Alfred Leskaj, Auditues i Lartë, prezantoi auditimin me temë "Receta dhe nënshkrimi elektronik", duke shpalosur në vija të trasha kornizën e këtij auditimi, çështjet e shqyrtuara, si dhe rëndësinë e tyre në raport me një shëndetësi efektive, efiçiente dhe ekonomike. Natyrisht, prezantimet nuk përmbanin gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e dhëna nga audituesit përkatës, duke qenë këto auditime ende në fazën e projekt-raportit dhe duke respektuar të drejtën e subjekteve për të përcjellë observacione, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI).

Znj. Valbona Kolgeci, në diskutimin e saj, kishte përgatitur prezantimin me temë "Si të shkruajmë një raport auditimi performance të kuptueshëm për publikun", duke dhënë pikëpamjet e veta si gazetare dhe eksperte e medias. Ky referim hasi në një debat konstruktiv midis audituesve të performancës dhe pjesëmarrësve të tjerë në trajnim, sidomos në pikat e (mos)takimit midis kërkesave të një shkrimi të medias/gazetave/portaleve në ditët e sotme dhe standardeve të auditimit. Komunikimi sa më i thjeshtë dhe reader-

friendly me qytetarët është në qendër edhe të Strategjisë së re të Komunikimit të KLSH-së, por që nuk mund të përkulet deri në cënimin e atyre standardeve që përbëjnë bazën e punës audituese dhe përgatitjen e publikimin e raporteve. Këto trajnime dhe seminare dëshmojnë sërish për suksesin e Marrëveshjes së bashkëpunimit midis KLSH dhe USAID, partneritet ky që do të vazhdojë të jetësohet edhe në vijim. KLSH, si katalizator në bashkëpunimin konkret ndërinstitucional në luftën kundër korrupsionit, e ka identifikuar USAID-in si një partner të rëndësishëm e të besuar për këtë çështje.

Presidenti i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë zhvilloi një vizitë zyrtare në Shqipëri

Nga datat 10-12 korrik 2018, Presidenti i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë zhvilloi një vizitë zyrtare në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Vizita u zhvillua në kuadër të organizimit të Konferencës përmbyllëse të Projektit IPA 2013, financuar nga BE, "Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm në Shqipëri". Më 10 korrik 2018 KLSH dhe Kryetari i saj përuruan Sallën qendrore të ndërtesës se Kontrollit të Lartë të Shtetit me emrin Lech Kaczyński, në bazë të Vendimit të Kryetarit te KLSH nr. 41, datë 11.05.2018, me motivacionin:

"Ne kujtim të Lech Kaczyński, një prej personaliteteve me te mëdha të kombit dhe Shtetit Polak, President i Zyrës së Auditimit Suprem të Polonisë (NIK) në vitet 1992-1995, reformator i institucionit te auditimit suprem publik te Polonisë dhe President i Republikës se Polonisë ne vitet 2005-2010, ne respekt dhe mirënjohje te thelle ndaj kontributit te jashtëzakonshëm të Presidentit te NIK z. Krzysztof Kwiatkowski, ish-Presidentit te NIK-ut polak, sot Këshilltar i Lartë i Presidentit të NIK, z. Jacek Jezierski, dhe Zv/Presidentit te NIK, z. Wojciech Kutila në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën 2012-2018, nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me kolegët dhe ekspertët polakë te NIK, sipas moto-s së INTOSAI-t "Experentia mutua Omnibus Prodest" dhe Nenit 15 te Deklarates se Limës".

Në këtë përurim morën pjesë ambasadori i Polonisë në Shqipëri, SHTZ. Karol Bachura, Presidenti i NIK Polak, z. Krzysztof Kwiatkowski, ish-President i NIK dhe aktualisht Këshilltar i Presidentit të NIK Polak, z. Jacek Jezierski, deputeti i Kuvendit të Polonisë dhe Kryetar i Grupit të miqësisë Poloni-Shqipëri, z. Tomasz Glogowski, deputetja e Kuvendit të Shqipërisë, Kryetare

e Grupit të miqësisë Poloni-Shqipëri, Zj. Evis Kushi, si dhe të ftuar të tjerë, drejtues e auditues të KLSH.

Në fjalën e tij përshëndetëse Kryetari KLSH u bëri të ditur të pranishmëve shkurtimisht historinë e z. Lech Kaczynski që prej vitit 1992, vit ku z. Kaczynski mbante postin e Presidentit të NIK, duke vënë theksin në ndikimin e tij të çmuar në shumë reforma për ndryshimin e qasjes se institucionit në auditim, ne ristrukturimin, si dhe duke përgatitur ligjin e ri mbi auditimin suprem publik në Poloni, i cili është ende në fuqi sot. Zoti Kaczynski i dha drejtimin dhe profilin evropiano-perëndimor që meritonte, NIK-ut polak.

Kryetari i KLSH theksoi se krahas pllakës përkujtimore te këtij personaliteti të madh të kombit dhe Shtetit polak, rëndësinë e plotësimit të kësaj salle me portretet e drejtuesve te sotëm të NIK, Presidentit Kwiatkowski, ish-Presidentit Jezierski dhe Zv/Presidentit Kutyla, si shenjë falënderimi për bashkëpunimin dhe realizimin me sukses të punës se përbashkët. Bashkëpunimi i nisur nga Presidenti Jezierski ne korrik të vitit 2012, ka vijuar me intensitet në periudhën mars 2016-korrik 2018, kohë që përkon me zbatimin nga NIK dhe nga SAI i Kroacisë i Projektit te Binjakëzimit IPA 2013 "Forcimi i kapaciteteve te Auditimit të Jashtëm Publik në Shqipëri".

Z. Kwiatkowski në fjalën e tij përshëndetëse vlerësoi projektin IPA të implementuar në KLSH, si projektin më të mirë të implementuar dhe theksoi vullnetin e Kryetarit të KLSH-së për realizimin me sukses të këtij projekti.

Presidenti Kwiatowski e mbylli fjalën e tij me mbështetjen që ka dhënë Ministri i Jashtëm i Republikës së Polonisë në Samitin e Londrës, të zhvilluar dy ditë më parë, lidhur me mbështetjen maksimale që Polonia do t'u japë vendeve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e tyre sa më shpejt në BE.

Letër falënderimi drejtuar Kryetarit të KLSH-së nga deputeti i Parlamentit të Republikës Polake z.Jaroslav Kaczynski me rastin e vendosjes së emrit të ish Presidentit të SAI-t Polak, z.Lech Kaczynski, sallës së Konferencave të KLSH-së.

Jarosław Kaczyński, **Partia për Ligj dhe Drejtësi (PiS)**

Kryetar

Varshavë, më 5 korrik 2018

I nderuar Zoti Kryetar,

Të nderuar Zotërinj,

Ndjehem jashtë mase i nderuar që salla përfaqësuese në godinën e Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë merr emrin e Presidentit të Republikës së Polonisë Lech Kaczyński si dhe që Vëllai im i Ndjerë do të kujtohet me një pllakë përkujtimore. Ky është një gjest i bukur nga ana Juaj ndaj do të doja të falënderoja nga thellësia e zemrës autoritetet e Kontrollit të Lartë në Shqipëri me Zotin Kryetar Bujar Leskaj në krye.

Jam thellësisht i bindur që bashkëpunimin ndërmjet Institucionit Suprem të Auditit polak me Kontrollin e Lartë të Shqipërisë Presidenti Lech Kaczyński do ta kishte përshëndetur me gëzimin më të madh. Vëllai im i Ndjerë i ka kushtuar rëndësi të madhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimit të përvojës që rrjedh prej tij. Ai konsideronte që përvoja e NIK-ut polak mund të ishte posaçërisht e vlefshme për shtetet e tjera të ish bllokut komunist. Në krye të NIK-ut, në fillimin e vitit 1992, i vuri vetes si objektiv strategjik- sikundër e thoshte vetë- "ndërtimin e një organi kontrolli modern, përshtatur kushteve të demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Ndërtimin e organit, i cili para së gjithash do të ishte i aftë të monitoronte proceset më të rëndësishme në shtet dhe ekonomi, e në mënyrë të veçantë ato procese që lidheshin me transformimet e sistemit. Kusht për realizimin e këtij objektivi ishte shkëputja e plotë e NIK-ut nga pushteti ekzekutiv si dhe ndërprerja e të gjitha lidhjeve të mundshme të NIK-ut me subjektet e audituara prej tij." Ai bëri të mundur që auditimet e ndërmarra të mos ishin të rastit, por të kishin karakter sistemor, të tillë që përcillte informacion dhe dije për patologjitë në Poloni.

Kurorëzim i punës së Vëllait tim të Ndjerë në funksionin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë ishte përgatitja e ligjit krejtësisht të ri mbi Kontrollin e Shtetit, i cili merrte në konsideratë objektivat e sipërpërmendura si dhe transformimet socialo-politiko-ekonomike. Lech Kaczyński e shkroi atë ligj me vetëdije të plotë se në qoftë se do të miratohej ai vetë do të humbiste funksionin e kryetarit. Të mirën e institucionit, të mirën e kontrollit shtetëror e vuri kësisoj mbi interesat vetjake. Kjo qasje e ka

karakterizuar Atë në gjithë veprimtarinë e tij.

Si masë e suksesit të Tij në vendosjen e NIK-ut në binarë të rinj mund të konsiderohet fakti që deri në momentin e marrjes së detyrës besueshmëria e Kontrollit të Lartë në sytë e opinionit publik ishte shumë e ulët, ndërsa në kohën e largimit, institucioni që ai drejtoi gëzonte një vlerësim shumë të lartë dhe besueshmëri tek qytetarët

Këtu do të doja të shtoja se fakti i bashkëpunimit midis Institucionit Suprem të Auditit me Kontrollin e Lartë të Shqipërisë më gëzon shumë jo vetëm si vëlla i Presidentit të Ndjerë Lech Kaczyński, por edhe personalisht. Shpresoj se ky bashkëpunim do të sjellë forcimin e marrëdhënieve midis Popujve tanë, çka do të doja t'ua dëshiroj Zotërinjëve, neve të gjithëve, Shqipërisë dhe Polonisë. Ndërsa Zotit Kryetar Bujar Leskaj i uroj suksese të mëtejshme në drejtimin e Kontrollit të Lartë në Shqipëri.

Me respekt,

Jarosław Kaczyński

(Korrespondenca e Kaçinjskit me Kviatkovskin)

I nderuar Zoti Kryetar,

Të falënderoj me gjithë zemër për kujtimin dashamirë dhe ftesën për Tiranë në ceremoninë e dhënies së emrit të Presidentit të Republikës së Polonisë Leh Kaçinjski aulës përfaqë-suese në godinën e KLSH së Shqipërisë si dhe zbulimit të pllakës që përkujton Vëllanë tim të Ndjerë. Për fat të keq, për arsye që nuk varen nga unë, nuk do të mund të vij në Tiranë, me dëshirën më të madhe megjithatë do t'u drejtoj një letër pjesëmarrësve të ceremonisë së rastit.

I Nderuar Zoti Kryetar,

Gëzohem shumë që NIK-u merr pjesë në sipërmarrjet ndërkombëtare që kanë për qëllim ndërtimin apo përsosjen e sistemeve të kontrollit shtetëror në zonën e Tre Deteve, Kaukazit Jugor dhe Ballkanit Perëndimor. Ne e dimë mjaft mirë sa e rëndësishme është çështja e institucioneve efektive të kontrollit për zhvillimin e duhur që i shërben së mirës së përgjithshme në vendet e ish bllokut komunist. Vëllai im i Ndjerë me siguri që do ta kishte mbështetur një qasje të tillë.

Edhe një herë, duke Ju falënderuar për kujtimin dhe ftesën, do të doja t'Ju uroja, Zoti Kryetar, Juve personalisht dhe të Afërmve Tuaj, gjithë të mirat.

Me respekt,

Jarosław Kaçinjski

Kryetari i Kuvendit Z.Gramoz Ruçi, i rezervoi një pritje të veçantë Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, Z. Krzysztof Kwiatowski, i shoqëruar nga Ambasadori i Polonisë në Tiranë, Z. Karol Bachura, si edhe Kryetari i KLSH, Z. Bujar Leskaj.

Polonia është për Shqipërinë një vend partner e mik dhe përfaqëson një nga

modelet më të suksesshme të progresit drejt demokracisë dhe integrimit europian, nënvizoi Kryetari i Kuvendit. Zoti Ruçi vlerësoi gjithashtu mbështetjen e Polonisë për procesin e integrimit europian të Shqipërisë.

Auditimi i veprimtarisë së institucioneve shtetërore është me rëndësi thelbësore për zhvillimin dhe demokracinë. Nisur nga ky vizion, në mënyrë konsensuale në Shqipëri Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është përfaqësues i opozitës. Kjo i shërben konsolidimit të demokracisë, krijon një ekuilibër në kontrollin e veprimtarisë qeverisëse prej opozitës, duke i dhënë asaj mundësi pjesëmarrjeje në instrumentet veprues të kontrollit dhe auditimit. Por kjo i shërben edhe eficiencës së kontrollit të qeverisjes, duke e bërë atë më funksionale, më të thellë dhe më përfshirëse.

Kryetari i Kuvendit vlerësoi bashkëpunimin shumë të mirë të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë me Zyrën Supreme të Auditimit të Polonisë.

Nga ana e tij, Presidenti i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, Z. Krzysztof Kwiatowski, falenderoi Z.Ruçi për pritjen, bashkëpunimin e frytshëm të Kuvendit të Shqipërisë me Kontrollin e Lartë të Shtetit si edhe vlerësimet për bashkëpunimin dypalësh të KLSH-së me Zyrën Supreme të Auditimit të Polonisë. Ai e informoi Kryetarin e Kuvendit për përfundimin me sukses të një projektit të përbashkët dhe shprehu vlerësimet e tij më të larta për performancën dhe standartet e larta europiane të punës së Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë.

Në datën 10 korrik, pasdite, Presidentit Kwiatowski iu akordua titulli “Honoris Causa“, nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, mbështetur në aktivitetin e tij të deritanishëm dhe kontributin e veçantë që ka dhënë në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të modernizimit të këtij Institucioni, në mënyrë që auditimi i jashtëm në Shqipëri të vijë në nivel me standardet e INTOSAI-it (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit).Recencën për dhënien e titulli e bëri Zv/Dekania, Dr.Ela Golemi, e cila theksoi aktivitetin e gjerë të Presidentit Kwiatowskit dhe kontributin e tij në krye të NIK-ut Polak si edhe bashkëpunimin e tij me KLSH.

Rektorja e Universitetit të Durrësit, Prof.Dr. Kseanela Sotirofski i dorëzoi Presidentit Kwiatowski titullin "Honoris Causa", duke e cilësuar si stafi më i Ri Akademik i Universitetit të Durrësit.Presidenti Kwiatowski u shpreh *".. jam i lumtur që jam sot me ju dhe ndihem shumë krenar për nderin që po më bëni, duke më bërë pjesë të Universitetit Tuaj, i cili është Universiteti i dytë publik më i madh në vend".*

Në fjalën e tij, Presidenti Kwiatowski u përqendrua në lidhjen që ka mes Universitetit dhe SAI-ve dhe më e rëndësishmja që i bashkon është e vërteta. Në shkencë e vërtetë është diçka që është e sigurtë dhe jo e supozuar si e tillë. Njëkohësisht SAI-t në punën e tyre punojnë për të mbërritur tek e vërteta, për të bërë transparencën e përdorimit të fondeve publike.

Në datën 11 korrik, në sallën "Shtëpia e Europës" në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, Zyra Kombëtare e Auditimit Shtetëror të Polonisë (NIK), Zyra Shtetërore e Auditimit e Kroacisë dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvilluan Konferencën "Institucionet Supreme të Auditimit, duke parë përpara drejt së ardhmes", një aktivitet përmbyllës i Projektit të Binjakezimit IPA 2013 " Forcimi i kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm Publik në Shqipëri".

Ky projekt u financua nga Bashkimi Evropian për 2.1 milion euro dhe u zhvillua gjatë periudhës mars 2016-korrik 2018.Në fjalën e saj të përshëndetjes, Ambasadorja e Bashkimit Evropian në Shqipëri, zj. Romana Vlahutin theksoi se *"Të gjithë qytetarët shqiptarë janë pagues të taksave, të cilët kanë të drejtë të dinë si dhe saktësisht për çfarë janë përdorur paratë e tyre".* Në këtë drejtim, përfaqësuesja e Evropës së bashkuar nënvizoi se "forcimi i institucionit kontrollues të parasë publike është parësor. BE do të vijojë të mbështesë institucionin më të lartë auditues në vend, në mënyrë që raportet e tij të jenë sa më të lexueshme dhe të

kuptueshme nga qytetarët dhe që ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të tij sa më efektive". Në përshëndetjen e tij, Presidenti i NIK-ut polak, z. Krzysztof Kwiatkowski u shpreh se 11 korriku është një ditë e veçantë, dita e Shën Benediktit, patronit të Evropës. *"Kontrolli i Lartë i Shtetit po modernizohet, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me standardet e BE-së dhe në këtë prizëm, ai është një institucion tashmë i integruar tërësisht në familjen e madhe evropiane",* nënvizoi Kwiatkowski. "Dua të falenderoj KLSH-në, në veçanti Kryetarin e saj z. Bujar Leskaj, si dhe stafin e drejtuar nga ai, për bashkëpunimin e pashembullt që na ofruan dhe për krijimin e kushteve optimale që ekspertët e NIK të jepnin eksperiencen e tyre në auditim", përfundoi Presidenti i SAI-t polak.

Në vlerësimin e Audituesit të Përgjithshëm të Kroacisë, z. Ivan Klešić "*Ky Projekt Binjakëzimi ishte një punë e vështirë, por edhe një sukses i përbashkët i të gjithë veprimtarëve në të. U realizua një partneritet efektiv, i bazuar në interesin e përbashkët, mirëkuptimin dhe respektin për njeri-tjetrin".* Drejtuesi i Projektit dhe Zv-President i Parë i Zyrës Kombëtare të Auditimit Shtetëror të Polonisë, z. Wojciech Kutyla, u shpreh se "Historia e bashkëpunimit efektiv dhe intensiv të NIK me KLSH nis me urimin dhe ftesën formale për takim, që në fillim të vitit 2012 i dërguam Kryetarit të porsazgjedhur të KLSH, z. Bujar Leskaj u përgjigj pozitivisht.*"Zoti Leskaj është një njeri i fjalës dhe çfarë thotë e bën. KLSH-në e ka reformuar në një institucion modern auditimi, i cili përfaqësohet me dinjitet në auditimet e përbashkëta dhe paralele që ne SAI-t organizojmë në nivel evropian",* përfundoi z.Kutyla. Në fjalën e tij, Kryetari i KLSH theksoi se "Rritja e dijeve në auditim është investimi më madhor që një institucion suprem auditimi, një SAI mund të bëjë, për të qëndruar i pavarur dhe për të garantuar përmbushjen e misionit të tij Kushtetues në shërbim të qytetarit. Ka shumë arësye, përse për ne si KLSH, si SAI, Projekti i Binjakëzimit IPA 2013, i financuar nga Bashkimi Evropian ishte i domosdoshëm dhe erdhi në kohën e duhur. Së pari, ai pasoi një periudhe katërvjeçare 2012-2015, ku institucioni, në zbatim të motos së INTOSAI-t "Experentia mutua Omnibus prodest(Nga eksperienca e përbashkët fitojnë të gjithë)", i bëri të gjitha përpjekjet për të modernizuar veprimtarinë e tij audituese, përmes partneritetit me SAI-t e vendeve europiane të zhvilluara, trajnimeve brenda dhe jashtë vendit dhe zbatimit me rigorozitet të standardeve te INTOSAI-t, ISSAI-ve, në bazë të objektivave të Strategjisë së tij të Zhvillimit 2013-2017, të përgatitur me ndihmën e ekspertëve të Programit SIGMA të BE dhe OECD". Më tej, z.Leskaj vijoi *"Nëpërmjet këtij Projekti*

*Binjakëzimi, transferimi i njohurive dhe aftësive tek audituesit e KLSH ka përmirësuar dhe do të vijojë të përmirësojë standardet dhe transparencën e metodave të punës. Për periudhën mars 2016-korrik 2018, Projekti i Binjakëzimit IPA 2013 realizoi tetë auditime pilot të performancës, auditime financiare dhe të teknologjisë së informacionit. Ekspertët polakë, kroatë, portugeze, estonezë dhe hollandezë ndihmuan audituesit tanë të thelloheshin në qasjet e tyre në auditim, në gjetjet dhe rekomandimet, si dhe në mesazhet qëndrore të auditimit. 97 misione ekspertësh dhe 6 vizita pune e shkëmbimi eksperiencash sollën manual të ri të auditimit të TI, si dhe rregullore, procedura të brendshme dhe manuale të përmirësuara. Institucioni po mbështetet tek një personel me kualifikime të larta dhe sisteme e procese moderne menaxhimi. Dobia më e madhe dhe vlera e shtuar e këtij Projekti të financuar nga BE, qëndron në faktin se ai vendos piketa të qëndrueshme për zhvillimin e auditimit të jashtëm publik të vendit për vitet 2020-2025, kohë kur sigurisht Shqipëria do të jetë bërë vend anëtar me të drejta të plota në Bashkimin Evropian".*Në diskutimet e tyre, Këshilltari i Lartë i NIK dhe ish-President, z. Jacek Jezierski, zj. Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme e KLSH dhe z. Paweł Banaś, Drejtor i Auditimit të TI në NIK, parashtruan rëndësinë e Projektit të Binjakëzimit dhe renditën një sërë produktesh dhe vlerash të realizuara nëpërmjet tij, duke veçuar programin e rregjistrimit elektronik të një dosje të plotë auditimi, një risi për të gjithë komunitetin e INTOSAI-t, realizuar në kuadër të programit për KLSH-në.

Në fjalën përmbyllëse të Konferencës, Kryetari Leskaj theksoi se *"Përmbyllja me sukses e këtij projekti për ne nuk përbën fundin e progresit të KLSH në auditim. Mbyllet një sipar dhe hapet një tjetër. Përfundimi i Projektit të Binjakëzimit shpreh një vijimësi në realizimin e treguesve të auditimit, të matur sipas Kornizës së Matjes së Performancës së SAI-t, miratuar si standard ne Kongresin INCOSAI XXII të INTOSAI-t në dhjetor 2016. Mbi bazën e Strategjisë së re të institucionit 2018-2022, të përgatitur dhe në reflektim të rekomandimeve të përmbajtura në raportet e misioneve të Projektit, ne e shohim me besim të plotë të ardhmen".*

Në vijim të aktiviteteve, Presidenti i NIK-ut Polak dhe Delegacioni Kroat udhëtuan drejt Qytetit të Shkodrës, në të cilin Presidenti Kwiatowski u dekorua nga Këshilli i Qarkut Shkodër me titullin "Nderi i Qarkut Shkodër". Dekorata iu dorëzua Presidentit Kwiatowski nga

Kryetarja e Këshillit të Qarkut Shkodër, zj.Greta Bardeli me motivacionin: *"Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, njërit prej bashkëpunëtorëve të huaj më me kontribute për Kontrollin e Lartë të Shtetit në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale të audituesve të tij dhe të modernizimit të Institucionit, në mënyrë që auditimi i jashtëm në Shqipëri të vijë në nivel me standardet e INTOSAI-t"*.

Zonja Bardeli evidentoi vlerat historike, kulturore dhe sportive të qytetit të Shkodrës, duke vlerësuar kontributet e historianëve, arkitektëve, sportistëve dhe artistëve në përgjithësi që i kanë dhënë emër qytetit të Shkodrës.

Zoti Kwiatowski, mes emocioneve, vlerësoi maksimalisht nderin që i bëri Këshilli i Qarkut Shkodër, një qytet me shumë tradita dhe histori.

Me pas Delegacioni Polak dhe Kroat, të shoqëruar nga përfaqësuesit e KLSH-së dhe të Qarkut Shkodër vizituan Qytetin e vjetër, Kalanë e Shkodrës dhe Fototekën "Marubi".

Në datën 12 korrik, Presidenti i NIK-ut Polak, z.Kwiatowski u dekorua nga Bashkia Vlorë me titullit "Qytetar Nderi", i Vlorës. Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Dritan Leli i dorëzoi titullin z.Kwiatowski, duke theksuar rolin e tij si President i NIK-ut Polak për trajnimin e dhjetëra audituesve të KLSH-së në Poloni, të cilët nën përkujdesjen e tij dhe të stafit që ai drejton kanë kryer trajnime në shumë fusha si në auditimin Financiar, të përputhshmërisë, të prokurimeve publike, etj, duke përmirësuar dhe përforcuar ndjeshëm dijet e tyre në këto fusha dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së punës audituese të KLSH-së.

Presidenti Kwiatowski falenderoi Kryetarin e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak të qytetit të Vlorës, duke theksuar se do të punojë për të qenë qytetar i denjë i këtij qyteti. Ceremonia kaloi në një atmosferë të përzemërt dhe miqësore.

Vizita Studimore në Kuadër të Projektit IPA në Poloni

Nga data 8-13 Korrik 2018, në kuadër të aktiviteteve 2.2.9 të Projektit të Binjakëzimit AL13 IBFI 01 mbi forcimin e kapaciteteve të auditimit të jashtëm shtetëror, një grup prej 16 audituesish të KLSH-së realizuan një vizitë studimore në Varshavë të Polonisë. Kjo vizitë u zhvillua pranë Zyrës së Auditimit Shtetëror të Polonisë (NIK) dhe pjesë e saj ishin edhe disa institucione shtetërore si, Institucioni i Auditimit /Autoriteti i Auditimit në Ministrinë e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Investimeve. Në takimin e hapjes, Zëvendës Presidenti i NIK z. Wojciech Kutyla nënvizoi midis të tjerash se, *"projekti për fat të keq po mbaron gjatë kësaj jave, por siç e dini, ai ka ecur shumë mirë dhe finalizohet me vizitën tuaj dhe inaugurimin e sallës me emrin e ish-Presidentit Polak Lech Kaczyński në Tiranë në mjediset e KLSH. Do të keni një sërë takimesh me ekspertët më të mirë të financave publike dhe të administrimit të fondeve europiane".*

Gjatë dy ditëve të para, temat e trajnimit u prezantuan nga z. Augustin Kubik, Këshilltar i Presidentit të NIK dhe ish-anëtar i Gjykatës Evropiane të Auditimit (ECA) në periudhën 6 vjeçare,

2010-2016.Fokusi kryesor i këtyre prezantimeve ishin aspekte dhe çështje të tilla si: detyrat funksionale dhe organizimi i institucioneve të administrimit, çertifikimit dhe auditimit të fondeve të përfituara nga ana e Bashkimit Evropian në Poloni; dallimet midis Institucionit të Auditimit (si strukturë e pavarur dhe që konsiderohet si auditim i jashtëm për agjencitë administruese dhe përfituesit e fondeve, që i raporton Komisionit Evropian) si dhe Zyrës së Auditimit Shtetëror NIK (si strukturë shtetërore e pavarur, që i raporton Parlamentit të vendit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit, ku pjesë mjaftë e rëndësishme e tij janë dhe fondet me origjinë nga institucionet europiane). Nga ana e Institucionit të Auditimit realizohen tre lloje auditimesh: auditimet e sistemeve, auditimet operacionale, si dhe auditimet e paraqitjes së shpenzimeve, për të cilat lëshohet njëra nga katër tipologjitë e opinioneve të auditimit sipas INTOSAI-t. Vend të rëndësishëm në prezantime iu rezervuan organizimit, përfaqësimit, detyrave dhe funksionimit të ECA. Lektorët nënvizuan se katër shtyllat ku mbështetet misioni i ECA-s janë: promovimi i përgjegjshmërisë dhe transparencës, kontributi në nxitjen e përgjegjshmërisë financiare, të shërbyerit si roja i pavarur i interesave të qytetarëve evropianë, si dhe ofrimi i udhëzimeve e këshillave për ligjvënësit dhe politikëbërësit e BE-së, bazuar në Traktatin e Mastrihtit (1992), Traktatin e Amsterdamit (1997), Traktatin e Nicës (2001) dhe Traktatin e Lisbonës (2007). 28 vendet anëtare formojnë trupën gjyqësore të ECA-s, e cila është ngritur mbi 5 dhoma (chamber) dhe ku kreu i saj është një “primus interparius” – (i parë mes të barabartëve), gjë që nënkupton se vota e tij është e baras vlefshme me gjithë anëtarët e trupës së Gjykatës, (me përjashtim të rasteve kur votat e vendeve anëtare ndahen e janë të barazuara, ku dhe vota e tij bëhet përcaktuese).

Në mënyrë të posaçme, z.Augustin Kubik, u ndal në shpjegimet e mekanizmave se si Gjykata Evropiane Auditimit i ofron Parlamentit dhe Këshillit Evropian dokumentin e njohur si Deklarata Vjetore e Sigurimit/ Statement of Assurance (DAS), i konsideruar si dokumenti përfundimtar për besueshmërinë e llogarive dhe ligjshmërinë e rregullsinë e transaksioneve themelore të buxhetit evropian të shpenzuar nga Komisioni Evropian. Përmes këtij dokumenti, (nganjëherë i cekur si regjistri 300 fletësh) ECA certifikon llogaritë e shpenzimeve dhe të ardhurave për gjithë buxhetin e BE. Kjo bazuar në rezultatet e auditimeve mbi bazë kampionimesh, rezultate që ekstra-polohen sipas softeve kompjuterike dhe bëhen të vlefshme për gjithë populacionin/ buxhetin e BE. Mbi këtë bazë arrihet në dhënien e konkluzionit dhe lëshimin e opinionit mbi sigurinë e deklaratave financiare të hartuara nga

Komisioni. Opinioni DAS jepet për të ardhurat totale dhe shpenzimet totale dhe në rastin e shpenzimeve edhe për grupet individuale. Interesant është fakti, se për herë të parë, ECA për llogaritë vjetore të vitit 2016 lëshoi opinion të kualifikuar për buxhetin e përgjithshëm të BE përmes DAS, pasi që nga krijimi i Gjykatës opinioni kishte qenë negativ. Burimet kryesore për të hartuar DAS janë:

a) Sistemi i kontrollit dhe administrimit të Komisionit Evropian;

b) Raporti vjetor i aktivitetit të BE;

c) Përdorimi i punës së të tjerëve;

d) Testimet substanciale.

Ish-anëtari i Gjykatës Evropiane të Audituesve, Z.Kubik shpjegoi raportet speciale të auditimeve që hartohen në Gjykatë dhe bashkëpunimin e ECA-s me OLAF për rastet e investigimit të mashtrimeve të identifikuara. Numri i këtyre raporteve, sipas ekspertit të financave, arrin mesatarisht nga 8-10 në vit. Metodikat dhe udhëzuesit që zbatohen në përditshmërinë e aktivitetit të auditimit të ECA-s, nevoja për metodologjinë dhe udhëzimet e standardizuara të përfshira në Piramidën Metodologjike të Kuadrit të ECA-s, (ku Standardet e Auditimit të Jashtëm janë shtylla kurrizore e metodologjisë); teknikat dhe mënyra e zgjedhjes së provës/ mostrës/ kampionit sipas Metodës së Njësisë Monetare (NUS); dallimet midis ISA dhe ISSAI-t; shpjegimet dhe udhëzimet se kur mund të përdoret puna e audituesve të tjerë, etj.; dallimet midis sigurisë së kufizuar dhe sigurisë së arsyeshme; dallimet midis termave "materialitet" dhe "persuasiveness", etj., ishin disa nga çështjet që morën vëmendjen e audituesve të KLSH.

Përgjatë dy ditëve të fundit vizita u shtri rreth Institucionit të Auditimit (Audit Authority)/ IAP dhe mbi mekanizmat e metodologjitë e punës së tij. Moderatorë të këtij prezantimi ishin Z.Marius Fraczkowski, Doreta Kwiecinska-Zv/Drejtues të Departamentit të IAP, si dhe dy ekspertë të financave publike. Ky institucion është pjesë e Ministrisë së Financave me 500 punonjës dhe është institucioni i vetëm atipik pasi ka auditues si në këtë bërthamë ashtu edhe pranë çdo njësie rajonale (në 16 rajonet) për të audituar në terren zbatimin e kontratave të projekteve nga çdo përfitues i fondeve evropiane, qofshin këto agjenci, biznese, fermerë, agropërpunues etj. Ndonëse është pjesë e MF, IAP auditohet nga ana e Komisionit Evropian, nga ECA si dhe nga NIK. Në Poloni ka vetëm një autoritet që merret me auditimin e fondeve të BE për gjithë programet e BE, ndryshe nga disa shtete të tjera si Italia, Gjermania, etj., që kanë ngritur institucione auditimi për çdo program. Slogani që dëgjohet në IAP është se, "nga njëra anë ne jemi institucion që auditojmë të tjerët, nga ana tjetër, jemi

institucion që auditohemi dhe të tjerë na auditojnë ne”...

Tipologjitë kryesore të auditimeve që zbatohen nga IAP janë:

- Auditime të dizenjimit (këto kryhen vetëm njëherë në fillim të proceseve, kur nis krijimi dhe kompozimi i institucioneve që do menaxhojnë dhe administrojnë ndihmën financiare evropiane);
- Auditime të sistemeve, (njësoj siç realizohen nga ana jonë dhe mbështetur në udhëzuesit e INTOSAI-t)
- Auditime të operacioneve (që janë auditet e projekteve dhe kryhen pranë çdo përfituesi apo beneficiari);
- Auditime tematike mbi instrumentet e inxhinierisë financiare;
- Auditime specifike (audit mbi ujditë e mundshme të operatorëve konkurrues pjesëmarrës në tenderat me fondet publike).

Në përfundim, në mjediset e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Investimeve, ekipi i KLSH, i shoqëruar nga drejtuesja e lartë Znj. Magdalena Czapska, u njoh me sistemin e menaxhimit të fondeve të BE, i titulluar “Sistemi i vënies në jetë të projekteve” si në infrastrukturë, në zhvillimin e rajoneve, në inovacion, në fushën e planifikimit hapësinor etj. Kjo ministri është përgjegjëse për hartimin dhe përditësimin e dokumenteve strategjike në nivel kombëtar e rajonal, ajo bën sinergjizimin mes operacioneve dhe proceseve në nivele të ndryshme (9 strategji për zhvillimin e 16 rajoneve). Ndër të tjera, u sqaruan mekanizmat e kontrollit dhe roli i NIK e ECA për të shpenzuar me efektivitet fondet evropiane.

Vizita studimore ishte mjaftë e dobishme dhe u përmbush me sukses. Ajo u përcoll me interesim nga gjithë audituesit e KLSH-së, që përmes pyetjeve të ndryshme dhe qasjeve krahasimore për situata të ngjashme, demonstruan interesim dhe korrektësi lartë.

Në këtë aktivitet morën pjesë Kryeauditues Lolita Baholli, dhe Audituesit Qeram Cibaku, Valentina Golemi, Erjola Meçaj, Ibrahim Ndreu, Alfred Cako, Ilir Hilaj, Safete Pojani, Artan Mirashi, Brenton Kotorri, Erieta Kellici, Jovan Plaku, Bledi Dervishaj, Erjola Hoxha, Aurel Rexhaj, Xhuljana Kume.

KLSH prezanton në Kuvend në seancë plenare Raportin e Performancës 2017

Në seancën plenare të datës 19.07.2018, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj, raportoi

përpara deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë mbi performancën institucionale të institucionit që ai drejton për vitin 2017.

Në fjalën e tij, z. Leskaj u ndal në zhvillimin strategjik të institucionit për periudhën 2012-2017, matjen e performancës sipas kuadrit të ri metodologjik të rekomanduar nga organizata botërore e institucioneve supreme të auditimit INTOSAI, sikurse edhe në sfidat për të ardhmen. "Filozofia e punës sonë në këto vite ka qenë modernizimi i institucionit në punën audituese, si edhe thellimi i transparencës dhe llogaridhënies për një qeverisje të mirë dhe në luftë kundër korrupsionit për përmirësimin e qeverisjes, duke vepruar me moton "KLSH-shërbestar i qytetarit dhe agjent i Kuvendit". Objektivat Strategjikë të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t u integruan në koherencë të plotë në Planin Strategjik, duke u formalizuar në objektivat kryesore:

1. Zhvillimi i kapacitetit institucional të KLSH;
2. Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit;
3. Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës;
4. Zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i TI në auditim;
5. Rritja e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit, si dhe
6. Rritja e ndikimit të rolit të KLSH-së përmes komunikimit dhe bashkë-punimit.

Kjo strategji u formulua në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe ishte guri i themelit për ndryshimin që pasoi në të gjitha dimensionet e punës në KLSH, ku më kryesoret përmenden: mandatimi i KLSH-së përmes Ligjit 154/2014 në kryerjen e aktivitetit auditues në linjë me simotrat e veta të zhvilluara, konsolidimi profesional përmes manualeve të auditimit dhe trajnimit të stafit, hapja institucionale përmes botimeve (shkencore dhe në shtypin e përditshëm) dhe komunikimit me palët e interesit, sikurse bashkëpunimet me SAI-et e huaja në përputhje me moton tonë ndërkombëtare: "Eksperienca e përba-shkët iu shërben të gjithëve".

6 fushat ku u shtri matja e performancës për vitin 2017 ishin:

1. Pavarësia dhe korniza ligjore;
2. Qeverisja e brendshme dhe etika;
3. Cilësia e auditimit dhe raportimi;
4. Menaxhimi financiar, asetet dhe strukturat mbështetëse;
5. Burimet Njerëzore dhe Trajnimi;
6. Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit.

Treguesit e agreguar dëshmojnë se KLSH, për vitin 2017 ka një perfomancë mbi nivelin mesatar. Konkretisht për tre nga 6 fusha vlerësimi, përkatësisht fushat 3, 4 dhe 5 merr vlerësimin 4 (nga 4) dhe për 3 fushat e tjera vlerësimin 3 (nga 4).

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën Janar - Dhjetor 2017, ka kryer 156 auditime nga 154 auditime të planifikuara, nga të cilat:

-92 auditime rregullshmërie;

-25 auditime përputhshmërie;

-14 auditime financiare;

-15 auditime performance;

-5 auditime tematike;

-5 auditime të T.I.

Institucioni ka arritur të konsolidojë një nivel "dysheme" auditimesh, për të siguruar mbulueshmërinë e duhur me auditim në fushat kryesore të shpenzimeve publike dhe të gjenerimit të të ardhurave, prag nën të cilin nuk ka rënë asnjëherë në këto 6 vitet e fundit.

Nga auditimet e kryera në vitin 2017, KLSH ka identifikuar mungesë përgjegjshmërie nga titullarët e institucioneve të çdo niveli, mosnjohje të kërkesave të ligjit të menaxhimit financiar, nivele të ulta dhe inefiçiencë të sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke krijuar risqe për shpenzime jo në përputhje me kërkesat ligjore dhe efektivitet të ulët në shpenzimin e fondeve buxhetore. Vijojnë praktikat dhe vendim-marrjet institucionale me efekte negative në fondet publike, ku niveli i dëmeve dhe shpenzimeve joefektive të konstatuara është:

- Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 11.5 miliardë lekë ose 85.8 milionë euro.
- Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në perfomancën e fondeve publike të shpenzuara nga subjektet e audituara, në shumën totale prej 99.05 miliardë lekë ose afërsisht 739.7 milionë euro nga e cila: 92.7 miliardë lekë në fushën e të ardhurave ose afërsisht 692.1 milionë euro dhe 6.3 miliardë lekë ose afërsisht 47.8 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve. Në total janë konstatuar shkelje në shumën 110.5 miliard lekë ose afërsisht 825.6 milionë euro. Dëmi i konstatuar është në një trend rritës në vitet e fundit. Në përfundim të fjalës së tij, Kryetari Leskaj theksoi se"Objektivat tona prioritare për të ardhmen u integruan në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022 në tre drejtime themelore:

    1) Rritja e impaktit të punës audituese me fokus në 6E-të (ekonomicitet, eficiensë, efektivitet, energji, etikë dhe environment (mjedis);

2) Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse.

3) Vazhdim i përmirësimit të kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit me partnerët dhe palët e interesit.

Në formulimin e këtyre objektivave, motoja apo qëllimi parësor, është: "Rritja e KLSH në dobi të qytetarit", duke qenë të bashkuar në ambicie dhe vendosmëri me të gjithë partnerët tanë strategjikë, sipas motos së Kongresit të XXII-të të INTOSAI-t në dhjetor 2016.

Në vijim, Kuvendi miratoi Rezolutën për aktivitetin e KLSH-së, duke dhënë rekomandime të vlefshme për përmirësimin e ardhshëm të punës se institucionit suprem të auditimit.

Auditues të KLSH pjesë e programit ndërkombëtar të fellowship-it të organizuar nga Zyra e Auditimit të Qeverisë së SHBA

Në përmbushje të qëllimit të dytë të Strategjisë së Zhvillimit 2018-2022 *"Optimizmi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse",* i cili synon të sigurojë që stafi auditues të zotërojë aftësitë dhe dijet e krijuara për të realizuar me profesionalizëm çdo aspekt që mund të përballet gjatë punës audituese, në datat 21 mars - 12 korrik 2018, Audituesi i Lartë, z. Alfinc Gabili dhe Audituese e I-rë, znj. Alma Shehu morën pjesë në programin ndërkombëtar të fellowship-it të organizuar nga Zyra e Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO).

Programi vjetor i fellowship-it (International Auditor Fellowship Program –IAFP) i ofruar nga GAO është një kurs studimi intensiv 4-mujor me 640 orë trajnimi, seminare dhe e-learning, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë institucioneve supreme të auditimit për të rritur kapacitetet e tyre profesionale dhe forcuar aftësinë e SAI-ve për të përmbushur misionet e tyre në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në qeverisje në mbarë botën. GAO e ka iniciuar këtë program në vitin 1979 dhe në programet e përvitshme kanë marrë pjesë 590 zyrtarë të nivelit të mesëm dhe të lartë nga SAI-të të më shumë se 100 vende kanë përfunduar programin.

Programi i fellowship-it ishte i fokusuar kryesisht në metodat dhe teknikat për kryerjen e auditimeve të performancës dhe aftësitë për zhvillimin e lidership-it. Ai përfshin trajnimin në klasë dhe

këqyrjen nga afër të të gjitha fazave të auditimit që prej pranimit të kërkesës së ardhur nga anëtarët e Kongresit për inicimin e një auditimi të caktuar, fazën studimore për auditimet e performances, hartimin matrix–it të auditimit, i cili përfshin hartimin e pyetjes kryesore dhe nën pyetjeve, përcaktimin e kritereve, përzgjedhjen e metodologjisë për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, hartimin e draft raportit, përfshirjen e komenteve të agjencive federale për draft raportin dhe publikimin e raportit përfundimtar. Në përmbushje të detyrimeve për pjesëmarrjen në programin e fellowship-it, në përfundim të programit audituesit e KLSH-së dorëzuan dy punime:

1. Kontrolli i brendshëm në SHBA- eksperienca e përfituar për tu implementuar në Shqipëri- punuar nga Alfonc Gabili.
2. Diferenca midis Zyrës së auditimit të Qeverisë së SHBA dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit në qasjen ndaj auditimit të performancës me fokus matjen e efektivitetit të programeve qeveritare - punuar nga Alma Shehu.

Përgjatë ndjekjes së programit të fellowship-it audituesit e KLSH patën mundësinë të takohen me Kontrollorin e Përgjithshëm të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA, z. Gene Dodaro, të cilit i shprehën falënderimet e Kryetarit të KLSH-së, z. Bujar Leskaj lidhur me marrëdhëniet e shkëlqyera midis dy

institucioneve dhe intensifikimin e tyre gjatë 7 viteve të fundit. Ftesa e GAO-s për pjesëmarrje në programin e fellowship-it dëshmon edhe njëherë gatishmërinë e GAO-s për të ndihmuar KLSH-në në ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të audituesve të saj. Zoti Dodaro shprehu vlerësimin e tij për angazhimin maksimal të z. Leskaj për modernizimin e KLSH-së dhe ndryshimet e cilësore që ka pësuar institucioni në vitet e fundit .

Në takimin që audituesit e KLSH patën me Drejtorin e Planifikimit Strategjik, z. James Christian Blockwood e falënderuan për organizimin cilësor të programit të fellowship-it, i cili i mundëson audituesve të njihen dhe të përfitojnë nga eksperienca e përparuar e GAO-s në auditimet e performancës. Z. Blockwood vlerësoi ndryshimet që ka ndërmarrë KLSH për ti dhënë më shumë rëndësi auditimeve të performancës dhe vlerësimit të programeve qeveritare si dhe përkthimin në gjuhën shqipe dhe përdorimin që kanë gjetur nga audituesit e KLSH-së dy prej dokumenteve kryesore të GAO-s:

Standardet e Auditimit të Qeverisë (Yellow book) dhe Standardet e Kontrollit të Brendshëm (Green book). Z. Blockwood shprehu gatishmërinë për vijimin e bashkëpunimit të mëtejshëm dhe shqyrtimin e mundësisë për të ftuar auditues të KLSH-së për të marrë pjesë edhe në trajnime të tjera afatshkurtra të ofruara nga GAO.

Në përfundim të programit të fellowship-it pjesëmarrësit u pajisën me certifikatën e kryerjes me sukses të këtij programi.

KLSH merr pjesë në takimin e rishikimit të draft raporteve të auditimit të programit të IDI-it Lufta kundër korrupsionit

Në datat 6-17 gusht 2018 në Lusaka, Zambia, u zhvillua takimi mbi auditimin e performancës së kuadrit ligjor dhe të implementimit të tij per luftën kundër korrupsionit, i iniciuar nga Iniciativa për Zhvillim (IDI), e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI. Ky takim ishte në vijimësi të takimit me të njëjtën temë të mbajtur në tetor të vitit 2017 ne Budapest, Hungari.

Qëllimi i programit të Iniciativës Ndërkombëtare për Zhvillim, IDI, i titulluar "Roli i SAI-ve në luftën kundër korrupsionit" është në mbështetje të përpjekjeve të institucioneve anëtare për të prezantuar qasjen e bazuar në integritet në luftën kundër korrupsionit.

Në kuadër të këtij programi, ekspertët nga SAI-t e Shqipërisë, Gjeorgjisë, Xhamajkës, Ishujve Kajman, Kazakistanit, Liberisë, Sierra Leones, Tanzanisë dhe Zambias diskutuan për mënyrën dhe zhvillimin e mjeteve në dispozicion të institucioneve përkatëse për të luftuar korrupsionin. Në këtë takim vendet pjesëmarrëse paraqitën punën e SAI-ve respektive në kuadër të luftës kundër korrupsionit, përkatësisht gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet qe kishin rezultuar ne përfundim të auditimeve të performancës të kryera mbi këtë problematikë. Raportet e auditimit të të gjithë pjesëmarrësve iu nënshtruan procedurës Peer Review gjatë të cilës grupet e punës të ngritura nga audituesit pjesëmarrës në takim shqyrtuan përputhshmërinë e planeve të auditimit me standardet ndërkombëtare.

Më konkretisht Peer Review u zhvillua në 7 faza:

- Pjesa e vëzhgimeve të përgjithshme;
- Vëzhgimi i objektivit të auditimit dhe i pyetjeve audituese;

- Fushëveprimi, qasja e auditimit dhe periudha kohore e mbuluar;
- Metodologjia e auditimit, burimi dhe grumbullimi i të dhënave si dhe analiza e tyre;
- Kriteret e auditimit dhe burimet e tyre;
- Gjetjet e auditimit dhe konkluzionet përkatëse.

Në përfundim të kësaj procedure çdo grup dha mendime për përmirësimin e rekomandimeve përkatëse për çdo raport të auditimit të ndërmarrë nga SAI-t pjesëmarrëse. Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë takim nga z. Artur Hasanbelliu, Drejtor Drejtorie, z. Gjovalin Preçi, Drejtor Drejtorie dhe znj. Megi Kurrushi, audituese ne Departamentin e Auditimit të Performancës. Përfaqësuesit e KLSH prezantuan raportin e auditimit të performancës me temë "Efektiviteti i Strategjisë Kombëtare Antikorrupsion".

Në përfundim të aktivitetit u dakordësuan afatet për përcjelljen e raportit të auditimit në subjektet e audituara si dhe u rakorduan afatet për përgatitjen e raportit përfundimtar të auditimit si dhe dërgimi i një kopje tek IDI me qëllimin e përgatitjes së një raporti të përbashkët të të gjithë SAI-ve pjesëmarrëse dhe publikimin e tij nga ana e organizatorëve të këtij projekti.

Trajnime brenda vendit

Gjatë 9 mujorit të vitit 2018, trajnimet e organizuara brenda institucionit janë fokusuar kryesisht në tre drejtime kryesore:

1. Trajnime për stafin e ri, në konceptin e prezantimit dhe njohjes së audituesve të rinj me ambientin ku ata pritet të punojnë, dhe dhënien e njohurive fillestare mbi profesionin e auditimit, aftësitë që duhet të zotërojnë, teknikat dhe mjetet qe duhet të njohin dhe përdorin gjatë punës së tyre. Në paketën e trajnimit, e cila u është ofruar audituesve në sesione 15 ditore trajnimi, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI) dhe aplikimi i tyre në kuadrin ligjor dhe rregullator të KLSH nëpërmjet përcaktimeve në nivelin më të Lartë të Kushtetutës së Shqipërisë, Ligjin Organik 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH" si dhe Manuale e udhëzues të praktikave të auditimit, mundësojnë parapërgatitjen e tyre për t'u përfshirë në ushrimin e funksionit si auditues publik me njohuritë bazë.

2. Trajnime për testimin e njohurive për njohuritë shtesë dhe vlerësimin e performancës së punës së audituesve, të organizuar në qershor 2018, i cili kishte si qëllim përditësimin e njohurive që audituesit zotërojnë si dhe një vlerësim paraprak të nevojave për njohuri shtesë në fusha specifike. Mbështetur në rezultatet e këtij sesioni si dhe kërkesat e vetë audituesve, në vijim procesi u mbështet nga veprimtari të tjera trajnimi.

3. Trajnimet e përditësimit të njohurive, të cilat janë drejtuar për stafin ekzistues dhe me eksperiencë, kryesisht në formën e shkëmbimit të eksperiencës brenda vetë departamenteve si dhe ofrimin e trajnimeve nga partnerët ndërkombëtarë dhe lokalë gjatë kryerjes së trajnimeve, të organizuara gjatë gjithë vitit dhe me theks të veçantë në Programin e Trajnimit 4-javor të organizuar gjatë muajit Gusht 2018, në të cilin u trajtuan rreth 13 tema të ofruara nga 10 trajnues ekspertë të brendshëm dhe ku morën pjesë mesatarisht 25 audites /ditë trajnimi.

Një pamje e përgjithshme e treguesit të ditëve të trajnimit jepet në tabelën e mëposhtëme:

TRAJNIMET E OFRUARA SIPAS BURIMIT		
Trajnime brenda vendit	**2425**	
Trajnime brenda Departamentit		501
Trajnime IPA (brenda vendit)		458
Trajnime Paketa Prezantimit (Audites te Rinj)		138
Trajnime Eksperte te jashtëm brenda vendit		63
E- Learning		45
Trajnime Përditësimi Njohurive (Urdhër nr.64, date 22.05.2018 & Program Trajnimi Gusht 2018)		1220
Trajnime Jashte vendit	**456**	
TOTALI DITE NJERËZ TRAJNIMI	**2881**	

Implementimi i suksesshëm gjatë nëntë mujorit të vitit 2018 të Programit të Zhvillimit Profesional të Stafit te KLSH, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 230, datë 31.12.2017 mundësoi që çdo audites në KLSH përgjatë kësaj periudhe të arrijë objektivat sa më poshtë:

Në total çdo punonjës në KLSH (audites+ staf drejtues) është trajnuar mesatarisht 19 ditë.

Çdo audites është trajnuar mesatarisht 21 ditë gjatë periudhës 9 mujore.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT TË AUSTRALISË

Qëllimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Australisë **(ANAO)**[1] është të përmirësojë performancën e sektorit publik dhe të mbështesë llogaridhënien dhe transparencën në sektorët e qeverisjes Australiane, përmes raportimit të pavarur në Kuvend, në Këshillin e Ministrave dhe informimit të publikut.

Qeveria përgjigjet përpara Parlamentit për përdorimin dhe mirë administrimin e të ardhurave publike, si edhe për mirë funksionimin e legjislacionit në fuqi të miratuar nga Kuvendi. Auditori i Përgjithshëm shqyrton dhe jep siguri të pavarur dhe objektive nëse Ekzekutivi po vepron në përputhje dhe për llogari me qëllimin e ligjvënësit (Parlamentit).

